

1 E hënë, 12 shkurt 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat përmbyllëse]

4 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.01

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Paraqisni ju
7 lutem.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
9 lënda KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
10 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
11 Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
13 Mirëmëngjes të gjithëve. Misë se vini. Vërej që të akuzuarit
14 janë të gjithë të pranishëm në sallën e gjyqit.

15 Sot do të vazhdojmë të dëgjojmë deklaratat përmbyllëse të
16 kësaj çështjeje gjyqësore. Sot do të vazhdojmë me deklaratën
17 mbyllëse të Mbrojtjes së Kadri Veselit. Më pas do të dëgjojmë
18 avokatin e Rexhep Selimit. Do të ndjekim rendin e ditës siç
19 është paraqitur në urdhrin e Trupit Gjykes që ka të bëjë me
20 deklaratat përmbyllëse, që ka shifrën P03639.

21 Sot do ta përfundojmë në orën 16.45 dhe kemi pushime
22 gjysmë orëshe në orën 10.30, pastaj kthehemi në orën 11.00,
23 kemi një orë e gjysëm për drekë në orën 13.00, kthehemi sërish
24 në orën 14.30, pastaj kemi një pushim 15 minuta dhe e fillojmë
25 seancën në orën 15.45.

1 Së fundmi, do t'ju them që këto deklaratat përbyllëse
2 përkthehen dhe ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve që të flasin
3 ngadalë për t'i mundësuar përkthyesve që të mund ta
4 përballojnë ritmin dhe keni kujdes që të mos e lexoni me
5 shpejtësi të madhe.

6 Kaq nga ana e Trupit Gjykses. Tani do të vazhdojmë me
7 deklaratën përbyllëse të Mbrojtjes së Kadri Veselit.

8 Z. Dixon, keni pasur katër orë e gjysëm në dispozicion,
9 kështu që ju kanë mbetur tre orë e gjysëm dhe do të përfundoni
10 jo më vonë se në orën 1.00 të ditës së sotme. Kur të jeni gati
11 mund të vazhdoni.

12 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

13 Dje e ndalua kur unë po flisja për pikën e dytë të
14 përgjithshme lidhur me NPK-në. Siç e thashë në fund të ditës
15 së djeshme, sot do të paraqes disa prej tipareve të këtyre
16 rrethanave mbi të cilat bazohet ZPS-ja, por të cilat, në fakt,
17 kur analizohen del se nuk kanë asnjë vlerë. Duhet të mos
18 harrojmë asnjëherë që ZPS-ja ka për detyrim që të provojë këto
19 rrethana, ato nuk mund të bazohen thjesht në informacionet e
20 dorës së dytë, thashetheme dhe në dëshmi të cilat janë të
21 pavërtetuara.

22 Numri i urdhrave të shkruara të cilat janë paraqitur si
23 prova dhe që vijnë nga z. Veseli lidhur me ndonjë gjë, le më
24 kur flitet për aktivitete penale apo kriminale: Asnjë.

25 Numri i urdhrave gojorë nga ai që mund t'ia ketë dhënë

1 ndokujt tjetër: Asnjë.

2 ZPS-ja do të përpiqet të pretendojë që ka patur një rast
3 kur është bërë një kërkesë e pretenduar nga z. Veseli për z.
4 Qadraku në një takim rastësor që është zhvilluar rreth 1 prill
5 1999 dhe që paraqitet në një farë mënyre si një urdhër. Pra,
6 një dëshmi nga z. Qadraku, një kërkesë për disa trupa, kërkesë
7 dhe asgjë tjetër. Dhe kur z. Qadraku u kthye dhe tha se kjo
8 nuk kishte të bënte, z. Veseli as nuk ishte aty dhe nuk mund
9 t'i raportonte në një farë mënyre. Pra, asgjë.

10 Numri i urdhrave që i janë dhënë ndonjë personi të
11 inteligjencës që kudo që ka të bëjë me një aspekt të
12 inteligjencës apo ndonjë gjeje tjetër: Asnjë.

13 Numri i personave të cilët tregohet përmes provave t'i
14 kanë raportuar z. Veseli dhe, sigurisht, që këtu nuk
15 përfshihen thashethemet apo pretendimet e pavërtetuara: Asnjë.

16 Nuk ka asnjë raportim të ndonjë skeme paralele
17 raportuese. ZPS-ja i dha një vëmendje të madhe kësaj
18 çështjeje. Kur paraqitën provat e tyre nuk e kanë nënvijëzuar
19 një gjë të tillë kur kanë bërë parashtrimet gojore. Pasi nuk
20 ekzistojnë.

21 Numri i rasteve kur ka nënshkruar ndonjë gjë, dy është
22 numri total, të nderuar Gjykatës. Një ishte nënshkrimi me
23 FARK-un në shtator të 1998-s për të bashkuar grupet për të
24 bashkëpunuar dhe, e dyta, një dokument i Shtabit të
25 Përgjithshëm i cili ka shumë nënshkrime të tjera dhe që ka të

1 bëjë me dakordësimin lidhur me Rambujenë, ku thuhet që mendimi
2 përfundimtar do të shpallet pas konsultimit me komandantët e
3 zonave dhe kjo është e marsit 1999. Është prova P227. Pra, dy
4 dokumente pozitive konstruktive synimi i të cilave ishte
5 nxitja dhe arritje e paqes.

6 Numri i takimeve të Shtabit të Përgjithshëm ku ka marrë
7 pjesë, ZPS-ja thotë që janë dy të tilla: një pjesë e një
8 takimi të Shtabit të Përgjithshëm të 12 nëntorit 1998 dhe më
9 pas i njëjtit takim që përmendëm më lartë kur folëm për
10 dokumentin e Rambujesë, i cili u nënshkrua më 12 mars 1999.
11 ZPS-ja u referohet këtyre dy takimeve në poshtëshënimin 2083
12 kur pretendojnë që përmes këtyre takimeve, z. Veseli kreu këtë
13 NPK. Dhe më duket që ata i referohen edhe një takimi të tretë
14 të mundshëm në prill të vitit 1999, mund të jenë tre takime të
15 cilëve i referohen ata, por bëhet fjalë për 3 nga 35 takime të
16 Shtabit të Përgjithshëm për të cilat ZPS-ja ka paraqitur prova
17 dhe mbi të cilat mbështetet. Dhe këta janë takimet në të cilat
18 nuk ka rrjedhur asgjë kriminale. Dhe nuk ka pasur as edhe
19 prova që z. Veseli të jetë zëvendësuar në të gjitha këto
20 takime, që t'i jetë raportuar atij apo që ai të ketë marrë
21 informacion pas secilit prej këtyre takimeve. Dhe nuk mund të
22 hamendësohet, të nderuar Gjykatës. Ka deduksione alternative
23 lidhur me këto komunikime. Por ekzistojnë këto, janë thjesht
24 deduksione alternative të arsyeshme, të cilat nuk i ka hedhur
25 poshtë Prokuroria.

1 Numri i personave që i ka caktuar apo shkarkuar: Asnjë.

2 Numri i urdhrave që mund t'i ketë dhënë ndokujt, raporte
3 që të ketë marrë apo aktivitete me persona të nivelit të ulët
4 të cilët në një farë mënyre janë paraqitur si pjesë e NPK-së,
5 Geci, Gashi, e tjerë: Asnjë.

6 Numri i personave të marrë në pyetje, të arrestuar, të
7 liruar nga ai, që të jenë të bazuar në prova të mbështetshme:
8 Asnjë.

9 Numri i deklaratave apo i komunikatave të cilat ka
10 përpiluar, për të cilat ka kontribuar apo që i ka lëshuar ai
11 që të jenë treguar atij, që të ketë pasur dijeni atij,
12 përsëri: Asnjë.

13 Numri i rregulloreve që ai ka përpiluar, ka luajtur rol
14 në përpilimin e tyre, është marrë me to, i ka shpërndarë apo i
15 ka zbatuar në një farë mënyre: Asnjë.

16 Numri i ditëve kur nuk ka qenë i pranishëm në Kosovë
17 gjatë periudhës së aktakuzës është një numër i madh. Bëhet
18 fjalë për muaj të tërë. Por numri i kontakteve që ka patur kur
19 ka qenë në Kosovë, me atë në Kosovë kur ka qenë jashtë bazuar
20 mbi dëshmitë e besueshme, asnjë.

21 Dhe dua të mbajmë parasysh këtu, pa u dhënë asnjë lloj
22 peshe përgjimeve serbe, të cilat ne i kemi diskutuar në dosjen
23 tonë dhe për të cilën do të dëgjojmë pak më vonë pak më shumë,
24 atëherë nuk provohet që z. Veseli të përmendet që ka marrë
25 pjesë si folës në asnjërin prej këtyre.

1 Sa i përket kontakteve nga jashtë në drejtim të Shtabit
2 të Përgjithshëm apo të tjerëve, pra, nga z. Veseli kur ishte
3 jashtë dhe kthehet në Kosovë e kështu me radhë, ZPS-ja bazohet
4 vetëm në një libër të Pal Refsdal për disa thirrje që i
5 përkasin një periudhe të shkurtër kur ndodhej jashtë shtetit
6 të cilat nuk janë thirrje të cilat i ka bërë z. Veseli. Nuk
7 janë paraqitur prova që ai të ketë nisur këtë thirrje
8 telefonike. Por z. Refsdal nuk është thirrur për të dhënë
9 dëshmi si dëshmitar. Mund të ishte thirrur. Libri i tij është
10 i përmbushur me thashetheme lidhur me këto ngjarje. Nuk është
11 i mbështetur apo i vërtetuar në asnjë mënyrë. Nuk ka prova për
12 të mbështetur këtë fakt të pretenduar që z. Veseli të ketë
13 qenë në kontakt të përhershëm me Shtabin e Përgjithshëm kur
14 ndodhej jashtë shtetit. Mbrojtja nuk ka qenë në gjendje që të
15 kundërshtojë autorin e këtyre pretendimeve, të diskutojë këtë
16 kështu që ajo që mbetet ajo është paraqitet në këtë libër për
17 atë që thuhet që janë ato telefonata. ZPS-ja nuk mund të
18 mbështetet në këtë pretendim apo material me plotë pretendime
19 për të provuar NKP. Kjo është një temë fatale e argumenteve të
20 ZPS-së.

21 Numri i urdhrave të lëshuar nga jashtë shtetit, raporte,
22 që kanë të bëjnë me çështjet e inteligjencës, vendime të
23 marra, emërime të bëra, veprime të ndërmarra, përfshirë edhe
24 veprime ushtarake të cilat nuk janë të paligjshme apo ndonjë
25 gjë që ka të bëjë me krimet e pretenduara të kësaj çështjeje

1 apo ndonjë gjë tjetër që të jetë e ndërlidhur: Asnjë.

2 Lista e asgjësë vazhdon, të nderuar Gjykatës. Këto shifra
3 nuk arrijnë në ato shifra që të përbëjnë një konspiracion
4 gjigand kriminal në të cilin të ketë luajtur rol z. Veseli.
5 Janë këto argumente rrethanore të cilat janë shumë të vogla.

6 Dhe tani, të nderuar Gjykatës, dhe pika e tretë e
7 përgjithshme që ka të bëjë me viktimat dhe me shtetin ligjor.
8 Kritikkat ndaj argumenteve të ZPS-së që kam bërë unë këtu sot
9 lidhur me z. Veseli për asnjë çast nuk zvogëlojnë vuajtjen e
10 viktimave të Kosovës, disa prej të cilave janë në qendër të
11 aktakuzës së kësaj çështjeje gjyqësore, përfshirë ato të cilat
12 unë i kam përmendur në parashtrimet e mia të deritanishme të
13 cilët nuk i kam përmendur për shkak të masave mbrojtëse,
14 megjithatë i kam në mendje gjithë kohën.

15 Shkatërrimet dhe dhimbja e shkaktuar në Kosovë gjatë
16 luftës ka qenë e jashtëzakonshme, që është një fakt shqetësues
17 për të gjitha palët dhe të gjitha palët pajtohen me këtë. Dhe
18 siç e kanë thënë ekspertët e thirrur nga z. Laws dhe nga Dr.
19 Black, Dr. Duhne-Prinsen, e kështu me radhë, kanë shpjeguar
20 ato që bëhet fjalë për 65 për qind të popullatës që kanë
21 përjetuar ngjarje traumatike gjatë luftës, janë 200.000 deri
22 në 400.000 individualë dhe më shumë e shumë të tjerë. Eksperti
23 ka nënvijëzuar që analizat specifike për Kosovën tregojnë që
24 edhe pas dhjetë vitesh pas përfundimit të luftës, stresi post-
25 traumatik mbetet në nivele shumë të larta. Dhe thonë që në të

1 gjitha këto raste ishte shumë më i lartë sesa studimet e bëra
2 në vende të tjera të cilat kishin kaluar një konflikt
3 përfshirë dhe luftëra si ato të Vietnamit. Dhe kjo gjendet në
4 faqen 8 të raportit të tyre të përbashkët.

5 Dhe kërkohet për këto veprime ndreqëse, përfshirë edhe
6 përmes punës së kësaj Gjykate. Siç e kanë nënvijëzuar
7 ekspertët, studimet kanë treguar që një numër shumë i lartë,
8 84 për qind e pacientëve të patrajtuar në Kosovë vazhdojnë të
9 tregojnë simptoma vite pas përfundimit të luftës. Dhe, siç e
10 thashë, koha nuk i shëron të gjitha plagët dhe kjo vlen për të
11 gjitha konfliktet dhe në pamundësi për të arritur drejtësinë
12 vetëm e përkeqëson këtë dhimbje dhe këtë vuajtje.

13 Dhe ky dështim bëhet më keq kur bëhet fjalë për mashtrim
14 nga sistemi i drejtësisë. Viktimat, siç e tha z. Laws, kanë
15 nevojë për drejtësi e cila të jetë e bazuar në të vërtetën dhe
16 në realitetin. Viktimat e dinë shumë mirë se padrejtësia më e
17 keqe është drejtësia e pretenduar apo false. Në synimin për
18 t'i dhënë fund pandëshkueshmërisë - që është e domosdoshme,
19 nuk është ndonjë opsion - duhet të mos sakrifkohet e vërteta,
20 duhet të mbrohen të pafajshmit dhe gjykatat tona duhet të jenë
21 gjykata me integritet.

22 Pavarësisht nëse duhen pesë vite apo më gjatë për të
23 arritur në përcaktimin e së vërtetës, siç ndodh këtu, ne duhet
24 të ecim në drejtim të saj për të arritur në fund të këtij
25 gjyqi tani që e dimë se cilat janë argumentet që përdor ZPS-

1 ja. Më pas koha që ka kaluar, sado që të ketë qenë e rëndë
2 edhe e vështirë, do të ishte me vlerë dhe e gjithë ajo bojë që
3 është harxhuar në mijëra e mijëra faqe të dosjeve
4 përfundimtare, fondet që janë shpenzuar për këtë Gjykatë, do
5 të jenë me vlerë për viktimat dhe për të gjithë, do të jenë me
6 vlerë për Kosovën dhe për tërë popullatën e saj, pavarësisht
7 përkatësisë etnike, si dhe me vlera për sa i përket fqinjëve
8 të saj Serbisë dhe Shqipërisë. Kjo do të bëjë që përfundimi i
9 gjykimit të Veselit këtu për një kohë prej më se pesë vitesh
10 do të jetë sukses, jo vetëm për shkak se do të lirohet një
11 person i pafajshëm por do të vendoset dhe precedenti që brezat
12 e ardhshëm do ta zbatojnë. Gjëja e fundit që duam ne këtu
13 është që brezat e ardhshëm në Kosovë dhe në rajon më
14 gjerësisht të mos kenë besim në shtetin ligjor për shkak se
15 është shkelur hapur në këtë çështje gjyqësore.

16 Të nderuar Gjykatës, ju si gardianët e shtetit ligjor,
17 tani në fund të këtij gjyqi të gjatë keni në dorë argumentet e
18 ZPS-së kundër z. Veseli dhe jeni ju, të nderuar Gjykatës, të
19 cilët jeni përballë dhe ta pengoni këtë përpjekje të kotë të
20 ZPS-së me qëllim që të mos shtrembërohet drejtësia.

21 Të nderuar Gjykatës, ju jeni pjesë e një tradite të
22 gjykatësve ndërkombëtarë të cilët jeni caktuar për të ndarë
23 faktin nga shpikjet në këto konflikte të armatosura. Kjo është
24 një traditë e cila vjen që nga Nurenbergu dhe përfundimi i
25 Luftës së Dytë Botërore dhe shpresojmë që do të vazhdojë edhe

1 në të ardhmen. Aktgjykimi juaj do të jetë pjesë, do të zërë
2 vendin e vet në këtë histori dhe nuk do të harrohet.

3 Pavarësisht se sa është përpjekur ZPS-ja që t'ju bindë
4 ju, të nderuar Gjykatës, që ta gjeni fajtor z. Veseli me çdo
5 kusht, ne e kundërshtojmë këtë me parimin ligjor dhe me
6 shtetin ligjor i cili është në qendër të të gjitha gjykatave
7 ndërkombëtare. Kur nuk ka prova apo kur provat janë të dobëta
8 nuk mund të ketë edhe shpallje fajësie.

9 Një nga tiparet e rëndësishme të tribunalit të
10 Nurenbergut, i cili është kritikuar, në fakt, si një drejtësi
11 e fitimtarëve që nuk ka pasur apel e kështu me radhë dhe sa i
12 përket edhe pranimit të një numri të madh të dokumenteve si
13 prova materiale, kjo kritikë ka qenë se në fakt ka falur disa
14 prej të pandehurve, 3 nga 22. Dhe unë po përmend dy prej
15 rasteve të faljeve apo të pafajësisë, jo për shkak se mund të
16 krahasohen me faktet e çështjes sonë gjyqësore, por për të
17 përmendur parimin ligjor i cili është në bazë të çdo gjykimi
18 penal.

19 Nën njërin prej këtyre rasteve, Hans Fritzsche, një
20 figurë e rëndësishme në ministrinë e propagandës, tribunalin
21 tha se pavarësisht se ai kishte bërë deklaratat të fuqishme të
22 natyrës propagandistike në transmetimet e tij, dhe unë po
23 citoj këtu:

24 "Tribunali nuk është i gatshëm që të konkludojë që ato
25 kishin synim që ta nxisnin popullin gjerman që të bënte krime

1 në popujt e pushtuar dhe ai nuk mund të thuhet se ka qenë
2 pjesëmarrës për krimet me të cilat është akuzuar. Synimi i tij
3 ishte thjesht që të krijonte mbështetje popullore në
4 mbështetje të përpjekjeve të Gjermanisë gjatë luftës.”

5 Dhe kjo është në faqen 526 të aktgjykimit.

6 Dhe në rastin tjetër të diplomatit Franz von Papen,
7 tribunali përfundoi se pavarësisht se ai ka shfrytëzuar
8 intrigën dhe është treguar bullizues si ministër i caktuar në
9 Austri në planin për të përforcuar nazistët në Austri dhe për
10 t’i minuar ata të cilët ishin kundër nazistëve, veprimet e tij
11 nuk ishin kriminale. Nuk ishte ndoshta mënyra më e mirë si për
12 ta zhvilluar këtë aktivitet por nuk ishte kriminale. Dhe kjo
13 në faqen 519 të aktgjykimit.

14 Dhe siç e thashë, pavarësisht se Lufta e Dytë Botërore
15 dhe konflikti i Kosovës, siç e thashë, as nuk mund të
16 krahasohen fare, parimet universale ligjore të kriminalitetit
17 si element themelor i shpalljes së fajësisë mbeten, dhe mbeten
18 me vend. Dhe është me rëndësi të theksohet që kur ka patur
19 dëshmi të pamjaftueshëm që të akuzuarit në Nurenberg nuk kanë
20 marrë pjesë në aktivitete penale në krime lufte apo krime
21 kundër njerëzimit, ata janë liruar. Dhe kjo ka treguar një
22 proces të vërtetë ligjor në të cilin prezumimi i fajësisë
23 është respektuar për miliona e miliona njerëz. Dhe kjo ishte
24 edhe ajo që i ka mbetur kësaj gjykate.

25 Është e njëjta gjë me gjykatat e tjera ndërkombëtare si

1 TPNJ-në, gjykatën e Ruandës dhe Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

2 Fatkeqësisht Prokuroria bën akrobaci në argumentet e saj
3 në raste kur nuk ka prova kundër klientit tim. Dhe është
4 pikërisht kjo që në fakt të shqetëson tej mase dhe kjo është
5 në kundërshtim me traditat krenare të gjykatës së të shkuarës
6 dhe të tanishme. Mund ta imagjinoni se si ndihet klienti im në
7 burg, plot ankth në një çështje e cila të mund të perceptohet
8 se është e vërtetë vetëm pse argumenti zhvendosi këtë. Në
9 fakt, Kardinali Richelieu, ministri kryesor i mbretit Louis
10 XIII nga viti 1620, fjalët e tij mbetën shqetësuese edhe sot
11 siç kanë qenë edhe atëherë. Dhe po citoj:

12 "Po të më japësh gjashtë rreshta të shkruar ... nga dora
13 e njeriut më të ndershëm unë përsëri do të gjejë diçka për të
14 cilin ta çoj në varje."

15 Dhe është pikërisht nocioni i shfrytëzimit të copëzave të
16 informacionit, të thashethemeve të spekulimit, copëza letrash,
17 propagandë, shenjëstrim, pretendime të paprovuara të cilat
18 thuren së bashku për të akuzuar dikë për një krim, pavarësisht
19 nëse personi e ka bërë një gjë të tillë. Ekuivalenti në
20 Amerikë është që një prokuror mund të ngrejë një çështje edhe
21 kundër një sanduiçi me proshutë.

22 Dhe ky rrezik ekziston gjithë kohën në kushtet e një
23 lufte guerilase kur nuk ka procesverbale të rregullta vetëm
24 copëza letrash, ku niveli i propagandës dhe mburrja është e
25 nivelit të lartë, kjo vjen edhe nga ata që luftojnë dhe nga të

1 cilët komentojnë dhe, më pas kemi dëgjuar komentet lidhur me
2 këtë dhe, më pas shënjestrohen me gisht të gjithë ata në të
3 gjitha drejtimet dhe, në fakt, humbet besimi në tërë
4 shoqërinë.

5 Por rreziku mbetet i pranishëm kur i akuzuari është shefi
6 i inteligjencës. Dhe pa nevojë për asnjë provë, mund të
7 krijohet ideja e një burri apo mashkulli misterioz i cili nga
8 hijet është i gatshëm që të bëjë krime. Dhe sipas këtij
9 mendimi të përgjithësuar thotë, a nuk grumbullojnë njerëzit e
10 inteligjencës informacion për të tjerët ta shfrytëzojnë kundër
11 tyre? Dhe ashtu në atë mënyrë kanë edhe licencën për të bërë
12 amnistinë e James Boond, 007? E kështu me radhë. Janë
13 pikërisht këto thjeshtëzime të intuitave dhe të përshtypjeve
14 të cilat në mënyrë krejt të pandërgjegjshme mund të thuren në
15 formën e një rrëfimi që tregon fajësi. Por, në fakt, nuk është
16 asgjë më shumë sesa një interpretim i pavërtetuar me anë të
17 secilit nuk sigurohet drejtësi as për viktimat dhe as për z.
18 Veseli.

19 Të nderuar Gjykatës, tani kaloj tek pika katër e
20 përgjithshme që ka të bëjë me irracionalitetin e
21 jashtëzakonshëm të këtij procedimi penal siç edhe pasqyrohet
22 në parashtimet mbyllëse të ZPS-së. Edhe pavarësisht
23 ndërhyrjeve që keni bërë ju, të nderuar Gjykatës, për ta
24 mbajtur nën kontroll të tërë situatën, argumentet e
25 Prokurorisë kundër z. Veseli nuk janë përmirësuar apo nuk janë

1 bërë më të kuptimshme. Dhe do t'i përmend këto gjatë kësaj
2 nënteme.

3 Po t'i hedhësh një sy hollësive të dosjes së ZPS-së dhe
4 poshtëshënimeve të pafundme atje, të cilat do t'i diskutoj më
5 vonë. Kjo është një veprimtari shumë e lodhshme që të lodh
6 trurin. ZPS-ja dëshiron të na çojë pikërisht në këtë drejtim
7 pasi ata nuk kanë argument të mbështetur. Pasi po të kishte
8 ndonjë gjë të ishte e tillë, do të mund të përmbledhej thjesht
9 në mënyrë të qartë përmes provave transparente. Nuk kishte
10 nevojë që të ekzistonte një dosje përfundimtare e cila të
11 ishte një grup poshtëshënimesh irelevante apo jo relevante, pa
12 mbështetje të ekzagjeruar përzgjedhëse të paplota, pasi ato
13 nuk ekzistojnë, nuk kishte nevojë.

14 Nuk ka nevojë që të duhet të kërkohet në turmë, në copëza
15 dokumentesh të paraqitura përmes procedurës jo gojore të cilat
16 përbëhen nga thashetheme e kështu me radhë, në dosjen
17 përfundimtare. Na jepni thjesht dëshmitë për këtë. Ajo që na
18 mbetet është që të kontrollojmë çdo poshtëshënim dhe
19 referencat të cilat përmbajnë për të parë nëse a mund të
20 gjendet ndonjë gjë, a ka ndonjë informacion për të gjetur,
21 ndonjë copëz informacioni lidhur me atë që mund të ketë thënë
22 dikush dikujt tjetër e kështu me radhë, është një procedim
23 penal i cili nuk është racional, i logjikshëm në shumë mënyra.
24 Dhe, të nderuar Gjykatës, po ju paraqes këtu se këto janë
25 të paprovuara. Ja një listë me dhjetë.

1 Njëshi. Që nga themelet e një rasti penal. Ata të cilët
2 kanë bërë ekzaminime të ADN-së dhe një pjesë e madhe e
3 ekspertëve patologjik nuk janë thirrur për dëshmitarë. Në
4 fakt, këta kanë thirrur të tjerë për të rishikuar konkluzionet
5 e tyre. Përse? Ne nuk jemi në gjendje që ta bëjmë një gjë të
6 tillë.

7 Dyshi. Nuk janë paraqitur dokumentet origjinale apo
8 kopje. Dhe nuk është bërë asnjë përpjekje nga ZPS-ja për t'i
9 siguruar ato pasi autoritetet serbe as nuk u përgjigjën kësaj
10 këtu. Të gjitha përpjekjet tona kanë thënë, "A mund t'i kemi
11 këto dokumentet origjinale?".

12 Dhe ne kishim dëshirë që para këtij Trupi Gjykues t'i
13 analizonim ato, por Mbrojtja tha "A mund t'i kemi këto?" dhe
14 përgjigja nuk erdhi. Zyrtarët serbë të cilët mund të kishin
15 dhënë dëshmi këtu as nuk u thirrën për të dhënë dëshmi dhe u
16 hoqën nga lista e dëshmitarëve.

17 Së treti. Dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja ishin të
18 thirrur si dëshmitarë të vërtetësisë, pra, për provimin e
19 vërtetësisë në mbështetje të qëndrimit të tyre, por në të
20 njëjtën kohë ne kemi parë që ZPS-ja ka sulmuar në të njëjtën
21 kohë dëshmitarë. Dhe ndërkohë kemi persona të vërtetë nga të
22 cilët ZPS-ja nuk ka marrë përgjigje, ndërkohë gënjeshtarëve iu
23 ka dhënë mundësitë për të dhënë përgjigjet e tyre. Kështu si
24 është e mundur që Gjykata të mbështetet në pjesë të caktuara
25 të dëshmitarëve për të dhënë vendim fajësie përtej dyshimit të

1 arsyeshëm. Ndërkohë që për të tjerë mund të thotë që nuk mund
2 të besohen për asnjë aspekt. Ndërkohë që ka pasur persona që
3 kanë gënjyer nën betim duke mos ju thënë të vërtetën dhe duke
4 fshehur krimet.

5 Së katërti. ZPS-ja ka vonuar, e ka vonuar hapjen e
6 çështjes së tyre, duke thënë që ata nuk kanë detyrimin që ta
7 bëjnë një gjë të tillë dhe këtë e kanë bërë deri në fund në
8 kuptimin e vonesave për ndarjen e dokumenteve me ne. Dhe nga
9 ana tjetër, nuk e ka bërë as të qartë se cila është çështja e
10 tyre. Edhe kur janë munduar që të na thonë se cili është
11 qëndrimi i tyre, e vërteta është që ne nuk e kemi kuptuar dhe
12 sot e kësaj dite, nuk e kemi të qartë. Ndërkohë që kjo ka
13 ndodhur me kaq shumë dëshmitarë nga UÇK-ja dhe me dëshmitarë
14 të tjerë jo vetëm të UÇK-së. ZPS-ja çka thotë? Thotë që këta
15 janë persona të besueshëm, të pabesueshëm, a nuk po tregojnë
16 të vërtetën dhe si rezultat nuk janë të besueshëm apo janë dhe
17 këta pjesë e kësaj NKP-je të gjerë që mbase në thelb nuk mund
18 të përfshijë çdokënd që ka qenë pjesë e UÇK-së? Dhe ZPS-ja nuk
19 është në gjendje të na e thotë këtë gjë sepse nuk ka prova.

20 Shihni pak qasjen që ka ZPS-ja me z. Zyrapi, është një
21 çështje të cilën e diskutoi gjerë e gjatë z. Misetic dje.
22 Megjithatë dua të shtoj disa pika të tjera të rëndësishme për
23 klientin tim. Për herë të parë në dosjen e tyre përfundimtare
24 ZPS-ja parashton që z. Zyrapi nuk ishte në rrethin e
25 brendshëm të Shtabit të Përgjithshëm, nuk e di se çfarë do të

1 thotë ZPS-ja me këtë. Domethënë, një herë thotë rrethi pastaj
2 rrethi i brendshëm? Domethënë kjo është diçka të cilën nuk e
3 kemi diskutuar asnjëherë më përpara. Nuk i është parashtruar
4 asnjë dëshmitari dhe nuk është fare e qenësishme. Dhe ZPS-ja
5 duket e pazgjuar që të mbështetet te Zyrapi si një dëshmitar i
6 mirë ose si person i mirë që qëndronte në zemër të Shtabit të
7 Përgjithshëm pastaj nga ana tjetër pretendon që ka pasur një
8 NKP të mbështetur në kolektivitetin e të gjithë ose me të
9 gjithë anëtarësinë e Shtabit të Përgjithshëm, por ku
10 përjashtohet ky burrë i ndershëm. Domethënë, me një fjali të
11 vetme, ZPS-ja, pra, e quan dikë që ka qenë në zemër të Shtabit
12 të Përgjithshëm si një person të jashtëm.

13 Por pastaj pjesë të caktuara të dëshmisë së z. Zyrapi që
14 i shkojnë për shtat ZPS-së, ZPS-ja i pranon. Për shembull, kur
15 ai thotë, kur z. Zyrapi thotë që detyra e z. Veseli do të
16 ishte që të merrte raporte për bashkëpunëtorët në zona dhe të
17 informonte sektorin ligjor. Çuditërisht edhe menjëherë,
18 befasisht, Zyrapi përsëri bëhet faktor kryesor dhe në këtë
19 rast ZPS-ja e konsideron z. Zyrapi si pjesë të rrethit të
20 brendshëm. Por, kini parasysh dhe, besoj, që e keni lexuar dhe
21 vetë, që ZPS-ja e ka theksuar me dhjetëra e dhjetëra e
22 dhjetëra herë që ai duhet të kishte ditur. Por nga ana tjetër
23 prova dhe dëshmia e dhënë prej tij në këtë gjyq është cituar
24 rreth 992 herë në këtë dosje, në dosjen përfundimtare të ZPS-
25 së.

1 Pastaj në të njëjtën kohë ZPS-ja thotë që Zyrapi nuk
2 është i ndershëm sa i takon njohurive që kishte ai për veprat
3 penale të UÇK-së. Pra, ZPS-ja thotë që Zyrapi lidhur me këtë
4 aspekt nuk është i besueshëm. Po pse nuk qenka Zyrapi për këtë
5 aspekt i arsyeshëm dhe i besueshëm? ZPS-ja thotë për shkak të
6 rolit të vet, domethënë, ai ka gënjyer për shkak të rolit të
7 vet sepse për shkak të rolit që kishte duhet të kishte pasur
8 njohuri për krimet. Pra, përsëri ZPS-ja ndërron mendje.
9 Domethënë, thotë duhet të ketë gënjyer lidhur me
10 kriminalitetin e bërë nga UÇK-ja sepse ishte në nivel kaq
11 shumë të lartë. ZPS-ja këtë pyetje nuk ia ka bërë asnjëherë
12 Zyrapit, nuk i ka thënë asnjëherë që nuk i je i ndershëm dhe i
13 sinqertë. Dhe, sigurisht, që ZPS-ja duhet ta thotë këtë sepse
14 në kundërtën nuk ka ku të mbështetet.

15 Më pas vazhdojmë me një tjetër gjë që nxjerrë nga sënduku
16 i vjetër ZPS-ja, frikësimi. Kur nuk ka asnjë vend tjetër për
17 të shkuar, ZPS-ja shkon dhe luan kartën e frikësimit. Dhe
18 prova nuk ka fare se po të kesh prova është tjetër gjë.
19 Megjithatë pavarësisht që nuk ka fare, fare prova, ZPS-ja luan
20 kartën e frikësimit. Jo vetëm kaq, po ZPS-ja nuk e ka trajtuar
21 fare me z. Zyrapi këtë gjë sikurse e dini, por thotë që z.
22 Zyrapi për këtë aspekt po gënjen për shkak të situatës dhe
23 klimës së gjatë të frikësimit. Ky është një person të cilin
24 ZPS-ja e ka cituar me mijëra herë. I ka përdorur deklaratat e
25 përgjithshme të tij si konfirmuese herë pas here, por pastaj

1 nga ana tjetër thonë që dëshmia e tij dhe e vërteta e tyre
2 njollosen nga frikësimi. Por pse mund të thotë ai diçka që
3 mund të përdoret për të pretenduar që bashkëpunëtorët
4 ndiqeshin nga Shtabi i Përgjithshëm në qoftë se do ishte -- do
5 kishte qenë kaq shumë i tmerruar dhe do të duhet të mbronte
6 veten?

7 Dhe pavarësisht kësaj ZPS-ja dëshiron që të ngasë jo kuaj
8 po pesë kuaj në të njëjtën kohë. Pra, nga njëra anë thotë që
9 është një person i brendshëm që ka njohuri të vërteta, thotë
10 që personi nuk është pjesë e rrethit të brendshëm, ka gënjyer
11 lidhur me kriminalitetin e UÇK-së sepse duhet ta kishte ditur
12 për shkak të rolit që kishte, por ka të drejtë kur flet për
13 bashkëpunëtorët, por megjithatë pavarësisht të gjithave është
14 i frikësuar.

15 Pse e bën Prokuroria këtë gjë? Këtë nuk kuptojmë. Arsyeja
16 është sepse ata nuk kanë asnjë çështje kundër z. Veseli,
17 kështu që duhet të shpërndahen në të gjitha drejtimet e
18 mundshme si në cirk, në mënyrë që të gjejnë diçka kundër tij.
19 Dëshpërimi të bën qesharak sipas nesh.

20 Në qoftë se ZPS-ja ju thotë ju, të nderuar Gjykatës, që
21 asaj i duhet që të ishte novatore për të testuar këto çështje
22 të mëdha ndërkombëtare, me të gjitha këto lloj dinamikash të
23 ndryshme, unë do parashtroja që kjo nuk është përgjigje e
24 besueshme. Se kur nuk ka prova, provat janë e vetmja rrugë që
25 duhet të ndjekin prokurorët. Në qoftë se nuk ke prova thjesht

1 mos ngri aktakuzë. Standardet nuk mund të zbriten, nuk mund të
2 ulen për pretekstin e luftës për drejtësi ose për arsye të
3 ndryshme që mund t'i përmendë ZPS-ja.

4 Numri pesë, të nderuar Gjykatës. Personat të cilët mund
5 të kishin dhënë prova për të mbështetur çështjen e Prokurorisë
6 çuditërisht asnjëherë nuk janë thirrur si dëshmitarë në këtë
7 gjykim nga Prokuroria. Për shembull, dëshmitarë, që sipas ZPS-
8 së pretendojnë se klienti im ka qenë i përfshirë në vepra
9 penale, nuk janë thërritur prej Prokurorisë. Por në vend të
10 tyre Prokuroria ka thërritur personat të cilët kanë dëgjuar
11 fjalë nga palë të dytë, palë të treta.

12 Për personat e marrë të cilët unë i përmenda dje,
13 dëshmitari burimor tek i cili është mbështetur ZPS-ja nuk
14 është thirrur fare për të dhënë dëshmi. Pse e bën ZPS-ja këtë
15 gjë? Dëshmia e tij, kur është treguar nga një dëshmitar tjetër
16 që kishte dëgjuar prej këtij të parit, nuk e ka konfirmuar
17 fare që z. Veseli ishte përfshirë. Për këtë arsye nuk e ka
18 thirrur Prokuroria, sepse dëshmitari nuk do thoshte që z.
19 Veseli kishte ndonjë lidhje me këtë pikë që në fakt ai nuk e
20 kishte siç e keni dëgjuar të gjithë? Kjo edhe një herë thekson
21 nevojën që personat duhet të vinin këtu në mënyrë të
22 drejtpërdrejtë për të dhënë dëshmi. Dhe nuk kemi asnjë provë
23 të drejtpërdrejtë përveçse fjalë që kanë qarkulluar dhe përveç
24 dhënie dëshmish mbështetur në ato çfarë kanë dëgjuar persona
25 që ka thirrur Prokuroria.

1 Së gjashti. ZPS-ja ka vendosur të mos thërrasë ata
2 dëshmitarë që i ka përdorur për konfirmimin e aktakuzës. Ne
3 kemi llogaritur që janë rreth të paktën 13 dëshmitarë,
4 përfshirë këtu dhe ndërkombëtarë, të cilët mund të kishin
5 ardhur dhe të kishin dhënë dëshmi për çështje që kanë të bëjnë
6 me zbulim-kundërzbulimin dhe të cilët Prokuroria vendosi të
7 mos i thërriste fare.

8 Por pse ZPS-ja nuk i ka thirrur këta dëshmitar kur ata
9 mund të kishin ardhur, ndërkohë që këta janë persona në të
10 cilët ZPS-ja është mbështetur për konfirmimin e aktakuzës?

11 Së shtati. Dëshmitarë kryesorë tek të cilët janë
12 mbështetur akuzat ndaj z. Veseli nuk kanë marrë asnjëherë
13 pjesë në këtë sallë gjyqi. Besoj se ju kujtohet apo jo, të
14 nderuar Gjykatës, që kemi pritur e kemi pritur që Dëshmitari
15 W04747 të vinte dhe të jepte dëshmi. Edhe pse ky person kishte
16 qenë shumë i shprehur në media, pra, kishte folur gjatë e
17 gjerë në media lidhur me akuzat e tij. Përsëri ZPS-ja vendos
18 të mos e thërrasë atë. Po pavarësisht kësaj ZPS-ja ende
19 mbështetet tek ai pa pasur një konfirmim aktual sikur kjo të
20 mos kishte pikë rëndësie fare. Çfarë mënyre e rehatshme për
21 Prokurorinë për të bërë ndjekje penale? Qëndrimi i Prokurorisë
22 është që le t'i bëjmë gjërat me shkrim dhe të mos tregojmë
23 asgjë. T'ju japim mundësinë dëshmitarëve që të kundërpyeten
24 prej nesh edhe për t'u ekspozuar që ata janë gënjeshtarë. Pra,
25 në këtë pikë, nuk e di fare se pse e kanë marrë mundimin të

1 ngrejë një aktakuzë Prokuroria? Prokuroria e dinte që në qoftë
2 se këta dëshmitarë do të thërriteshin ata do bëheshin copë e
3 çikë në kuptimin e pyetjeve të bëra prej nesh.

4 Së teti. Tre anëtarë të NKP-së janë thërritur nga ZPS-ja
5 për të dhënë prova për Prokurorinë, këta janë: Sylejman
6 Selimi, Rrustem Mustafa dhe Shukri Buja. Nuk është dhënë asnjë
7 lloj shpjegimi fare se pse ata janë pjesë e NKP-së dhe
8 udhëheqës të tjerë nuk janë. Atyre nuk iu bë asnjë pyetje
9 lidhur me kontributin që kanë dhënë kur ishin në sallën e
10 gjyqit dhe nuk është se ata dinin më shumë informacion sot
11 sesa kanë ditur vite më përpara. Ata janë identifikuar si
12 pjesë të rrethit të brendshëm apo i ka identifikuar Prokuroria
13 si një pjesë e një rrethi tjetër. Dhe kjo mungesë
14 racionaliteti është e rëndësishme sepse ZPS-ja mbështetet në
15 dëshminë e tyre duke u përpjekur që të sigurojë një vendim
16 fajësie për klientin tim pa marrë parasysh qoftë edhe për një
17 moment të vetëm se mbase ata po përpiqeshin të mbronin veten.
18 Nuk kanë shtjelluar asgjë me ta. Ata pretendojnë që të jenë
19 kriminelë lufte dhe në fakt dy prej tyre kanë vendim fajësie
20 për krime lufte. Si mundet ZPS-ja, pa iu dridhur qerpiku, të
21 ndërtojë ndonjë pjesë të çështjes së tyre mbështetur në
22 dëshmitë e këtyre personave?

23 Për shembull, ZPS-ja mbështetet tek Sylejman Selimi në
24 një pjesë të intervistës së UNMIK-ut lidhur me lidhjen e
25 pretenduar të z. Veseli me z. Geci edhe pse pretendimi që

1 ngrihet në atë intervistë nuk përfshihet në aktakuzë, në fakt,
2 nuk është ngritur asnjë akuzë nga asnjë vend lidhur me këtë
3 pretendim të dhënë në intervistë dhe z. Veseli ju shpjegoi
4 plotësisht ju, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykses, se çfarë
5 donte të thoshte ai kur ka dhënë këtë intervistë. Megjithatë,
6 sikurse e kam shtjelluar dhe me të gjatë marrjes në pyetje të
7 tij prej meje, ai kishte çdo arsye që të shpëtonte veten dhe
8 të thoshte: Shiko personin tjetër, shiko zbulim-
9 kundërzbulimin, mos më shih mua. Dhe kjo është diçka, është
10 një aspekt kryesor të cilin ZPS-ja absolutisht e ka
11 anashkaluar. Por unë dua ta cek këtë element sepse më duhet të
12 mbroj të drejtat e klientit tim. Pavarësisht të gjithë kësaj,
13 ZPS-ja nuk thellohet më tej por thjesht citon një pjesë të
14 vogël të dëshmisë së tij, ndërkohë që nuk merret fare me
15 standardet kriminale. Nuk ka asnjë provë të besueshme që z.
16 Veseli ka qenë përgjegjës për z. Geci dhe e ka udhëzuar atë
17 për asnjë prej krimeve të pretenduara ose për asnjë gjë
18 tjetër.

19 Po ashtu ekziston një Geci tjetër që Prokuroria u mundua
20 që ta lidhte me z. Veseli, nuk e kam fjalën këtu për Sabit
21 Gecin si pjesë e NKP-së, po e kam fjalën për një tjetër Geci,
22 për një tjetër Sabit Geci. Gjithsesi këtij aspekti do t'i
23 drejtohem, do ta trajtoj më poshtë.

24 Pika e nëntë. Qasja e ZPS-së për nxjerrën e provave
25 lidhur me dokumentet dhe pranimin e dokumenteve ishte

1 tërësisht jo logjike. Kur vinte një dëshmitar këtu që mund të
2 komentonte një dokument të caktuar, ata nuk i kërkonin
3 dëshmitarit që të komentonte dokumentin, po pastaj kur vinte
4 dikush tjetër që s'e kishte idenë për dokumentin e pyesnin për
5 dokumentin. Por, sigurisht, domethënë, kur je i frikësuar se
6 çfarë mund të thotë dëshmitari është me e sigurtë që të
7 kërkossh pranimin e provave jогоjore.

8 Dhe, për shembull, kur dëshmitarët vinin këtu e thonin
9 që, unë nuk di asgjë lidhur me këtë temë. Të nderuar Gjykatës,
10 besoj se ju kujtohet se sa herë ka ndodhur kjo dhe sa herë kam
11 qëndruar në këmbë në kundërshtim të pyetjeve. Sa herë ka
12 ndodhur që dëshmitarët thonin që nuk dimë asgjë lidhur me
13 dokumentet dhe, pavarësisht kësaj, ZPS-ja thoshte që nuk është
14 e nevojshme që të krijohet lidhja midis dokumentit, thjesht
15 jepni informacion të përgjithshëm. Ose madje edhe më keq edhe
16 kur nuk kishin arsye për të kundërshtuar dokumentin që iu
17 tregohej. Shpesh dëshmitarëve iu kërkohej që të lexonin
18 dokumentin, domethënë, nuk kishte fare lidhje dokumenti me
19 personin, nuk kishte të bënte fare pyetja me prejardhjen ose
20 me origjinën e dokumentit, ishte thjesht një ushtrim leximi
21 dhe atëherë kur bëheshin pyetje prej Prokurorisë.

22 Po ashtu ZPS-ja ka kundërshtuar pranimin e dokumenteve
23 nga Mbrojtja dhe kur voliste, për shembull, ka pasur një
24 kundërshtim të ZPS-së dhe kjo jepet në transkript në faqen
25 T26886.

1 Dhe ajo çfarë dua të them, pika thelbësore është që ZPS-
2 ja e ka për detyrë të tregojë që këto janë dokumente autentike
3 në qoftë se do që të mbështetet në vërtetësinë e përmbajtjes
4 së tyre. Ajo çfarë është më e rëndësishme për z. Veseli është
5 që ZPS-ja duhet që të vërtetonte që këto dokumente janë marrë
6 dhe që këto dokumente lidheshin me z. Veseli. Vetëm fakti në
7 vetvete që këto dokumente mund të ekzistonin edhe në rast se
8 vërtetohej që ato janë autentike, nuk vërteton se këto
9 dokumente janë dërguar, janë rishikuar, janë zbatuar ose që
10 këto dokumentet janë realizuar. Mund të jetë thjesht një
11 letër, një dokument, nuk tregon asgjë në qoftë se nuk krijon
12 lidhjen midis dokumentit përkatës dhe personit që akuzon. Tani
13 dëshiroj që të theksoj disa elementë të tjerë të rëndësishëm
14 dhe këtu do të kaloj tek pika e radhës që është pika dhjetë.

15 Edhe në këtë rast në këtë çështje gjyqësore kemi pasur
16 një person që ka qenë roje i të akuzuarve në burg, ka pasur
17 qasje në qelitë e tyre dhe më pas u bë prokuror i tyre dhe ka
18 ardhur i ka akuzuar ata këtu në Gjykatë ndërkohë që dëshmia e
19 tij është quajtur dëshmi e dëshmitarit.

20 Këto janë pikat kryesore. Sigurisht që ka shumë pika të
21 tjera që unë mund të rendis.

22 Megjithatë mund ta dini, të nderuar Gjykatës, që ditët e
23 sotme gjykimet ndërkombëtare nuk janë aq të shpeshta. Dhe ne
24 parashtrojmë që ZPS-ja nuk duhet ta kishte humbur këtë mundësi
25 dhe nuk duhet t'i kishte vendosur fare të akuzuarit, po në

1 veçanti klientin tim përpara këtij gjykimi. Çfarë nuk do
2 kishin bërë vende të tilla si Ukraina, Sudani, Palestina,
3 Afganistani, Miamari, Venezuela, Irani e shumë e shumë vende
4 të tjera që të kishin mundësinë që të vendosnin drejtësi,
5 mundësi që e ka pasur të plotë ZPS-ja me bashkëpunimin dhe
6 mbështetjen e plotë të Kosovës dhe në vend që ta kishte bërë
7 punën e vet në mënyrë të përkorë, ZPS-ja thjesht ngre një
8 çështje vetëm për një anë të konfliktit dhe nuk e bën punën e
9 vet siç duhet.

10 Mendojmë, të nderuar Gjykatës, që është e rëndësishme të
11 theksohet që Kosova e ka nisur dhe e ka mbështetur këtë
12 Gjykatë ndërkombëtare. Kosova është një vend i vogël. Ndërkohë
13 që ngjarjet që mbulon kjo çështje gjyqësore kanë ndodhur 25
14 vite më përpara, ndërkohë që procesi gjyqësor nuk është se
15 ndiqet shumë jashtë Kosove. Megjithatë në një peizazh
16 ndërkombëtar, pra, përfshinë shtete të cilat atashohen me
17 gjykatat ndërkombëtare dhe është e rëndësishme që të theksohet
18 që Kosova ka dhënë mbështetjen e plotë, kështu që për këtë
19 arsye angazhimi i Kosovës ndaj drejtësisë duhet që të
20 përgëzohet dhe duhet të jepet roli që meriton në shtete dhe në
21 kombe të ndryshme në botë dhe duhet që t'i sigurohet
22 respektimi i sundimit të ligjit.

23 Sikurse e kam theksuar, rëndësia e DHSK-së për Kosovën
24 është absolutisht shumë e rëndësishme për sundimin e ligjit
25 dhe për pajtime të ardhshme edhe për një vend të tillë të

1 vogël që nuk është në qendër të vëmendjes së botës apo që nuk
2 tërheq vëmendjen kryesore në titujt e gazetave ose të lajmeve
3 kryesore, përsëri është shumë e rëndësishme që të merret
4 parasysh gjithë mbështetja e vendit për këtë Gjykatë.

5 Autoritetet serbe dhe mbështetja e tyre për këtë Gjykatë
6 po ashtu duhet të merren parasysh, në veçanti kur flitet për
7 qëllime forensike për vlerësimin e provave që ata i kanë dhënë
8 Gjykatës. Sikurse e kam theksuar dhe më herët, në aspektin
9 intelektual nuk është e ndershme të argumentosh që mund të
10 anashkalosh politikat serbe dhe dominimin serb ndërkohë që
11 vlerësohet nëse UÇK-ja në thelb ka pasur të njëjtën politikë
12 dhe në të njëjtën kohë të thuash që ka shkuar në drejtim
13 tjetër. Dhe për këtë arsye është mirë që të shikohet konteksti
14 më i gjerë i zhvillimeve. Ju nuk mund të injoroni atë çfarë ka
15 bërë Serbia sikurse Serbia të ishin thjesht dele që kalonin
16 gjatë natës. Ky është rast klasik i dy standardeve të ndryshme
17 të përdorura nga ZPS-ja.

18 Dëshmitë tregojnë se sistemi i aparteidit është ushtruar
19 nga Serbia në këtë kohë. Ky është një sistem që e ka
20 zanafillën në Afrikën e Jugut që fatmirësisht i dha fund këtij
21 sistemi në fillim të viteve 1990, ndërkohë kjo situatë po
22 shkonte në drejtim të kundërt e po përshkallëzohej në Kosovë.
23 Dhe ndërkohë që autorët e veprave kërkuar pajtim në Afrikën e
24 Veriut dhe kërkuar ndjesë për ato çfarë kishin bërë, në Kosovë
25 arkitektët serbë dhe ekzekutuesit bënë të kundërtën. Ata

1 akuzuan persona që kanë vuajtur nën atë sitëm dhe kërkuan që
2 këta që kishin vuajtur të gjykoheshin dhe, në fakt, ata jo
3 vetëm kaq por edhe dhanë provat që kjo të bëhej për t'i thënë
4 ndërkombëtarëve që, ju kemi thënë që këta të UÇK-së janë
5 rrugaçë, janë të pabindur, ne kemi pasur të drejtë për atë
6 çfarë kemi bërë në Kosovë. Dhe donim që ky sistem aparteidi të
7 validohej, të vlerësohej.

8 Dhe Gjykata duhet që të shikojë me kujdes dëshmitë e
9 dhëna nga shteti serb, ashtu siç është bërë në Afrikën e Jugut
10 apo në vende të tjera, pra, duhet të shikohen motivimet më të
11 thella dhe origjina e dokumenteve apo e dëshmive të caktuara.
12 Dhe duhet kushtuar rëndësi e veçantë dokumenteve që janë dhënë
13 nga këto autoritete. Sigurisht që do cekim poshtëshënimet e
14 dokumente të tjera, duhet trajtuar gjithashtu edhe
15 autenticiteti, zinxhiri i ruajtjes e të tjerë.

16 Pra, ky është një element i rëndësishëm që duhet të
17 merret parasysh. Siç ka vendosur edhe Dhoma e Apelit sa i
18 takon apelit që kishte me përgjimet. Pra, është e rëndësishme
19 që të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Dhe sipas
20 Dhomës së Apelit është shumë e rëndësishme që të shikohen me
21 shumë imtësi provat që janë dhënë nga autoritetet serbe lidhur
22 me përgjimet dhe me dokumente të tjera. Ne parashtrojmë që kjo
23 është diçka që duhet ta bëni realisht. Se është tjetër gjë që
24 t'i japësh të gjitha dokumentet në grup pa vënë në diskutim
25 asnjë prej tyre, por është tjetër gjë që të shohësh me hollësi

1 se çfarë origjine kanë këto dokumente, çfarë autenticiteti
2 kanë ato dhe kjo duhet të bëhet absolutisht në shumë hollësi
3 si punë. Ne parashtrojmë që këto dokumentet nuk janë
4 autentike. Në çdo rast edhe në qoftë se do e shikonim në pamje
5 të parë, domethënë, këto janë dokumente të cilat nuk
6 konfirmohen nga burime të tjera. Po thjesht janë një piriq
7 dokumentesh që kanë ardh nga Beogradi dhe asgjë më tepër sesa
8 kaq.

9 Së fundi, të nderuar Gjykatës, unë thashë që nën këtë
10 titull do cek edhe ndërhyrjet tuaja.

11 Z. Emmerson, i ndihmuar në atë kohë nga z. Andrew Strong,
12 tha në deklaratën e tij hapëse se ju, të nderuar Gjykatës, do
13 të prisni më kot për prova kundër z. Veseli. Dhe kjo pritje
14 frustruese mbase do t'ju bënte ju, të nderuar Gjykatës, që të
15 merrnit në pyetje dëshmitarët. Dhe kjo është diçka të cilën ne
16 e kemi përsëritur herë pas here dhe nuk do merrem më shumë
17 kohë këtu. Por pyetje sqaruese duhet që të bëheshin nga
18 gjyqtarët për shkak të përshtypjes që krijonin përgjigjet.
19 Sepse ne gjatë gjithë kohës kemi thënë që Prokuroria ka qenë
20 në rehatinë e vet dhe nuk është cenuar. Dhe nga ana tjetër ka
21 pasur edhe shqetësim minimal. Dhe shumë pak pyetje plotësuese
22 kanë ndodhur. Për shembull, pashë të gjitha të dhënat
23 përkatëse, për shembull, pash numrin e minutave të shpenzuara
24 nga ju, të nderuar Gjykatës. Ndërkohë që pyetjet kanë qenë të
25 shumta.

1 Domethënë, të nderuar Gjykatës, ne mund të kemi një debat
2 shumë të rëndësishëm, domethënë, mund të flasim pa fund për të
3 drejtën zakonore, për të drejtën civile, për sistemin
4 inkuizitor, e të tjerë e të tjerë, jam i sigurtë që ky është
5 një debat i cili do zhvillohet nga gjykata të tjera në të
6 ardhmen, megjithatë nuk është se do e shtjelloj shumë në
7 hollësi këtu. Por dua të them që pavarësisht nga metodat e
8 përdorura edhe me prova të cilat kanë dalë nga pyetjet tuaja,
9 të nderuar Gjykatës, ju, të nderuar Gjykatës, nuk qetë në
10 gjendje që t'i sqaronit gjërat deri në fund.

11 Ju, besoj, që keni vënë re që ZPS-ja i ka cituar pyetjet
12 tuaja, të nderuar Gjykatës, 36 herë, janë pyetje që janë bërë
13 prej jush për z. Veseli vetëm në lidhje me çështje të
14 inteligjencë-kundërinteligjencës. Dhe pavarësisht që nuk
15 ekziston asnjë provë për vërtetimin ose konfirmimin e
16 qëndrimit të Prokurorisë ndaj z. Veseli pyetjet kanë qenë të
17 shumta.

18 Sa për t'ju dhënë një ilustrim dua që t'ju referohem
19 paragrafit 517, poshtëshënimi 2130, këtu thuhet që Veseli ka
20 pasur përgjegjësi dhe ka mbikëqyrur shërbimet e zbulim-
21 kundërzbulimit të UÇK-së - dhe në bashkëpunim me policinë
22 ushtarake - duke identifikuar dhe duke marrë masa kundër
23 oponentëve. Domethënë, vetëm kundër oponentëve, që është një
24 deklaratë shumë e gjerë e bërë prej Prokurorisë. Ndërkohë janë
25 bërë, në qoftë se do i referohemi, për shembull, Trupit

1 Gjykues të z. Mustafa. Dhe në qoftë se do i referohemi
2 transkriptit në faqen 5905 deri në 5907 ku iu bë pyetje lidhur
3 me një deklaratë të z. Humolli që ishte përgjegjës për
4 identifikimin e bashkëpunëtorëve dhe për kalimin ose
5 transmetimin e këtij informacioni.

6 Dhe në përgjigje ai thotë:

7 "Unë e di që shërbimi i zbulim-kundërzbulimit nuk u
8 konsolidua asnjëherë.

9 "Unë nuk e di se kujt mund t'i kenë raportuar persona sa
10 i takon sektorit të zbulim-kundërzbulimit sepse ky është një
11 sektor që nuk ka qenë funksional."

12 Pra, kur është pyetur se kush ishte përgjegjës për ta
13 bërë këtë gjë, kjo ishte përgjigja. Përgjigja ishte që nuk
14 kishte sektor inteligjence ose zbulim-kundërzbulimi nuk ka
15 qenë funksional. Ndërkohë që z. Humolli është një prej këtyre
16 dëshmitarëve që unë e përmenda më herët dhe ZPS-ja ka marrë
17 një deklaratë dëshmitari prej tij. Por ky person nuk u thërrit
18 asnjëherë në Gjykatë për të dhënë dëshmi përpara Trupit
19 Gjykues.

20 Kjo dëshmi qartë nuk mbështet pretendimin bosh të ZPS-së
21 që z. Veseli ishte përgjegjës për policinë ushtarake, për
22 identifikimin ose për marrjen e masave ndaj të gjithë
23 oponentëve. Dhe ZPS-ja nuk citon gamën, larminë e gjerë të
24 provave që tregojnë që z. Veseli nuk kishte asnjë kontakt me
25 personat e zbulim-kundërzbulimit në zona. Personat kanë ardhur

1 dhe e kanë thënë këtu në Gjykatë, e kanë thënë troç që ata nuk
2 i kanë raportuar asnjëherë z. Veseli, nuk ka marrë urdhra prej
3 tyre. Pra, sipas nesh, ZPS-ja ka qenë skajisht selektive në
4 atë çfarë ka vendosur që t'i paraqesë Trupit Gjykues.

5 Nuk ka asgjë në prova të nxjerra, të nderuar anëtarë të
6 Trupit Gjykues, që lejojnë një çështje të ngrihet kundër
7 klientit tim përveç asaj që ZPS-ja është përpjekur që ta bëjë
8 tani. Dhe të akuzuarit nuk mund të dënohen për asnjë çështje
9 për të cilat ZPS-ja nuk është shprehur qartazi dhe për të
10 cilën ekipet e Mbrojtjes nuk kanë marrë njoftim të duhur.

11 Pika kryesore që ne duam të ngremë lidhur me -- është se
12 pyetjet e ZPS-së të marra së bashku, të nderuar Gjykatës, nuk
13 kanë paraqitur asnjë provë kundër z. Veseli që nuk afrohet
14 fare standardit penal të vërtetimit përtej dyshimit të
15 arsyeshëm, duhet të jetë e vështirë të identifikohet apo
16 gjendet ndonjë *maxim* apo ndonjë shprehje ligjore më thelbësore
17 e kuptimit të drejtësisë ndërkombëtare. Pra, kjo jep mbrojtjen
18 përfundimtare në këtë çështje jo vetëm për z. Veseli por edhe
19 për Gjykatën. Në fakt historia e këtij parimi zbulon se në
20 origjinë kjo kishte të bënte me kohën e mesjetës për mbrojtjen
21 e gjykatësve, anëtarëve të jurisë dhe gjykatës, synimi ishte
22 që t'ju garantohej atyre se ata ishin të sigurtë për këtë
23 standard, në nivel të standardit që do të shpallnin dikë
24 fajtor pa rrezikuar jetën e tyre.

25 Tani këtu në sistemin e *cammon law*, pra, të drejtës

1 anglosaksone dhe kontinentale, të dyja së bashku ne nuk kemi
2 nevojë të marrim -- nuk kemi nevojë të hyjmë në një debat
3 tjetër akademik. Shprehja informacioni *dubio pro reo, in*
4 *dubio*, masa në prani të dyshimit, duhet të vendoset në favor
5 të të pandehurit, që vjen nga e drejta kanonike romake e
6 Evropës kontinentale dhe lidhet ngushtë me zhvillimin e
7 standardit të dyshimit të arsyeshëm nga e drejta anglosaksone.
8 Këtu duken që kanë si origjinë kërkimin e doktrinës, pra, bazë
9 doktrinën e "rrugës më të sigurtë". Pra, që në prani që
10 dyshimeve, një gjykatës duhet të zgjedhë rrugën më të butë që
11 është pjesa e ndërgjegjes të pastër, të sigurtë, për të mos
12 dënuar një person. Ndërkohë që ekzistojnë qoftë dhe mundësia
13 më e vogël e pafajësisë së tij.

14 Të nderuar Gjykatës, tani do t'ju përgjigjem në hollësi
15 poshtëshënimeve të dosjes së ZPS-së në parashtrimet e tyre
16 gojore dhe do ta bëj në tre pjesë, më në hollësi, duke
17 përdorur shembuj konkret që tregojnë se ata nuk e kanë bazuar
18 apo mbështetur në mënyrë të duhur pretendimet e tyre
19 ekstravagante që paraqesin dhe do ta bëj këtë në pjesë duke
20 përdorur disa shembuj. Do të shoh përfshirjen e
21 drejtpërdrejtë. Thashë që ishin disa copëza tek të cilat do
22 kthehem, do t'i trajtoj. Dhe do t'i lidh së bashku. Së dyti do
23 të shohim NKP-në dhe paragrafët dhe citimet në të cilat ata
24 mbështeten, pra, ZPS-ja. Dhe pastaj, në fund, do të shohim
25 format alternative të përgjegjësisë, përfshirë formën eprore

1 të përgjegjësisë.

2 Së pari, pjesëmarrja e drejtpërdrejtë, të nderuar
3 Gjykatës.

4 Sidoqoftë, sido që të jetë, sado e madhe të jetë kjo nuk
5 mund të reduktohet tek disa copëza provash apo argumentesh që
6 Prokuroria -- në të cilën Prokuroria në thelb mbështetet. Dhe
7 ne parashtrojmë që kjo gjendet në paragrafin 515 të dosjes së
8 Prokurorisë për veprimet e drejtpërdrejtë, mbi të cilat ZPS-ja
9 mbështetet fuqimisht. Të nderuar Gjykatës, do të ishte e
10 dobishme që të konsultoheni dhe të shihni disa paragrafë gjatë
11 kohës që po vazhdoj të bëj paraqitjen. Por 515 është pjesa
12 qendrore apo më e fuqishme e provave të ZPS-së.

13 Në paragrafin vijues 516 pasi ata në paragrafin 515 thonë
14 se kjo është ajo që z. Veseli ishte i përfshirë në mënyrë të
15 drejtpërdrejtë, pastaj thonë:

16 "Kjo sjellje e përfshirjes së drejtpërdrejtë nuk ishte
17 rastësore apo aksidentale. Apo shembujt e pjesëmarrjes
18 personale të Veselit janë të konsiderueshëm jo vetëm sa i
19 takon synimit apo kontributit të shfaqur dhe të qartë për
20 qëllimin kriminal të përbashkët, por edhe sepse ata nxjerrin
21 në pah", këmbëngul këtu, "nxjerrin në pah dijeninë e gjerë që
22 kishte z. Veseli dhe pranimin, faktin që pranonte NKP-në në të
23 cilën Veseli -- pjesë e së cilës Veseli ishte në mënyrë të
24 vullnetshme."

25 Pra, në qoftë se pretendimet e drejtpërdrejtë bien poshtë

1 që duhet të bien poshtë dhe ne parashtrojmë që provat e ZPS-së
2 nuk qëndrojnë në këtë rast. Nëse z. Veseli nuk ishte i
3 përfshirë në asgjë penale, kriminale të drejtpërdrejtë që dhe
4 kështu është, ne e paraqesim këtë, atëherë kjo është e
5 thjeshtë bëhet fjalë për prova tërësisht rrethanore lidhur me
6 ekzistencën e NKP-së apo të paturit njohuri për krime. Pra,
7 kur bëhet kjo gjë, fakti që ai i ka bërë detyrat e tij, a ka
8 lëvizur, a është takuar me persona, siç tregohet në prova për
9 qëllime ushtarake, e gjitha kjo pa përfshirjen e tij të
10 drejtpërdrejtë në veprime të caktuara në të cilat ai nuk ka
11 qenë i përfshirë apo aktivitete kriminale. Pra, kjo ndryshon
12 tërësisht, rrënjësisht gjithçka.

13 ZPS-ja mbështetet në këto incidente për të thënë që ato
14 tregojnë synimin e tij për të kontribuar në NKP, tregojnë
15 njohurinë e tij për krime dhe përfundimisht tregojnë se ai
16 kishte përgjegjësi eprore gjithashtu. Pra, në qoftë se hiqen
17 të gjitha këto që ai nuk merrte pjesë në këto aktivitete në të
18 cilat Prokuroria mbështetet, siç ishte rasti i marrjes së
19 granatahedhësve, gjëra të tilla që mund të jenë bërë pa
20 njohurinë e tij apo pjesëmarrjen e tij.

21 Të nderuar Gjykatës, duhet të shohim incidentet e
22 përmendura së pari, paragrafin 515, për të vendosur lidhur me
23 këto, ne themi që duhet të vendosni në favor tonin në
24 mbështetje tonën dhe duhet t'i hiqni fare nga mendja dhe
25 pastaj të shikojmë në anën të majtë që janë provat rrethanore.

1 Duke filluar me 515 -- nuk duhet të lexoj të gjithë
2 paragrafin por është edhe ky një shembull themi i problemit
3 qendror të kësaj prove të Prokurorisë. Ata fillojnë duke thënë
4 që z. Veseli përmes një vendimi kolektiv të Shtabit të
5 Përgjithshëm emëroi Xhemë Gashin si kreu i njësisë së
6 Drenocit. Ky është shembulli i parë i pjesëmarrjes së
7 drejtpërdrejtë.

8 Tani kthehemi tek ky pretendimi i veprimit në mënyrë
9 kolektive që edhe ky nuk qëndron. Po më shumë se kaq,
10 përfshirja e pretenduar e z. Veseli kundërshtohet këtu nga
11 vetë provat e Prokurorisë. Por kur janë mbështetur në provën e
12 Dëshmitarit W04748 i cili nënvijëzoi apo emëroi një person nga
13 Shtabi i Përgjithshëm që ishte përgjegjës për këtë emërim por
14 nuk ishte z. Veseli në fakt ai person. Pra, përveç këtij
15 nocioni të veprimit në mënyrë kolektive që nuk ka asnjë kuptim
16 pretendimi totalisht bie poshtë bazuar, mbështetur në vetë
17 provat e Prokurorisë.

18 Të nderuar Gjykatës, duhet të shikoni secilin prej këtyre
19 poshtëshënimeve për të parë dhe të verifikohen dhe të
20 rriverifikohen dhe për të parë përmbajtjen e tyre por asnjë
21 prej tyre nuk shkon në favor të Prokurorisë.

22 Pjesa e dytë e 515(a) është heqja e dy, siç u përmend
23 dje. Prova të dorës së dytë të pavërtetuara, të pakonfirmuara.
24 Dhe pastaj kalojmë në 515(b) që është pretendimi se ai ka qenë
25 i pranishëm gjatë transferimit dhe lirimit të dy personave në

1 fjalë që u hoqën. Ky është incidenti i Kleçkës që përmenda dje
2 por nuk do të përsëris, thjesht dua të shtoj se sa -- të
3 theksoj kontrastin e madh që është këtu mes këtyre lloj
4 provave që kërkohen për të mbështetur këtë dhe këto nuk
5 ekzistojnë.

6 ZPS-ja nuk ka identifikuar lidhur me këto incidente, siç
7 e thashë dje, asnjë model apo praktikë koherente përputhëse
8 apo prova të tjera që lidhen me pretendimet për pjesëmarrjen e
9 drejtpërdrejtë të z. Veseli. Apeli i Shalës, sipas
10 parashtrimit tonë, është burim që duhet të përdoret sipas nesh
11 në këtë çështje lidhur me provat që duhet të jenë të
12 mjaftueshëm por që qartësisht nuk ekzistojnë në rastin e
13 Veselit.

14 Kjo vjen nga Paneli i Apelit në çështjen Shala. Ata bënë
15 konstatime se i akuzuari në këtë rast, synimi i tij për të
16 vrarë viktimën në atë rast, që vinte nga një deklaratë e
17 paverifikuar, ishte konfirmuar sepse kishte prova të tjera
18 rrethanore që mund të verifikoheshin për të konfirmuar këtë.
19 Dhe ata thanë, citojmë, konkretisht provat e drejtpërdrejtë në
20 gjykatë për përfshirjen e të akuzuarit në ndalime dhe
21 keqtrajtme të të ndaluarve në të njëjtin vend në të njëjtën
22 kohë, të akuzuarit dhanë dëshmi për dhunën që kanë pësuar të
23 ndaluarit nga anëtarët e tjerë të NPK-së dhe, ai ishte i pari
24 që goditi një viktimë në veçanti, duke treguar autoritetin e
25 tij përmes marrjes së iniciativës dhe, vazhdoi të marrë pjesë

1 në keqtrajtimin e të ndaluarve pasi të ndaluarit kishin humbur
2 vetëdijen, pra, duke treguar që ai kishte synimin për të
3 vrarë. Kjo është në paragrafët 84, 851, 502, 505.

4 Tani, në rastin tonë nuk i kemi këto prova konfirmuese
5 për sa i takon dy personave që u morën apo të ndaluarin që
6 pretendohet që të jetë mbajtur i ndaluar në Kleçkë nga z.
7 Veseli dhe/apo se ai ishte i përfshirë në zhdukjen e
8 pretenduar apo vrasje apo ndalim. Thjesht nuk kemi as model as
9 praktikë apo prova të ngjashme. As historik të tillë të
10 pjesëmarrjes së tij të kaluar apo të përfshirjes së tij, nuk
11 kemi dëshmi të dhunës fare. Skenarët faktikë janë tërësisht të
12 ndryshëm. Dhe kjo është ajo që dhoma e Apelit tha është e
13 mjaftueshme. Nuk jemi fare afër asaj.

14 Ngjashëm me këtë, konstatimi i Dhomës së Apelit lidhur me
15 NKP-në në atë rast tregon se secili element i NKP-së u
16 konsiderua se përcaktonte nëse provat e dorës së dytë të
17 paverifikuara u konfirmuan nga dëshmi të tjera të verifikuara
18 nga Paneli duke vënë në dukje dëshminë e dhënë në Gjykatë
19 lidhur me përfshirjen e të akuzuarit në keqtrajtimin --
20 praninë e tij fizike në të njëjtin vend si anëtarë të tjerë të
21 NKP-së të përfshirë në keqtrajtim, veprimi në një mënyrë të
22 caktuar në të njëjtën kohë, praktika gjatë ndalimit në të
23 njëjtin vend ku të akuzuarit kanë qenë të pranishëm dhe
24 pjesëmarrja në keqtrajtim. Kjo është paragrafi 502, 505.

25 Nuk bëhet fjalë thjesht për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë

1 por edhe NKP-ja gjithashtu. Ata duhet të kishin dëshmi në
2 gjykatë që të tregojnë elementët e kriminalitetit që tregojnë
3 që këta elementë janë vërtetuar. Edhe po të mos kishte veprime
4 kriminale, në të cilat ata do të mbështetshin në një mënyrë
5 apo një tjetër, ata duhet të vërtetojnë me prova se këto ishin
6 konfirmuar në mënyrë të duhur. Tani nuk ka asnjë provë në
7 çështjen që kemi këtu në rastin e Veselit.

8 Dhe është shumë domethënëse se paneli i apelit nuk i
9 rrëzoi, nuk i anuloi disa konstatime lidhur me torturën në atë
10 rast kundër pesë të -- torturën që pësuan pesë viktimat të
11 pretenduara që ishin të bazuara tërësisht në prova të dorës së
12 dytë të paverifikuara mbi bazën se modeli i provave apo
13 praktika për provat e tjera edhe, në atë rast, nuk mbështeste
14 se këta persona ishin torturuar. Rregulla 144, u konstatua që
15 shkelja e rregullës 144. Kjo është paragrafi 512, 551. Tani,
16 kjo nuk kishte të bënte me krimet për të cilat bëhet fjalë as
17 përfshirjen e të akuzuarit, përfshirjen personale të të
18 akuzuarit, por parimi është i njëjtë. Praktika dhe provat e
19 tjera duhet të mbështesin, të konfirmojnë përfshirjen
20 personale të të akuzuarit në krim nëse ai është pretendimi që
21 mbi të cilin po mbështetet. Pra edhe nëse konfirmon krimin për
22 të cilin bëhet fjalë në mënyrë të ndarë, kjo nuk do të thotë
23 përfshirje personale, nuk do të thotë që përfshirja personale
24 është vërtetuar përmes provave që kanë të një modelit të
25 ngjashëm. Prova të modelit të ngjashëm duhet të përqendrohen

1 në faktin nëse ato tregojnë përfshirjen e të akuzuarit sipas
2 kritereve që përmenda më lart.

3 Dhe ajo që është më e rëndësishme në çështjen e Veselit,
4 Paneli i Apelit ishte shumë i qartë se provat e dorës -- të
5 shumta nuk konfirmojnë njëra-tjetrën. Në njërin prej
6 pretendimeve për torturë në paragrafin 544, 551, tre rrëfime
7 të dorës së dytë, shumë të ngjashme me atë që kishim nga dy
8 personat që në rastin e dy personave që u morën, Prokuroria u
9 mbështet në këto rrëfime, u përdorën si prova mbështetëse,
10 Paneli tha se shpallja fajtor apo verdikti i fajësisë bazuar
11 në këto prova shkeli rregullën 144. Dëshmitari i katërt i cili
12 mund të jepte dëshmi lidhur me këtë nuk hyri në hollësi, në
13 fakt, në hollësinë e fakteve të pretenduara nga këto prova të
14 dorës së dytë apo thashetheme.

15 Pra, trajtova këto të dyja. Pjesa tjetër mundësitë dhe
16 qëllimet edhe pse këto u përmendën në parashtrimet gojore janë
17 të mbushura me gabime dhe defekte.

18 Shohim paragrafin 515(b) i cili vazhdon dhe përmend
19 shoqërimin apo argumentin e shoqërimit që është klishe dhe
20 këtu lidhur me Dëshmitarin W04743, z. Naser Krasniqi. Dhe ata
21 paraqesin këtë, pra, ZPS-ja, duke cituar dëshminë e Veselit në
22 vitin 2012 lidhur me SHIK-un dhe ata thonë si në vijim, citoj,
23 Z. Veseli vetëdeklaroi nën betim se ai ishte emëruar si kreu i
24 SHIK-ut në fund të marsit 1999 dhe përpara kësaj shefi i G2,
25 në njërin prej -- ky segment i aktiviteteve të tija kishte të

1 bënte me trajtimin e problemit të bashkëpunëtorëve serbë se ai
2 e njihte 4743 shumë mirë dhe se 4743 ishte një anëtar i SHIK-
3 ut dhe "një prej më të mirëve që kishte dalë nga lufta". Dhe
4 që ishte i përfshirë, kjo është 4743, pra, në ndalimin dhe
5 keqtrajtimin e kundërshtarëve.

6 Nuk e di nëse kjo është një përpjekje apo një lloj modeli
7 i përdorur nga ZPS-ja për të paraqitur atë në këtë mënyrë. Së
8 pari, dëshmia e z. Veseli, të cilës ata i referohen, ka të
9 bëjë me SHIK-un pas luftës ku ai përshkruan zhvillimet në
10 periudhën pas luftës në gjysmën e dytë të 1999-s dhe pastaj në
11 vitin 2000 dhe deri në zhbërjen e tij në vitin, pra, të
12 strukturës së SHIK-ut në vitin 2008. Z. Veseli shprehet për
13 "Kapacitetet e SHIK-ut si strukturë që në fillim ishin të
14 kufizuara sa i përket numrit, trajnimeve. Dhe vetëm më vonë,
15 ndoshta në gjysmën e dytë të vitit 2000 kishin filluar të
16 vendosnin një bazë të strukturës që funksiononte në mënyrë të
17 duhur sa i takon operacioneve". Kjo është në P789.

18 Në fakt, z. Krasniqi na dha neve dëshmi se ai ishte
19 rekrutuar në fillim të vitit 2000, pranverë të vitit 2000. Dhe
20 ai tha në dëshminë e tij se kur bëri trajnimin e parë nga
21 miqtë ndërkombëtarë, agjenci të miqve ndërkombëtar, ishte
22 trajnimi i parë që kishte bërë lidhur me shërbimet e zbulimit.
23 Kjo bëhet fjalë në vitin 2000.

24 Pra, e gjitha kjo është pas luftës. Ju do të shihni këtë
25 vazhdimisht, në mënyrë të përsëritur. Ajo që ZPS-ja bën është

1 të kalojë nga pasluftë sepse nuk kanë asgjë përgjatë luftës,
2 domethënë, ajo që po ndodhte gjatë luftës dhe duhet të
3 vërtetojnë këtë lidhje. Në rastin kur Veseli flet për SHIK-un,
4 zhvillimin e SHIK-ut pas luftës, kjo s'ka të bëjë fare, asgjë
5 fare me atë që ka ndodhur gjatë luftës. Dhe në qoftë se pas
6 luftës ata po shohin, Prokuroria, sesi po konsideroheshin
7 çështjet e sigurisë për të siguruar marrjen e informacionit e
8 të tjera, kjo nuk do të thotë që kjo gjë, pra, që SHIK-u bënte
9 pas luftës, ka ndodhur edhe gjatë luftës. Në fakt, ata nuk
10 mund ta bënin këtë gjatë luftës dhe i kanë thënë dhe është
11 thënë në mënyrë të përsëritur se nuk ishin në gjendje të
12 zhvillonin strukturat e mjaftueshme për ta bërë këtë dhe kjo u
13 bë vetëm pas luftës.

14 Së dyti, referenca për bashkëpunëtorët ka të bëjë e
15 gjitha me punën e SHIK-ut pas luftës dhe nuk ka asgjë të
16 paligjshme që të jetë, që të ekzistojë një strukturë e
17 shërbimeve të zbulimit civil që merret me çështjet dhe
18 rreziqet e sigurisë. ZPS-ja neglizhon dhe nuk përmend faktin
19 se z. Veseli e ka bërë absolutisht të qartë, tërësisht të
20 qartë se nuk bëhej fjalë për hakmarrje ndaj bashkëpunëtorëve.
21 Kjo ishte pas luftës. Edhe një herë, e gjitha është aty në
22 intervistë, por është injoruar tërësisht nga ZPS-ja.

23 Dhe pastaj, së treti, gjatë luftës, për sa i përket
24 periudhës gjatë luftës nuk ka prova që z. Krasniqi të ketë
25 pasur kontakte me z. Veseli apo të ketë punuar me të. Ata i

1 referohen atij si personi kyç që tregon atë që ka ndodhur
2 gjatë luftës, por nuk ka prova që ata kanë patur kontakte me
3 njëri-tjetrin por përveç një takimi që është bërë dhe, do t'i
4 kthehem atij, në maj të 1999, vetëm një takim shumë i shpejtë,
5 i shkurtër, kanë punuar së bashku kanë punuar ngushtë së
6 bashku të lidhur në ndonjë mënyrë me krime që pretendohen
7 kundër z. Krasniqi.

8 ZPS-ja nuk mund të thotë, siç e bëjnë në poshtëshënimin
9 2128 dhe ju nuk mund të besoni, të nderuar Gjykatës -- që ju
10 Gjykatës nuk mund të besoni të gjitha që z. Krasniqi thotë,
11 asgjë që z. Krasniqi thotë. Ata e kanë thirrur atë, janë
12 mbështetur në të pafundësisht sa i takon këtij takimi që
13 përmenda më herët. Ata i kthehen vazhdimisht këtij takimi dhe
14 e përmendin në mënyrë të vazhdueshme. Është edhe ky një
15 shembull tjetër i qasjes, i teorisë skizofrene që ka
16 Prokuroria, pra, nuk mund të besoni asgjë në të. Por ky takim
17 është i besueshëm, është i rëndësishëm dhe në këtë rast ai
18 thotë të vërtetën.

19 Gjithashtu, duhet të keni parasysh, të nderuar Gjykatës,
20 se z. Krasniqi edhe pse i akuzuar nga gjykatat e EULEX-it për
21 keqtrajtim të të ndaluarve, u shpall i pafajshëm për ato akuza
22 në çështjen në të cilën dëshmitari i vetëm për pretendimin e
23 Kleçkës, pra, 4839 nga ana tjetër u tregua që ishte dhe ai
24 gënjeshtar. Ai u konstatua se ishte gënjeshtar. Dhe kjo pikë
25 kontraktuese që nuk vu në pah nga ZPS-ja.

1 Tani, ZPS-ja mund të thotë që ju, të nderuar Gjykatës,
2 nuk jeni të detyruar të ndiqni konstatimet që janë bërë më
3 herët, të mëparshme, por këto këtu kemi rastin kur përdoren
4 pika të caktuara të konstatimeve të mëparshme dhe jo të tjera.

5 Dhe nëse thuhet që një person është njeri i mirë 12 vjet
6 pas luftës, si mund të jetë kjo, të merret kjo që ai i njihte
7 ata, punoi me ata gjatë luftës? Në qoftë se ka ndonjë kuptim
8 kjo tregon thjesht se sa poshtë ka rënë ZPS-ja për t'u kapur
9 me copëza apo me gjëra për t'u përpjekur për të mbushur
10 boshllëqet në atë që ka ndodhur gjatë luftës në provat e tyre
11 që nuk kanë. Por ky është thelbi dhe baza e provave të tyre në
12 paragrafin 515. Dhe do ta konstatoi ju vetë Gjykatës që ata e
13 hodhën në këtë pikë në mënyrë të pakontrolluar të vazhdueshme
14 duke u përpjekur për të krijuar diçka që është e pranueshme.

15 Dhe, së fundmi, të nderuar Gjykatës, përpara pushimit,
16 disa copëza të tjera që përmenda, janë dy të tjera pretendime
17 të bëra në lidhje me përfshirjen e drejtpërdrejtë, por mesa
18 duket tani ZPS-ja nuk thotë ndryshe në parashtrimet e tyre,
19 por në dosjen e shkruar ata u tërhoqën duke thënë se z. Veseli
20 nuk u përfshi kurrë në këtë. Pretendimi se ai ishte i
21 pranishëm në momentin kur Bytyqi shprehu mbështetje për UÇK-në
22 dhe se ai dinte lidhur me keqtrajtimin e pretenduar, nuk
23 mbështetet nga provat dhe ZPS-ja duket që nuk po parashtron më
24 tej tani se z. Veseli kishte njohuri për të.

25 Pika dy, diçka tjetër që është hequr për z. Veseli është

1 urdhërimi i arrestimit të një personi, nuk do ta përmend emrin
2 sepse është i mbrojtur, por me merremi me të në paragrafin
3 556, 560 të dosjes sonë, e kemi trajtuar këtë. Kjo ka ndodhur
4 në qershor, mesa duhet 1998. Por ZPS-ja ka nënshkruar se z.
5 Veseli e kanë hequr ZPS-në nga ky rrëfim -- e kanë hequr z.
6 Veseli nga rrëfim. Dhe tani i referohen thjesht si një lloj
7 urdhri i përgjithshëm i Shtabit të Përgjithshëm. Nuk e
8 përmendin më tej atë në mënyrë konkrete dhe specifike në
9 dosjen e tyre. Ky duket një lëshim që është bërë. Sepse nuk
10 mund ta vërtetojnë atë. Sidoqoftë, nuk ka prova të kësaj siç
11 është thënë edhe në dosjen tonë, pra edhe kjo duhet të mos
12 merret parasysh.

13 Për të përfunduar lidhur me pjesëmarrjen e
14 drejtpërdrejtë. ZPS-ja në mënyrë të guximshme deklaroi në
15 paragrafin 516 që ju lexova juve, të nderuar Gjykatës, se këto
16 pretendime të përfshirjes së drejtpërdrejtë tregojnë synimin e
17 z. Veseli, kontributin e tij në NKP dhe nxjerrin në pah
18 dijeninë e tij të gjerë që kishte për krime dhe për rrjedhojë
19 gatishmërinë e tij për të marrë pjesë në të. Edhe kjo është
20 deklaratë e guximshme e pambështetur që është tërësisht e
21 pambështetur.

22 Parashtrimi ynë është se pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e
23 z. Veseli duhet të hiqet fare nga aktakuza përfshirë -- dhe,
24 kjo është e rëndësishme, kur bëhet fjalë për synimin dhe
25 njohurinë e tij apo se si në një farë mënyre ai pranoi këtë

1 NKP. Të nderuar Gjykatës, duhet të hiqni nga mendja këtë sepse
2 nuk është vërtetuar në nivelin e kriterit apo standardit
3 kriminal dhe është thjesht një provë rrethanore e zbehtë.

4 Kjo është koha ndoshta që të bëjmë një pushim.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
6 z. Dixon.

7 Përpara se të bëjmë pushimin, Gjykatësi Mettraux ka një
8 kërkesë qartësuese.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Smith.

10 Dhe kjo është për ZPS-në faqja 28389 në parashtrimin e së
11 hënës, rreshti 20. Parashtrimi që u bë është se z. Lahi
12 Brahimaj ishte i pranishëm në takimin e komandës së Dukagjinit
13 i cili miratoi rregullat që kishin të bënin me ekzekutivin e
14 bashkëpunëtorëve të armikut. Asnjë referencë nuk u dha. Mund
15 të na jepni referencën pas pushimit?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Tani do të bëjmë pushimin. Gjysëm ore pushim. Kthehemi në orën
19 11.00 për të vazhduar me paraqitjen e z. Dixon.

20 --- Pauza fillon në orën 10.26

21 --- Seanca rifillon në orën 11.01

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

23 Z. Dixon, mund të vazhdoni.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. QUICK: [Përkthim] Më falni, kam -- më flani për

1 ndërprerjen, po desha t'ju përgjigjesha për sqarimin që
2 kërkuat më herët.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, më falni.

4 Z. QUICK: [Përkthim] Lidhur me pyetjen e Gjykatësit
5 Mettraux, ju lutem shikoni provën që është procesverbali i
6 mbledhjes së zonës së Dukagjinit dhe që mban numrin P1598, që
7 është mbajtur më 21 qershor 1998; keni Faktet e Gjykuara më
8 herët me numër 257, 259, që lidhen me takimin e njëjtë të
9 policisë ushtarake, rregulloret që janë miratuar, pjesëmarrjen
10 e Lahi Brahimaj, dhe më pas, ju lutem, shikoni edhe provën
11 P908_ET.1 dhe P927_ET.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani, z.
14 Dixon, mund të flisni.

15 Z. ROBERTS: [Mikrofoni çaktivizuar].

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

17 Z. ROBERTS: [Mikrofoni çaktivizuar].

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

19 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
20 këshillohen]

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të
22 bëjmë një pushim të shkurtër që të zgjidhim problemin teknik.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 11.04

24 --- Seanca rifillon në orën 11.12

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

1 z. Dixon, e provojmë dhe një herë.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Tani do të vazhdoj e
3 do të jap disa shembuj lidhur me Ndërmarrjen Kriminale të
4 Përbashkët që është tërësisht rrethanore në këtë rast. Në
5 fakt, ZPS-ja nuk ka asnjë provë për të mbështetur NKP-në që
6 pretendohet kundër klientit tim.

7 Edhe në paragrafin 480 të dosjes, kanë një parashtrim
8 befasues, ku thonë atë çka ka thënë klienti im në një
9 intervistë që është botuar më 9 shkurt 2013, ka qenë provë që
10 Shtabi i Përgjithshëm vepronte në mënyrë kolektive. Ju
11 kujtohet, të nderuar Gjykatës, që ata cituan atë çka ka thënë
12 në një intervistë klienti im shumë, shumë vite pas luftës. Një
13 intervistë në media, nuk ka qenë në betim, po ai ka thënë që:

14 "Nuk kemi pasur detyra të ndara po bënim çfarë të kishim
15 mundësi. Ishim të angazhuar në udhëheqje, logjistikë, zbulim,
16 kundërzbulim, se të tilla ishin rrethanat."

17 Tani, ZPS-ja vijon më tej merr pjesë nga kjo intervista,
18 por po ta kishin dëgjuar të gjithë intervistën do ta kishin
19 kuptuar që z. Veseli po fliste për fazat e hershme të
20 konfliktit sepse ai vijon dhe thotë më pas që:

21 [Siç lexohet] "... diku në maj të atij viti", këtu flet
22 për vitin 1998, pra maj 1998, "pasi biseduam me Agim Çekun,
23 filluam të krijojmë strukturat e UÇK-së dhe t'i bënim më
24 profesionale dhe Çeku - që nuk lë mënjanë rolin e
25 jashtëzakonshëm të Bislim Zyrapit filloi të ndërtonte

1 strukturat specifike të UÇK-së bazuar në strukturat e NATO-s,
2 si G1, G2.”

3 Pra e shpjegon që në fillim ishte e përgjithshme,
4 kaotike, rrëmujë, po më pas filluam me ushtarë karriere si
5 Zyrapit të ndërtonim struktura të mirëfillta. Kjo nuk është
6 aspak ajo që pretendon ZPS-ja, klienti im nuk ka thënë që “Ne
7 kemi vepruar në mënyrë kolektive”, nuk mund të marrin këtë
8 fjalë për të treguar që ai ka qenë pjesë e NKP-së, ai thjesht
9 ka dashur të thotë që ne po punonim të gjithë së bashku kundër
10 armikut. Nuk ka thënë asgjë klienti im, ka folur vetëm për
11 strukturat, për të thënë që kemi pasur më shumë organizim, por
12 jo përgjegjësi kolektive. Dhe në këtë organizim, sigurisht që
13 kishin rolet gjithsecili. Rrjedhimisht ky nuk do të thotë që
14 nëse je pjesë e një drejtorie nuk do të ketë përgjegjësi për
15 të gjitha drejtoritë e tjera. Është absurde, të nderuar
16 Gjykatës.

17 Duhet patur shumë kujdes kur t'i jepni peshë intervistave
18 në media në vitin 2009, që ka ndodhur shumë vite pas luftës,
19 kur z. Veseli po njihej politikisht, u përgjigjej pyetjeve të
20 përgjithshme të cilat janë incizuar apo janë marrë nga
21 gazetarët.

22 Sidoqoftë, nuk ka absolutisht asnjë provë. Kjo është në
23 fakt një teori konspirative. ZPS-ja është duke rënë gjithnjë e
24 më shumë, dhe po arrin fundin, kur pikërisht përpigjen të
25 tregojnë se si z. Veseli ka kontribuar për NKP-në.

1 Veprimet sikurse që ata përmendin sigurisht kanë një
2 kontribut, unë e kam shtjelluar në paragrafët 508, 527 të
3 dosjes dhe flitet për periudhat e zbulimit të cilat janë
4 trajtuar në paragrafët 255, 273 të dosjes sonë. Ata këta kanë
5 si provë, edhe unë, të nderuar Gjykatës, ta shikoni me
6 vëmendje, por sidoqoftë dua t'ju jap disa shembuj.

7 Sa i takon përgjegjësisë së drejtpërdrejtë, megjithatë ju
8 do të shihni që në mënyrë të vazhdueshme përsëriten të njëjtat
9 gjëra. E thonë ndonjëherë në mënyra të ndryshme në tekst e në
10 poshtëshënime, por më falni, por për mua kjo është si një
11 kasetë e prishur.

12 Të shohim më konkretisht një paragraf. Shohim paragrafin
13 508. Thotë në këtë paragraf që një rast ka qenë kur z. Veseli
14 ka marrë pjesë në takimet e Shtabit të Përgjithshëm ku janë
15 marrë vendime lidhur me organizimin e UÇK-së dhe janë bërë
16 emërimet e stafit komandues. Poshtëshënimi përkatës është
17 2083, ku në, në fakt, flitet për dy takime të Shtabit të
18 Përgjithshëm, mund të jenë dy apo tre, megjithatë nuk ka asnjë
19 provë aty, asgjë nuk tregon që në fakt, z. Veseli ka vendosur
20 për stafin komandues, por edhe sikur të ketë vendosur, a është
21 ky krim?

22 Në pas vijojnë të shtjellojnë synimet kriminale, thonë
23 që:

24 "Veseli ka drejtuar aparatin përgjegjës për identifikimin
25 e bashkëpunëtorëve të dyshuar, ka mbledhur dhe analizuar

1 informacion në lidhje me ta dhe ka mbajtur kontakte me njësitë
2 e zbulimit.”

3 Poshtëshënimet përkatëse janë 2086, 2088. Prapë janë
4 bazuar në një intervistë të z. Veseli që është e 3 majit 2011,
5 ku qartazi ai i referohet SHIK-ut pas luftës. Dhe Prokurori që
6 i ka bërë pyetje në atë intervistë, në fakt, i referohet vitit
7 2000, dhe ka bërë, ky pyetur për SHIK-un dhe drejtoritë e
8 SHIK-ut, z. Veseli, pra, po flet për drejtoritë e ndryshme të
9 SHIK-ut dhe sigurisht që kishin filluar të ishin funksionalë
10 sepse kishte përfunduar lufta edhe një shtet ka të drejtën e
11 vet të ketë dhe shërbimin informativ.

12 Të njëjtën gjë ka thënë z. Veseli në dëshminë që ka dhënë
13 para Gjykatës Supreme në qershor 2012 për të njëjtin rast. Të
14 gjitha këto kanë qenë në lidhje me ngjarjet pas luftës. Këto
15 janë në provën 789. Nuk ka thënë asgjë z. Veseli që të shtyn
16 të mendosh se ka bërë të kundërtën. Unë nuk e kuptoj dot se si
17 kanë dalë në këtë deduksion. Ai ka treguar çfarë bën shërbimi
18 informativ, se si ka bashkëpunuar me organet e tjera, s'ka
19 asnjë element kriminal për këtë. Ka folur për personat që kanë
20 punuar dhe ky është pikërisht trajnimi që z. Veseli do të
21 merrte jashtë vendit dhe do ta zbërthente në praktikë pas
22 luftës tek shërbimi informativ civil. Nuk ka asgjë aty për
23 mbajtjen e kontakteve me shërbimet informative gjatë luftës,
24 sepse nuk ka pasur kontakte. Nuk kishte mundësi se si të
25 mbaheshin këto kontakte. Por ka ndodhur më pas, ka ndodhur,

1 pra, pas luftës.

2 Përmendet edhe një dokumentar që mbulon vizitën e z.
3 Veseli në Hagë në 2019-n për intervistën me Dhomat e
4 Specializuara - bëhet fjalë për provën 4212 - ku prapë nuk
5 përmenden fare bashkëpunëtorët. Mund të themi që është pak a
6 shumë paraqitje publike që tregon që erdhi në Hagë, po ta
7 përdorësh këtë për të thënë që kjo është provë që z. Veseli ka
8 drejtuar aparatit e tërë për identifikimin e bashkëpunëtorëve
9 gjatë luftës është absurde.

10 ZPS-ja është përpjekur të na thotë që SHIK-u ka qenë
11 funksional qysh prej prillit 1999, dhe z. Veseli ka qenë kreu
12 i SHIK-ut. Po ashtu thonë që për shkak të Qeverisë Përkohshme
13 -- për shkak të UNMIK-ut, Qeveria e Përkohshme nuk lejohej të
14 bënte asgjë. Të gjitha këto që thonë i kanë bazuar në
15 intervistat e z. Veseli, që në fakt nuk tregojnë çfarë ka
16 ndodhur konkretisht në prill, maj, qershor, korrik dhe gusht
17 1999. Asnjë provë nuk ka sjellë ZPS-ja që të na vërtetojë ne
18 që SHIK-u ka qenë funksional asokohe. Nuk e kemi ne barrën e
19 provës, ata e kanë barrën e provës. Por ata tregojnë në vija
20 të përgjithshme që pas luftës nga fundi i 1999-s filluan të
21 lëviznin gjërat. Dhe kjo përputhet me provat për muajt e
22 vështirë të bombardimit të NATO-s nga fundi i marsit 1999 e
23 deri në fund të luftës në qershor 1999, që sigurisht ky ishte
24 dhe fokusi. Në këtë periudhë nuk mundet të angazhoheshin me
25 strukturat civile sepse bëhej fjalë për një periudhë

1 bombardimesh. Ishte një periudhë e vështirë, njerëzit u
2 larguan, refugjatët lëviznin në të gjitha drejtimet, forcat
3 serbe dolën në terren, bënë përpjekjet e fundit për të
4 luftuar, që e bënte shumë të vështirë një organizim të
5 këtillë.

6 Po ashtu përputhet me provat për procesin e rëndësishëm
7 të demilitarizimit që vijoi më pas, ku mori pjesë dhe z.
8 Veseli sikurse dhe ne e kemi parë, që po ashtu ishte fokusi
9 asokohe. Qeveria e Përkohshme u bë aktive vetëm pas luftës por
10 edhe atëherë në mënyra shumë të kufizuara për shkak të UNMIK-
11 ut, sikurse dëgjuat prej shumë nga dëshmitarët ndërkombëtarë,
12 më shumë ishte për shfaqje sesa për çdo gjë tjetër. Edhe ata
13 nuk duhet të bënin asgjë dhe, në fakt, me sa kam unë dijeni
14 ata nuk po bënin asgjë.

15 ZPS-ja mbështetet dhe në emërimin e personave më pas, pas
16 luftës në SHIK, të cilët dikur më parë kishin qenë të
17 përfshirë në një mënyrë apo tjetër në luftë. Po kjo nuk tregon
18 se ka pasur dijeni se çfarë bënin këta persona asokohe. ZPS-ja
19 duhet të vërtetojë se ka pasur dijeni klienti asokohe në
20 mënyrë që të vendosë nëse duhet ta emërojë këtë person në
21 pozicionin përkatës pas luftës. Pra, duhet ta vërtetojnë që e
22 kanë njohur personin në kohën përkatëse dhe jo më pas, dhe
23 edhe sikur ta ketë njohur personin, duhet ta ketë ditur se
24 çfarë bënte personi në atë kohë, jo ta ketë mësuar këtë gjë më
25 vonë.

1 Vetëm pas luftës, pra, e kam thënë disa herë, siç e keni
2 parë dhe nga provat, u krijua struktura e shërbimit
3 informativ. Vetëm në këtë periudhë z. Veseli ishte në gjendje
4 dhe filloi të drejtonte këtë strukturë. Provat na tregojnë se
5 gjatë luftës, në fakt, ishte e pamundur që ta krijoje këtë
6 strukturë. Trajtimi dhe kontaktet jashtë vendit sigurisht që e
7 ndihmuan për strukturën e mëpasshme.

8 Sikurse e pranon dhe ZPS-ja, pas Rambujesë z. Veseli u
9 largua nga pozicioni i tij si shefi i shërbimit ushtarak G2,
10 pranë UÇK-së dhe këtu bëhet fjalë për periudhën prill 1999 dhe
11 u bë kreu i shërbimit informativ civil. SHIK-u pra, ishte
12 pjesë e qeverisë së asokohe. Këtë e pranojnë. Megjithatë ata
13 nuk e pranojnë se si u shpalosën ngjarjet më pas në prill,
14 sepse kemi ndërhyrjen e NATO-s, përshkallëzimin e situatës,
15 veçanërisht për shkak të rezistencës së madhe të forcave
16 serbe, të cilat u ndoqën nga kapitullimi dhe dorëzimi i
17 forcave serbe dhe më pas erdhi UNMIK-u, demilitarizimi,
18 strukturat e ndryshme të përkohshme. I kemi dëgjuar të gjitha
19 këto. Por, vetëm pas luftës mund të merrnin frymë dhe të
20 fillonin të krijonin struktura të mirëfillta.

21 ZPS-ja, madje, ka dhe guxim dhe në paragrafin 508 dhe
22 thotë: "Që në fillim shërbimi zbulim-kundërzbulimi ishte
23 thelbësor për mundësinë e UÇK-së që të kryente operacionet e
24 veta, përfshirë kundër oponentëve". Pra, në thelb ata vendosin
25 shërbimin, zbulimin-kundërzbulimin dhe rrjedhimisht klientin

1 tim. Mund të ketë qenë dhe një njësi zbulimi në një fshat,
2 diku larg. Ata thonë kudo që të ketë qenë përgjigjeshe z.
3 Veseli. Edhe i japin edhe një poshtëshënim që mbështesin këtë
4 pretendim, 2089, që prapë është një intervistë e z. Veseli në
5 vitin 2009, dhe citojnë të njëjtën gjë. Mesa duket ata e kanë
6 përdorur këtë intervistë edhe për bashkëpunimin kolektiv, por
7 dhe tregojnë që filluan veprimtaritë kundër oponentëve sikurse
8 pretendohet në aktakuzë.

9 Të nderuar Gjykatës, nuk do të gjeni një referencë të
10 vetme të oponentëve në atë intervistë. Nuk janë përmendur një
11 herë të vetme, është absolute. ZPS-ja vazhdon edhe përmend një
12 pjesë tjetër të intervistës ku flet për shënjestrat ku duhet
13 të godiste NATO-ja, por kjo nuk mund të nënkuptojnë oponentë.
14 Më pas marrin një pjesë tjetër ku thonë që:

15 "Zyrtarisht, SHIK-u është themeluar në kohën kur u
16 themelua dhe Qeveria e Përkohshme."

17 "Zyrtarisht, zyrtarisht", po, vërtetë, por nuk bëri
18 asgjë. Kjo është pyetja.

19 "Ne duhet të dimë se në rrethanat se si kemi punuar
20 asokohe na duhej dhe zbulimi, se përmes zbulimit mund të
21 kryenim operacionet tona dhe të mbroheshim."

22 Pra, janë mbështetur në këtë paragraf, një deklaratë të
23 përgjithshme për nevojën që duhet të kishte një shtet për
24 shërbim zbulim-kundërzbulimi. Nuk po flasim për SHIK-un tani,
25 por ata pretendojnë që në këtë periudhë funksiononte zbulimi

1 dhe kundërzbulimi. Megjithatë, si në çdo shtet duhet të ketë
2 shërbim zbulim-kundërzbulimi sepse kështu mund të mbrohet një
3 shtet, por të dalësh në përfundimin se kishte operacione
4 kundër oponentëve për mua është e tepruar.

5 Tani, fajësi për shkak të lidhjeve, një, tani kemi
6 fajësinë për shkak të postit që ka pasur. S'ka asgjë të
7 paligjshme në punën e zbulimit-kundërzbulimit. Në gjithë botën
8 ka agjenci zbulimi-kundërzbulimi, FBI-ja, MI5 - ka politika
9 dhe rregullore që janë të nevojshme për të mbledhur
10 informacione për kërcënimet ndaj vendit.

11 Të nderuar Gjykatës, ky është paragrafi 508. Të gjitha
12 rreshtat që vijnë më pas, dhe nuk do t'i dëgjoj të gjitha,
13 përmbajnë të njëjtin problem që përsëritet.

14 Kam një shembull tjetër këtu për t'ju treguar se sa
15 dëshpëruese është kjo gjendje, paragrafi 510. Kam disa
16 diapozitiva vetëm për këta paragrafë për të paraqitur, tetë të
17 tilla, për ta bërë pak më të gjallë këtë dhe për ta
18 demonstruar apo treguar në mënyrë grafike se kur lexohen këto
19 paragrafë dhe shihen të gjitha poshtëshënimet mund të mos
20 shikohet kjo gjë dhe mund të shihet më mirë përmes
21 diapozitivave. Ekipi im ka bërë një punë mjaft të
22 jashtëzakonshme, kemi përpiluar 500 diapozitiva të tillë për
23 të analizuar pikë për pikë se çfarë ka ky tekst. Nuk do t'i
24 shohim të gjitha. Vetëm këto që thashë. Dhe kjo është në thelb
25 të akuzës për NPK dhe po kështu dhe për sistemin e komandimit.

1 Ja çfarë thuhet në paragrafin 510:

2 "Si shef i drejtorisë së inteligjencës, Veseli ishte
3 mbikëqyrës i të gjitha çështjeve në UÇK, në përputhje me
4 rregulloret e UÇK-së dhe që e bën atë përgjegjës për
5 organizimin dhe organizimin e punës së njësive vartëse."

6 "Ai ka caktuar në të gjithë dhe e ka bërë këtë në të
7 gjithë territorin e vendit. Ai ka caktuar detyra dhe ka marrë
8 raportet nga të gjitha njësitë e inteligjencës në të gjitha
9 zonat."

10 Të shohim. Ky është pretendimi, të shohim çfarë thuhet.

11 Të kalojmë tani në diapozitivin 2.

12 Që është poshtëshënimi i parë, 2099. Dhe thuhet që
13 Qadraku thotë në një intervistë në prill 2023, në provën
14 P1863, që Veseli ishte shef i tij. Pra, konfirmoi që këtë
15 intervistë që kishte dhënë që ishte e saktë dhe, në fakt, u
16 pyet për këtë, tha që ishte Veseli ishte shefi i tij.

17 Por ZPS-ja e injoron, e anashkalon tërësisht, e shpërfill
18 të gjithë faktin që Qadraku -- ato që ka thënë Qadraku në
19 dëshminë e tij që nuk ka marrë urdhra nga Veseli apo që ai t'i
20 këtë raportuar. Dhe këtë e keni në faqet e transkriptit 709
21 dhe 710 dhe 15, 16.

22 Që janë faktorë kryesorë për të provuar nëse ka patur
23 këtë rol mbikëqyrës. Është një rol i zakonshëm. Po cilat janë
24 provat kur thuhet nëse mbikëqyrja është provuar, ai thotë: Jo,
25 nuk ka marrë asnjëherë asnjë urdhër nga ai. Dhe pikërisht

1 është një rast klasik ky i ZPS-së, të cilët përqendrohen vetëm
2 në një pikë të veçantë dhe injorojnë të gjithë tërësinë e
3 provave.

4 Sa i përket diapozitivit 3. Kjo është shifra tjetër që
5 citojnë ata. Dhe kjo është faqja kryesore e kësaj interviste
6 që kanë diskutuar herë pas here. Dhe nuk mund të pretendojnë
7 që faqja hyrëse apo kapaku të mund të mbështesë pretendimin e
8 tyre, duhet ta shohin të tërë intervistën nga e para. Dhe po
9 t'i hedhësh sytë të gjithë kësaj interviste, nuk shihet që nuk
10 ka asnjë shenjë që të tregojë që ka patur mbikëqyrje të të
11 gjitha çështjeve të inteligjencës në UÇK. Përmend "trajnimet e
12 përhershme" në gusht dhe shtator 1998 pa dhënë asnjë hollësi,
13 por nuk përmend çështjen e mbikëqyrjes së çështjeve apo
14 aspekteve të inteligjencës.

15 Dhe kjo ishte koha e ofensivave serbe. Dhe ishte e
16 rëndësishme, se kur u pyet për këtë çështje Zyrapit për këtë
17 trajnim, ai nuk ishte në gjendje ta konfirmonte një gjë të
18 tillë. Ai tha: Duhet të mbani parasysh që z. Veseli ka qenë
19 jashtë shtetit, duke u marrë me çështje që zhvilloheshin
20 jashtë shtetit dhe me marrëveshjen e FARK-ut. Këtë e tha
21 Zyrapit për shtatorin dhe tetorin e 1998.

22 ZPS-ja e anashkalon një gjë të tillë. Dhe është kjo një
23 gjë thelbësore për tërësinë e provave që shqyrtohen. Dhe kjo
24 është një mangësi kolosale nga ana e ZPS-së. Ata gjithë kohën
25 thonë që do të shihet dëshmia apo provat në tërësinë e tyre.

1 Por po të shihen të tëra, e kemi dëgjuar këtë, ata që e kanë
2 thënë me dhjetëra herë që duhet të shihen të tëra provat. Por
3 pasi kështu mund të trajtohet një çështje gjyqësore e kësaj
4 natyre. Por, në fakt, kur bie fjala për të justifikuar një
5 pretendim kaq serioz sa kjo edhe nuk i shikojnë provat në
6 tërësinë e tyre. Por shikojnë vetëm një përzgjedhje fare të
7 ngushtë dhe këtë e bëjnë qëllimisht, pasi do të minonte të
8 tërë pretendimin që kanë ngritur.

9 Diapozitivi 4.

10 Dhe kjo është rregullorja, që është një temë që
11 përsëritet po kështu gjithë kohën. Intervista që ka dhënë
12 shumë vite më vonë Veseli lidhur me SHIK-un dhe punën e tyre.
13 Por tani të flasim për disa prej rregulloreve. P83,
14 rregulloret e Shtabit të Përgjithshëm, Zyrapit dhe dëshmi për
15 këtë, që është dëshmitari i tyre më i mirë. Ata nuk e citojnë
16 këtë. Në fakt, kur pyeti Trupit Gjyqësor nëse drejtori,
17 praktikisht, që ka drejtuar punën e njësive vartëse dhe ka
18 mbikëqyrur edhe aktivitetin ushtarak dhe kjo është pjesa e
19 nënvijëzuar, ju pyetët në mënyrë specifike, të nderuar
20 Gjykatës, për këtë dhe përgjigja e tij ishte:

21 "Kjo ishte një e vështirë në praktikë pasi drejtori nuk
22 ishte i pranishëm për një periudhë të gjatë, dhe prandaj këtë
23 pjesë nuk ishim në gjendje ta zbatonim."

24 Dhe është në përputhje me përgjigjen që z. Mustafaj i dha
25 Trupit Gjyqësor të cilën e përmenda më herët.

1 Dhe ai më pas tha që:

2 "Ky ishte një përkthim i dokumenteve modele që kishin
3 marrë nga ushtritë perëndimore."

4 Dhe kjo gjendet në transkriptin 18443.

5 Kopjimi, të nderuar Gjykatës, nuk provon që një gjë të
6 jetë zbatuar në praktikë siç e ka shpjeguar z. Zyrapi dhe këtë
7 e ka konfirmuar, konfirmoi që këto ishin dokumente që
8 shërbenin si aspiratë për zhvillimet e ardhshme dhe kjo
9 gjendet në transkriptin 18494 deri në 5. Dhe ZPS-ja dje, në
10 fakt të hënën, z. Quick mu duk sikur e pranoi për herë të parë
11 një gjë të tillë, pra, që bëhej fjalë për aspirata.

12 Diapozitivi tjetër numër 5.

13 Kjo është një rregullore tjetër që citohet nga ZPS-ja.
14 Dhe pjesa e nënvijëzuar, mendoj unë, që është pjesa dhe kyçi
15 të cilin deshën që ne ta shikonim. Bëhet fjalë për rregulloren
16 provizore që ka të bëjë me çështjen e kondicionit në fushën e
17 betejës. Z. Zyrapi dha dëshmi për këtë. Është T18486.

18 E shpjegoi se nga vinin, kush i ka bërë, kush i ka
19 shpjeguar. Në zona tha që nuk i kanë patur këto rregullore.
20 Dhe, në fakt, z. Veseli s'ka pasur asgjë të përbashkët me
21 këtë, pasi ai ishte shefi i inteligjencës. Kjo është një
22 prokurori që mund ta bëjnë nxënësit e klasës së parë. Ai duhet
23 të tregojë që këto rregullore kishin lidhje me të në një farë
24 mënyre të njëmendtë me qëllim që të bazohet në këtë dokument
25 për të treguar që ka qenë shefi i inteligjencës në tërë

1 Kosovën dhe ka mbikëqyrur të gjithë politikën e shënjestrimit
2 të kundërshtarëve në Kosovë. Nuk mund, thjesht, që ku dokument
3 vetëm të përmendet dhe të thuhet "inteligjenca" dhe asgjë më
4 tepër.

5 Të nderuar Gjykatës, po t'i lexoni këto rregullore nuk
6 shihni asgjë aty, këto janë kopje nga ushtritë, nuk shihet
7 asgjë aty që është kriminale. Janë kopje të kopjuara nga
8 ushtritë perëndimore dhe nuk mund të thuhet që këto janë
9 rregullore me të cilat frymëzoheshin njerëzit për të kryer
10 krime. As nuk mund të fillohet të mendohet që kjo ekziston.

11 Pastaj kalojmë në diapozitivin 6.

12 Të nderuar Gjykatës, pretendimi këtu është që z. Veseli
13 është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punës së të
14 gjitha njësive të inteligjencës. Dhe thonë që ka prova që ai
15 ka caktuar detyra dhe ka marrë raporte. Dhe është diapozitivi
16 6 që flet për këtë çështje. Dhe këtu për këtë bazohen në një
17 pjesë të pyetjeve që i kanë bërë z. Qadraku. Është kërkesa e
18 vetme që përmenda pak më herët. Dhe do të shihni këtu që data
19 është e 1 prillit 1999 në rreshtin e tretë ku thuhet që:

20 "Ishte kaos në atë kohë. 4.000 ushtarë kanë hyrë në zonën
21 e Kleçkës dhe të Divjakës dhe në këtë kaos unë kam takuar z.
22 Veseli."

23 Kështu thotë që takimi ishte i rastësishëm. Dhe
24 Prokuroria këtu thotë që mund të konstatohet nga kjo që ka
25 caktuar detyra. Ai ka bërë -- z. Qadraku tha që:

1 "... unë bëra kërkesë, propozova që të shkoja ta takoja
2 për të arritur për të kuptuar që çdo gjë funksiononte si në
3 rregull dhe e kam realizuar me sukses këtë punë."

4 Por nuk tha që kishte raportuar. Z. Qadraku nuk tha që
5 kishte raportuar që të thoshte "E përfundova me sukses këtë.
6 Kështu ndodhi". Ky është konteksti i atij që u takua me të, i
7 tha "mund ta bësh këtë gjë" dhe atë e bën. Dhe ky është
8 shembulli i vetëm që citohet në poshtëshënim. Nuk provon
9 përtej dyshimit të arsyeshëm që bëhet fjalë për një kërkesë
10 për caktimin e punëve apo detyrave.

11 Siç e thashë përpara, Qadraku ka thënë që nuk ka marrë
12 urdhër nga z. Veseli dhe nuk ka raportuar para tij. Nuk ka
13 ekzistuar një raportim paralel. Dhe kjo ka vlerë për të gjitha
14 zonat operative.

15 Diapozitivi 7.

16 Tani bëhet fjalë për marrjen e raporteve. ZPS-ja citon
17 një pjesë të gjatë. Ne e kemi përmbledhur. Kjo është një
18 përmbledhje e dëshmisë kryesore, provave kryesore të
19 paraqitura. Dhe këtu bëhet fjalë se çfarë ka thënë Naser
20 Krasniqi për një datë të pacaktuar në maj. Ky është takimi, të
21 nderuar Gjykatës, që thashë që do ta përmendja. Kemi patur një
22 bisedë të shkurtër dhe ku e informoi z. Veseli lidhur me të
23 ashtuquajturin çështjen e Krojmiri rastin kur pesë ushtarakë,
24 policë ushtarakë janë vrarë ose rasti i pesë, të ashtuquajtur,
25 rasti i pesë policëve ushtarakë të cilët janë akuzuar për

1 ndalime arbitrare dhe për keqtrajtimin e civilëve të izoluar
2 në prill, pra, një muaj më parë.

3 Edhe kjo është pjesë ku z. Krasniqi e bën të qartë që ka
4 diskutuar këtë çështje të ngjashme me z. Veseli. Thotë e
5 takoi, e pyeti për këtë dhe dha informacione të përgjithshme
6 lidhur me të dhe u largua.

7 Ata nuk citojnë këtu kundërpyetjet e bëra. Edhe një herë
8 e përzgjedhin këtë nga tërësia e të gjithë sfondit, pasi gjatë
9 kundërpyetjeve z. Krasniqi bëri të qartë se nuk ka marrë
10 urdhër nga z. Veseli, nuk e kanë trajtuar asnjë rast specifik
11 me të më parë. Ai tha që z. Veseli nuk ka marrë pjesë në asnjë
12 hetim lidhur me çështjen e Krojmirit dhe/apo në ndonjë vendim
13 të marrë lidhur me këtë çështje. Dhe kjo gjendet në faqen e
14 transkriptit 24771. Diskutimi lidhur me këtë çështje ishte i
15 natyrës së përgjithësuese. Z. Veseli nuk ka marrë pjesë në
16 hetimin e asnjë çështjeje tjetër apo ndonjë vendim tjetër
17 lidhur me çështje të ndryshme. Nuk ka marrë pjesë në asnjë
18 vendim për paraburgosjen e ndonjë personi në Kleçkë apo për
19 lirimin e tyre. Dhe ky ishte diskutimi i vetëm që ka patur me
20 z. Veseli. Nuk ka patur diskutime të ngjashme me të apo të
21 natyrës zyrtare. Pra, nuk ka ekzistuar asnjë lloj raportimi.
22 Nuk ka marrë urdhër dhe nuk i ka raportuar atij dhe kjo,
23 megjithëkëtë, citohet si një provë e marrjes së raporteve nga
24 njësitë e inteligjencës, është një shembull i këtij takimi
25 shumë të shkurtër lidhur me një çështje në të cilën z. Veseli

1 nuk ka patur asnjë rol dhe për të cilin ka marrë vetëm
2 informacion të përgjithësuar.

3 Këtu nuk bëhet fjalë fare për marrjen e raporteve nga të
4 gjitha zonat. Në fakt nuk flitet fare as për inteligjencë. Nuk
5 është raportim ky, dëshmitari e tha këtë gjatë kundërpyetjeve
6 që iu bënë. Atëherë si mund ta bëjë këtë pretendim, këtë
7 parashtrim ZPS-ja?

8 Dhe po të kalojmë në diapozitivin tjetër ku flasim për
9 Dëshmitarin W04747. Po e përmbledh pasi ka [REDAKTUAR]
10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR] . Nuk është e lidhur me çështjen e Krojmirit,
15 është krejt e veçantë dhe përpiqen që ta përdorin këtë për të
16 thënë që ky pretendim mbështet atë që po themi ne, pa i bërë
17 asnjë pyetje dëshmitarit në fjalë.

18 Nuk ka lidhje me asnjë prej provave të poshtëshënimeve të
19 tjera.

20 Siç e kemi shpjeguar në dokumentin tonë, në dosjen tonë,
21 Dëshmitari W04747 është një dëshmitar i cili nuk mund të
22 mbështetet dhe është i spikatur fakti se nuk janë marrë
23 dëshmitarë të tjerë, nuk janë thirrur dëshmitarë të tjerë nga
24 Prokuroria për të dhënë dëshmi në sallë lidhur me këtë zonë.
25 Përse nuk ka ndodhur kjo gjë? Të nderuar Gjykatës, ju nuk mund

1 të mbështetni në këto thashetheme, pavarësisht rasteve kur
2 këtë e përmend ZPS-ja, nuk ka asnjë bazë. Kjo nuk është diçka
3 që mund ta ndihmojë Prokurorinë.

4 Kaq pra. Këto janë poshtëshënimet lidhur me këtë fjali të
5 paragrafit 510. Siç e thashë ne kemi diapozitiva për të gjithë
6 paragrafët. Janë mbi 500 diapozitiva. Dhe që të gjithë
7 tregojnë të njëjtin model, mungesë të provave, përdorimin e
8 gabuar të tyre dhe shembullin, citimin e vetëm një shembulli
9 për të ngritur akuza më të gjerësishme.

10 ZPS-ja mund të thotë kur të përgjigjen të mërkurën që
11 këto janë shembuj, ne nuk do të citojmë çdo gjë. A janë këta
12 shembujt më të mirë të tyre? Jam i sigurtë që do të citohen më
13 të mirët. Po a janë këto vërtetë më të mirët? Edhe në qoftë se
14 ka diçka tjetër, për çfarë mendojnë? Për P500? E kemi dëgjuar
15 për këtë provë material në të cilin Qadraku dha dëshmi dhe tha
16 që ia dërguar komandantit të zonës dhe jo Shtabit të
17 Përgjithshëm apo z. Veseli. Dhe e tha aq shumë qartë që nuk e
18 ka ditur nëse është dërguar në Shtabin e Përgjithshëm apo e
19 kanë marrë ata. Ai ka raportuar përmes komandës së zonës. Dhe
20 nuk ka prova që të provojnë të kundërtën. Kjo gjendet në faqen
21 e transkriptit 22714, 715 dhe 22722, 28.

22 Zyrapë po kështu ka dhënë dëshmi që P500 nuk është marrë
23 në Shtabin e Përgjithshëm.

24 Ky diapozitiv mund të hiqet nga ekrani pasi nuk ka të
25 bëjë me P500.

1 Ai tha që nuk ka arritur ky dokument atje. Dhe kjo
2 gjendet në faqen e transkriptit T18253.

3 Edhe në qoftë se nuk i besoni këto gjëra, të nderuar
4 Gjykatës dhe të thoni që po përpiqen të mbulojnë diçka e
5 kështu me radhë. Megjithëkëtë nuk është provuar se kush i ka
6 hartuar këto dokumente. Nuk është provuar as se këto
7 dokumentet të kenë arritur në Shtabin e Përgjithshëm, apo që
8 ka patur dijeni mbi to z. Veseli apo që ka ekzistuar ndonjë
9 raportim paralel. Dhe nuk mund të thuhet thjesht një dëshmitar
10 ka thënë të vërtetën për këtë, nuk mund të thuhet e kundërta
11 që është provuar që ata po gënjejnë. Në qoftë se nuk mund të
12 mbështetesh në këta dëshmitarë, atëherë nuk mund të thuash që
13 janë të mbështetshëm, nuk mund të arrish as në konkluzionin që
14 është provuar dhe vetëm përmes provave mund të provohet një
15 gjë. Prokuroria duhet të sjellë prova të tjera.

16 Megjithëkëtë janë mbështetur në këta dëshmitarë, e keni
17 parë këtë. E keni parë që janë mbështetur në Qadrakun për të
18 thënë që klienti im ka qenë drejtuesi i të gjitha njësive të
19 inteligjencës. A është e kjo e vërteta? Vetëm për shkak se nuk
20 përshtatet me argumentet e tyre? Ky është një argument i
21 dyshimtë i cili duhet hedhur poshtë.

22 Ata thanë që në qoftë se P500 nuk mund të shfrytëzohet,
23 atëherë të kthehemi tek P709? Z. Tieger e përmendi këtë. Ai
24 përmendi referencën ndaj "Shef Lulit". Dhe ekziston edhe një
25 dokument tjetër i ngjashëm, P186, i cili nuk e ka këtë

1 referencë të shkruar me shkrim dore ku përmendet "Shef Luli",
2 është i datës 18 gusht. Prokuroria asnjëherë nuk e ka sqaruar
3 se për çfarë bëhet fjalë.

4 Të nderuar Gjykatës, ju keni dëshminë e z. Qadraku lidhur
5 me këtë çështje që ka thënë që nuk e ka parë më parë P709, që
6 P1862, e ka dërguar dhe është ajo që nuk e ka të shkruar "Shef
7 Luli" në këtë dokument, këtë ia ka dërguar komandantit të
8 zonës dhe nuk ka ekzistuar raportimi paralel dhe nuk mund të
9 hidhet poshtë. Prokuroria ka barrën për të provuar përtej
10 dyshimit të arsyeshëm këtë gjë. ZPS-ja nuk ka arritur që të
11 provojë që ka ekzistuar standardi kriminal që përmend P709,
12 ajo është siç ka ndodhur, nëse është dërguar, është marrë,
13 kishte të bënte kjo me z. Veseli apo jo, e ka marrë apo e ka
14 parë këtë, ndonjë gjë të ngjashme me këtë.

15 Mesa dimë ne edhe po të ishte reale, mund të ishte
16 dërguar atij dhe mund të kishte qenë gabim ajo, mund të kishte
17 thënë që: S'është për mua. Unë nuk jam G2. Nuk jam
18 inteligjenca. Dërgoja dikujt tjetër.

19 Të gjitha këto çështje do të duheshin eksploruar. Nuk na
20 takojnë neve që të provojmë këto gjërat. Ata duhet ta bëjnë
21 këtë me të gjitha deduksionet që kanë nxjerrë dhe nuk e kanë
22 bërë një gjë të tillë.

23 Megjithëkëtë, ZPS-ja nuk ka provuar që z. Veseli të ketë
24 qenë si shef i SHIK-ut në vitin 1999, të merrej me çështje të
25 transferimeve nga një zonë në një zonë tjetër në UÇK edhe në

1 qoftë se ka qenë në funksionim në atë kohë. Nuk ka absolutisht
2 asnjë provë që ta mbështesë këtë pretendim. Ky është dokumenti
3 i vetëm që përmendin atë në të cilin mbështeten. Po nuk e di
4 se çfarë konkluzioni mund të nxjerrin nga kjo. Nuk ka asgjë
5 tjetër. Asnjë dokument nuk është thirrur për të vërtetuar
6 këtë. Është thjesht një dokument thashethemi. Siç e kam thënë
7 edhe një herë nuk mund të konstatohet fajësia mbi bazën e
8 dëshmive të paprovuara.

9 Fakti që unë kam patur mundësinë për t'i bërë pyetjet
10 Qadrakut për këtë dokument nuk e zgjidh këtë çështje. Në fakt,
11 kjo e minon të gjithë argumentin e ZPS-së, nuk konfirmon ky
12 dokument të vërtetë për përmbajtjen që ka, pavarësisht se cila
13 është kjo e vërtetë. Por nuk zgjidhet ky problem, nuk mund t'i
14 bëhen pyetje një personi i cili të thotë që është i përfshirë
15 në shkruarjen e kësaj apo të asaj. Nuk ka prova për ta
16 mbështetur këtë. Si provohet një gjë e tillë? Nuk është e
17 provuar.

18 Dhe këto, të dy këto dokumente, ZPS-ja mund të thotë që
19 kanë qenë thjesht shembuj.

20 Ato mund të kishin shtuar dhe këto të tjerat. Po përsëri
21 argumenti nuk çohet më tutje. Nuk ka të tjera. Dhe ky model
22 vazhdon në të gjithë kohën, në të gjithë dokumentin. Edhe një
23 program tjetër të shtrembëruar. Edhe një herë jemi në
24 paragrafin 510. Është ky një shembull tjetër i shtrembëruar
25 dhe këtu thuhet që:

1 "Ai kultivoi dhe mbrojti sekretin që u ka lejuar të
2 funksionojnë operacionet e inteligjencës kundër
3 kundërshtarëve, pavarësisht se mesazhi publik ishte i moderuar
4 me qëllim që të mos kritikohet nga jashtë."

5 Poshtëshënimi 2103 është dhe burimi për këtë thënie.

6 Edhe një herë e gjitha vjen nga dëshmia e z. Veseli në
7 vitin 2011, 2012 kur është pyetur për SHIK-un pas lufte. Nuk
8 kishte asgjë që t'i përkiste periudhës së luftës. Dëshmia nuk
9 thotë asgjë lidhur me sekretin e operacioneve kundër
10 kundërshtarëve sidoqoftë, gjatë apo pas luftës. Dhe ky është
11 një keqinterpretim.

12 Z. Veseli ka diskutuar SHIK-un dhe arritjen e tij,
13 zhvillimin e tij të ngadalshëm nga korriku i 1999-s, pas
14 luftës në vitin 2000 e më vonë. Foli për arkivat e SHIK-ut,
15 për kur është formuar ai dhe se si e kanë ndihmuar atë
16 shërbimet e inteligjencës së vendeve të zhvilluara. Që të
17 gjitha këto janë tema që kanë të bëjnë me periudhën e pas
18 luftës dhe jo me operacione kundër kundërshtarëve. Dhe më pas
19 ka parë se si anëtarët e SHIK-ut do të duhej t'i përmbaheshin
20 sekretit dhe të mos nxirrnin informacione dhe, siç i ka
21 shpjeguar, këtë e ka thënë që është diçka e cila pritet të
22 jetë e vërtetë në të gjitha sistemet e zbulimit kudo në botë.
23 Pra, është sekret pasi shërbimet e inteligjencës e bëjnë punën
24 e tyre në atë mënyrë, nuk i tregojnë njerëzve se çfarë po
25 bëjnë.

1 Dhe është edhe në këtë rast një model i riciklimit të një
2 incidenti të vetëm në të cilin i shtojmë një intervistë
3 medieje apo diçka nga 4747, ndoshta disa faqe nga një libër
4 dhe e gjitha nxirret jashtë çdo lloj proporcioni. Dhe është
5 një model i cili përsëritet. Citohen në prova të dobëta dhe të
6 cilat sa herë që të citohen nuk e përmirësojnë situatën.
7 Megjithatë Prokuroria vazhdon ta përsërisë këtë gjë duke
8 menduar se do të ketë impakt. Po është e kundërta. Nuk
9 përmirësohet situata. Dhe tregon sesa mangësi ka argumenti që
10 duan të bëjnë.

11 Të nderuar Gjykatës, ajo që desha të bëja është të
12 përmendja një apo dy shembuj. Pothuajse po i arrin fundi
13 parashtrimit tim. Dhe thashë që kemi për një orë, por unë do
14 të përfundoj sigurisht nga ora 1.00, ndoshta mund të bëjmë
15 pushim deri në orën 12.15 dhe pastaj të përfundoj në 45
16 minutat e fundit me qëllim që ta ndajmë pak këtë punë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do ta
18 bëjmë kështu.

19 Atëherë bëjmë një pushim prej 15 minutash. Takohemi
20 serish në orën 12.15 dhe do t'i lejojmë kështu z. Dixon ta
21 përfundojë.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 11.58

24 --- Seanca rifillon në orën 12.15

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal dëshiroj të them
2 se Mbrojtja nuk është dakord që citimet e bëra nga Gjykatësi
3 Mettraux mbështesin propozimin e bërë. Do e lë këtu për
4 momentin po thjesht doja që këtë ta thoja për procesverbal.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Z. Dixon mund të vazhdoni më tej.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

8 Dëshiroj të jap një tjetër shembull tani sepse është një
9 shembull që ka të bëjë me komunikatat. Jam i sigurt, të
10 nderuar Gjykatës, që ju do i merrni komunikatat parasysht gjatë
11 vendimmarrjes tuaj, dhe komunikatat janë një element që ZPS-ja
12 e ka theksuar shumë. Më konkretisht i referohem paragrafëve
13 520 dhe 521 të dosjes së ZPS-së. ZPS-ja pretendon dhe më
14 kujtohet, në fakt, që kur e kam lexuar këtë pretendim për së
15 pari kam bërë një shënim habitor te ky paragraf, ishte e
16 pabesueshme që e lexoja, por sipas ZPS-së thuhej që klienti im
17 ka lehtësuar shpërndarjen e deklaratave të UÇK-së që kanë
18 formuar shtyllën kurrizore të politikave të bashkëpunëtorëve.
19 Domethënë, që klienti im ka ofruar shtyllën kurrizore faktike
20 për gjithë komunikatat dhe deklaratat, dhe në provën 521
21 thuhet gjithashtu që ai ka dhënë informacionin që është
22 pasqyruar më pas në këto komunikatat. Pra, e gjithë gjëja
23 vinte prej tij sipas ZPS-së. Ndërkohë që nuk ka asnjë pikë
24 prove që mbështet këtë pretendim të ZPS-së.

25 Është e nevojshme që të krijohet kjo lloj lidhje midis z.

1 Veseli dhe komunikatave në një farë mënyre sepse kjo është e
2 vetmja mënyrë si lidhet ai me krimet. Megjithatë kjo është një
3 mënyrë dëshpëruese e ZPS-së për të fajësuar klientin tim dhe
4 nuk jep asnjë provë që e mbështet ose konfirmon këtë gjë. Edhe
5 gjuha ose formulimi që ka përdorur ZPS-ja është e tillë, është
6 e vagullt, është e përgjithshme.

7 ZPS-ja thotë që Kadri Veseli "ka marrë, ka vlerësuar dhe
8 ka transferuar, ka dhënë informacionin inteligjent që ka
9 formuar bazën e komunikatave". Domethënë, nuk është e qartë
10 fare se çfarë informacioni inteligjent bëhet fjalë. Kujt ja ka
11 dhënë Veseli këtë informacion. Dhe ZPS-ja nuk sqaron, për
12 shembull, në qoftë se Veseli i ka hartuar, i ka shpërndarë, i
13 ka dhënë për palë të tjera këto komunikata dhe kjo është
14 absolutisht e rëndësishme sepse në të kundërtën janë fjalë
15 boshe, janë fjalë kot. Në qoftë se ti ngre një pretendim të
16 tillë, ngre një akuzë të tillë, është e rëndësishme që të
17 japësh fakte dhe që të konfirmosh pretendime të tilla.

18 Pra, ZPS-ja nuk pretendon që Kadri Veseli i ka hartuar
19 këto, se nuk kanë pikë vlere dhe pikë prove lidhur me këtë,
20 është thjesht një fajësi për shkak të asociimit që e ka
21 mbuluar ndryshe ZPS-ja. Domethënë, me fjalë të tjera ZPS-ja
22 thotë që meqenëse keni qenë pjesë e Shtabit të Përgjithshëm,
23 keni pasur drejtimin e inteligjencës ose të zbulim-
24 kundërzbulimit, dhe është përgjegjësia juaj që të jeni
25 përgjegjës për sa takon përmbajtjes së tyre. Domethënë, nuk

1 është asgjë tjetër përveçse kësaj. Domethënë, është thjesht
2 një qëndrim dëshiror i Prokurorisë, ndërkohë që Prokuroria nuk
3 vërteton asgjë lidhur me këtë.

4 Ndërkohë, edhe poshtëshënimet që citohen nga Prokuroria
5 lidhur me këto pretendime kundër klientit tim, janë së pari,
6 11 pjesët e librit të z. Bytyqi, që është Nuhi Bytyqi
7 konkretisht, dhe kjo jepet në provën P1264. Megjithatë, në
8 qoftë se do të kalosh pjesët që përmend ZPS-ja, asnjë prej
9 këtyre pjesëve nuk ka të bëjë me bashkëpunëtorët ose politikant
10 e bashkëpunëtorëve. Kështu që nuk ka fare lidhje midis këtyre
11 pjesëve dhe z. Veseli. Më tej, Prokuroria vazhdon me vizitën e
12 Kadri Veselit në Kosova FreePress, në Shtypin e Lirë të
13 Kosovës me datë 12 maj 1999. Është takimi që ata e përmendin
14 në provën 515. Dhe kaq, asgjë tjetër. Dhe më duhet të them që
15 edhe më i zellshmi i faktmbledhësve nuk mund të arrijë në
16 përfundimin që kjo përbën lehtësim të nxjerrjes së deklaratave
17 mbi bashkëpunëtorët. Edhe Kardinal Richelieu vetë nuk mund të
18 gjente arsye për vendim fajësie në këtë arsye të ZPS-së.

19 Ndërkohë kemi një tjetër dokument të cilit i referohet
20 ZPS-ja që është prova 00515 përkthimi jepet në pikën 59, dhe
21 bëhet fjalë për një raport të radios Kosova e Lirë, është një
22 raport që ka të bëjë me periudhën maj, qershor 1999. Ndërkohë
23 që Kadri Veseli në atë raport nuk përmendet fare, në qoftë se
24 e keni lexuar.

25 Ndërkohë sa i takon komunikatave të rregullta me anëtarët

1 e Shtabit të Përgjithshëm përshirë këtu dhe z. Thaçi,
2 Prokuroria thotë që z. Veseli ka marrë, ka vlerësuar dhe ka
3 transferuar informacionin inteligjent që përbënin vlera
4 faktike për komunikatat. Por, nuk jepet asnjë lloj citimi për
5 mbështetjen apo konfirmimin e këtij qëndrimi të Prokurorisë.
6 Për shembull, sa i takon citimeve lidhur me marrëdhënien e z.
7 Thaçi dhe z. Veseli, nuk nxjerrin asgjë të keqe midis
8 komunikimeve të tyre. Këta janë persona që e kanë njohur
9 njëri-tjetrin edhe para luftës dhe pas luftës.

10 Pretendimi që Veseli ka dhënë informacion për komunikatat
11 e Shtabit të Përgjithshëm dhe deklaratat e Shtabit të
12 Përgjithshëm është shumë i rëndësishëm për ZPS-në, sepse nuk
13 ka asnjë provë të deklaratave të asaj kohe të Veselit. Dhe në
14 përpjekje të dëshpëruara të saj, ZPS-ja mundohet që të kapet
15 mbas fjalëve të thëna prej tij më pas. Pavarësisht kësaj, ZPS-
16 ja i referohet vetëm tre provave dhe këto tre prova kanë të
17 bëjnë me vetmen komunikatë që nuk ka pikë lidhje me Kadri
18 Veselin.

19 Dhe kjo jepet në poshtëshënime në paragrafin 5212,
20 Komunikata 80 që është prova P1752 që është lëshuar në qershor
21 të vitit 1999 - kohë kjo kur z. Veseli nuk e kishte më atë
22 post. Dokumenti i referohet informacionit të marrë nga zona
23 operative e Drenicës, domethënë këtë titull ka informacioni.
24 Dhe ka të bëjë me një sulm që ka të bëjë me bashkëpunëtorë të
25 perceptuar. Nuk ka pikë prove që z. Veseli ka të bëjë apo ka

1 lidhje me këtë komunikatë, sepse në atë kohë z. Veseli nuk
2 punonte fare për G2-shin, ndërkohë fakti që përmendët zbulim-
3 kundërzbulimi i zonës nuk mund të provohet përtej dyshimit të
4 arsyeshëm që z. Veseli kishte ndonjë lidhje me zonat.

5 Sigurisht që ZPS-ja e di që të duhet të gërmojë pak më
6 tej, dhe për këtë arsye ata citojnë dy deklarata dëshmitarësh
7 që janë: Dëshmitari i parë është 4324 dhe kjo jepet në provën
8 P2868, 2869 në poshtëshënimin 2150. Dëshmitari identifikon ata
9 të cilët sipas tij e kanë sulmuar, mbështetur në komunikatën
10 në fjalë dhe njëri prej sulmuesve, sipas tij, është Sabit
11 Geci. Dhe këtu nuk e kemi fjalën për Sabit Gecin e NPK-së por
12 një të afërm të tij. Ta bëjmë të qartë, dhe kjo në fakt është
13 diçka e cila del e qartë nga vetë ZPS-ja. Ndërkohë, sikurse e
14 dini ZPS-ja në vetvete ka parashikuar marrjen në pyetje të
15 dëshmitarit, bëhet fjalë për këtë dëshmitar ndërkombëtar që
16 jepet në transkript në T27137. Dhe z. Halling tha, për ata që
17 janë këtu në sallën e gjyqit, edhe na dha një listë të gjatë
18 numrash provash. Edhe më kujtohet që unë po thoshja pse po na
19 i jep këto numra provash Halling. Dhe tani, vetëm tani e
20 kuptoj që ai po përpiqej të na jepte paralajmërimin që do
21 fliste për një tjetër Sabit Geci që nuk ishte Sabit Geci i
22 NPK-së, por ishte një i afërm i tij.

23 Dhe as Sabit Geci i NKP-së dhe as Sabit Geci tjetër nuk
24 është i lidhur fare me klientin tim. Por, tani jemi në një
25 tjetër stad. Pra, nuk jemi - nuk pretendon Prokuroria që kemi

1 një lidhje me Sabin Gecin e NKP-së dhe pyetja që shtroj unë
2 këtu është që ky Geci i dytë tani është bërë një instrument
3 tjetër i ZPS-së. Kjo në vetvete të lë pa fjalë.

4 Nuk duhet të harrojmë që kjo e gjitha po mundohet që të
5 përdoret për të provuar që z. Veseli ka qenë shtylla kurrizore
6 e komunikatave dhe shpërndarjes së tyre.

7 Më lejoni të them, edhe gjithashtu në fakt do të jap një
8 tjetër shembull që mbase është shembulli i fundit që për mua
9 është shumë domethënës që ilustron problemin sistematik të ZPS-
10 së, jepet në paragrafin 523 ku parashikohet se z. Veseli është
11 koordinuar me Musë Jasharin, me komandantin e zonës së
12 Pashtrikut që ka qenë i përfshirë në krime, dhe ka koordinuar
13 ose bashkërenduar instrumentet e NPK-së me persona të tjerë,
14 si për shembull, me Limajn, Brahimajn, Gecin, etj. Pra, kemi
15 të bëjmë me fajësi për shkak të asociimit.

16 Kjo është hera e parë ku theksohet se z. Veseli ka qenë i
17 lidhur me z. Jashari këtu në një farë mënyrë. Prokuroria e
18 thotë këtë gjë por në fakt, asnjëherë nuk na e ka shpjeguar më
19 përpara, nuk e ka përmedur më përpara këtë gjë. Por tani është
20 shumë vonë për ta ngritur këtë pikë. Kur sheh provat që sipas
21 ZPS-së mbështesin këtë pretendim të tyre, unë do të thoja që
22 këto janë të gjitha gjepura. Për shembull do t'ju referoja
23 juve të shikonit poshtëshënimin 2157. Dhe z. Jashari nuk ka
24 pasur pikë lidhje me klientin tim. E vetmja gjë që e bën
25 "fajtor" klientin tim është një intervistë, është një

1 intervistë e vitit 2001, që pasqyrohet në provën P00413, ku
2 klienti pyetet se si është krijuar zona. Në përgjigje ai thotë
3 që ka punuar me disa persona. Domethënë përmend disa persona
4 në mënyrë të përgjithshme. Dhe Jashari thotë ndër të tjerë ka
5 qenë dhe z. Veseli. Ai thotë se e ka takuar atë edhe më herët,
6 domethënë përmendet në vija të përgjithshme ndërkohë që nuk
7 bëhet asnjë shpjegim lidhur me formacionin aktual të zonës, se
8 si mund të përfshiheshin ata në akte të caktuara bashkë. Dhe
9 mbi të gjitha ai nuk është thirrur asnjëherë për të dhënë
10 dëshmi këtu përpara jush, të nderuar anëtar të Trupit Gjykses.
11 Në qoftë se ky ishte një person kaq shumë i rëndësishëm për
12 vërtetimin e NKP-së, pse nuk e thirri Prokuroria këtë person?

13 Pra, përsëri ZPS-ja përdor fjalë që kanë qarkulluar dhe
14 nuk ka asnjëherë konfirmim dhe asnjë provë. Dhe në qoftë se do
15 shikoni mënyrën dhe arsyen se pse është pranuar kjo intervistë
16 e këtij dëshmitari, qëllimet janë të ndryshme, ndërkohë që
17 përdoret kjo intervistë për arsye të ndryshme. Dhe Prokuroria
18 e kupton që duhet që të përdorë të gjithë mjetet e mundshme
19 për të hedhur baltë.

20 Tani le të kalojmë tek pika që ZPS-ja nuk mbështetet tek
21 asnjë informacion ose ndonjë mbështetje tjetër për
22 intervistën, dhe mundësisht e pranojnë P1281. Mendoj se ju
23 kujtohet, të nderuar Gjykatës, ku e keni parë që z. Veseli ka
24 qenë i ulur pranë z. Jashari, por që nuk ka folur fare me të
25 dhe kjo jepet në paragrafin 788. Pra, i takon sipas ZPS-së që

1 në qoftë se t'i ulesh afër një personi në një dasëm dhe në
2 qoftë se t'i dëgjon intervistën e këtij personi, i takon që
3 sipas Prokurorisë, gjithmonë, ti je përgjegjës për të gjitha
4 krimet që pretendon ky person që ke kryer ti. Domethënë, kjo
5 është absurde.

6 E njëjta gjë vlen edhe për lidhjet e tjera të anëtarëve
7 të NKP-së. Për shembull, në qoftë se do shikoni
8 poshtëshënimet, do vini në përfundimin që klienti im nuk është
9 i përfshirë në asnjë prej krimeve të cilat pretendon
10 Prokuroria që ai ka kryer

11 Të nderuar Gjykatës, për të përfunduar me shembujt e NKP-
12 së ne parashtrojmë që ZPS-ja duket sikur po na tërheq zvarrë
13 me vete me kaosin e mbretit të mizave. Domethënë, sipas ZPS-së
14 është çdo lloj asociimi ka kuptim për aq kohë sa i shërben
15 asaj. Dhe si rezultat sipas nesh, ZPS-ja nuk mbështet dhe nuk
16 konfirmon absolutisht asnjë prej akuzave të tij. Dhe nga ana
17 tjetër, ka shumë pika të cilat mund të vërtetojnë që klienti
18 im është tërësisht i pafajshëm. Dhe ne parashtrojmë që
19 qëndrimi i Prokurorisë duhet të hidhet poshtë.

20 Ndërkohë, seksioni i fundit janë format e tjera të
21 përgjegjësisë, duke parë si qëndrimin tonë dhe duke e
22 ilustruar këtë qëndrim tonin me disa prej shembujve që janë
23 marrë prej dosjes së Prokurorisë.

24 Sikurse e kemi parashtuar në dosjen tonë përfundimtare
25 përgjegjësia eprore nuk qëndron fare, nuk është fare e bazuar.

1 Kontrolli efektiv është i vetmi prag përmes të cilës mund të
2 ndodhë kjo. Dhe pa NKP, pa strukturë komanduese për zbulim-
3 kundërzbulimin, kjo portë mbetet tërësisht e mbyllur për ZPS-
4 në. Pra, ZPS-ja këtë pistë nuk mund ta përdorë dot.

5 Këtu në këtë seksion të dosjes ne shohim një tjetër nivel
6 ku të gjithë përgjithësohen për sa i takon përgjegjësive të
7 tyre. Për shembull, mund ta shikoni, të nderuar Gjykatës, që
8 z. Veseli nuk përmendet as edhe një herë të vetme me emër e
9 mbiemër, vetëm thuhet që gjithë katër të akuzuarit janë
10 përgjegjës. Dhe nuk përmbushen standardet për të përcaktuar se
11 si elementë shumë të ngushtë të përgjegjësisë eprore, të
12 ndihmës dhe nxitjes janë përmbushur sipas Prokurorisë. Pra, në
13 qoftë se do të kontrolloni poshtëshënimet, në qoftë se do
14 kontrolloni tekstin lidhur me këtë pjesë të aktakuzës, do
15 shikoni që në dosjen e Prokurorisë nuk përmenden shprehimisht
16 të akuzuarit, por thjesht ata mundohen t'i përgjithësojnë të
17 gjithë dhe t'i fusin të gjithë në një trajtim.

18 Dua që t'i referohem këtu gjyqit të Tokios, duhet t'i
19 kthehem edhe një herë Luftës së II-të Botërore, që është një
20 element shumë i rëndësishëm megjithëse ky është një gjykim i
21 cili daton shumë kohë më përpara. Megjithatë, të nderuar
22 Gjykatës, në qoftë se do të mbani parasysh se në qoftë se
23 njerëzit duhet të largohen nga një organizatë, në qoftë se
24 gjejnë diçka të tillë si të vërtetë, çfarë thuhet në gjykimin
25 e Tokios thuhet që nuk është e nevojshme domosdoshmërisht që të

1 tërhiqesh ose që të japësh dorëheqjen. Edhe në qoftë se ke
2 qenë i informuar që të burgosurit janë keqtrajtuar. Ne nuk po
3 themi që kishte njohuri për të burgosurit e keqtrajtuar, mos
4 më keqkuptoni, por sipas gjykimit të Tokios edhe në qoftë se
5 kjo do të ishte e vërtetë, nuk është bazë për tërheqje.

6 Pra, Gjykatësit e këtij gjykimi thonë që Prokuroria duhet
7 të tregojë që para -- ka pasur një abuzim me administratën për
8 sa i takon trajtimin të administrimit të të burgosurve. Pra,
9 me fjalë të tjera, nuk është bërë asgjë efektive për ta
10 parandaluar këtë brenda kompetencave që ekzistonin në atë
11 sistem.

12 Kjo jepet në faqen 31 dhe 32 të Tribunalit Ushtarak për
13 Lindjen e Largët.

14 Pra, shikoni se sa të qarta janë ato kërkesa dhe
15 standarde se si ato duhet të vërtetohen. Domethënë, ne nuk po
16 flasim për neglizhencë të përgjithshme, por po flasim për
17 përgjegjësi individuale kriminale. Pra, është e nevojshme që
18 të demonstrojë që ti je pjesë e sistemit, që je pjesë e atij
19 sistemi që ekziston për administrimin e të burgosurve.
20 Pavarësisht në qoftë se bëhet fjalë për një konflikt të
21 armatosur ndërkombëtar ose një konflikt të brendshëm. Dhe
22 brenda këtij sistemi ti duhet të kesh njohuri dhe duhet të
23 kesh mundësi të marrësh hapa brenda kompetencave të tua për të
24 parandaluar krime të tilla. Ndërkohë në dosjen e Prokurorisë
25 nuk ekzistojnë prova për struktura të tilla për një sistem të

1 tillë ku ka qenë i përfshirë z. Veseli. Dhe thjesht ZPS-ja për
2 të gjetur një zgjidhje ka përmendur pjesën e NPK-së.

3 Dua të theksoj një tjetër element ligjor që është NPK-ja
4 III në paragrafin 605 të dosjes përfundimtare të ZPS-së. ZPS-
5 ja thotë që, pra, mosveprimi mund të çojë në kryerjen e
6 krimeve të akuzuara. Formulimi është shumë i gjerë, ndoshta
7 ZPS-ja qëllimisht nuk ka qenë e qartë, megjithatë është e
8 rëndësishme të theksoj që për NPK III duhet që së pari të kesh
9 kaluar nga NPK I, pra, duhet të kesh vërtetuar që ekziston
10 qëllimi i përbashkët për kryerjen e një krimi. Pra, duhet që
11 të jetë vërtetuar që je pjesë e NPK I. Duhet që të kalosh një
12 herë të gjithë kriteret për NPK I dhe pastaj të mund të jesh
13 në gjendje që të ngresh akuza lidhur me NPK III. Vetëm atëherë
14 mund të ketë parashikueshmëri, por ti nuk mund të thuash me
15 përgjegjësi që NPK III është i parashikueshëm ose që ke
16 dëgjuar në përgjithësi lidhur me këto gjëra. Pra, disa prej
17 këtyre krimet duhet të jenë në synuara. Është e nevojshme që
18 të krijohet lidhja me këtë synim përmes pjesëmarrjes dhe
19 veprimeve tuaja.

20 Ne këtë e kemi bërë të qartë në paragrafët tonë, pra, të
21 dosjes përfundimtare nga 650 në 653.

22 Në qoftë se ZPS-ja mundohet që të argumentojë që
23 parashikueshmëria mjafton, mendoj që kjo është çështje
24 juridike dhe duhet parë si e tillë.

25 Të nderuar Gjykatës, në përfundim u desh të prisnim

1 parashtrimet e z. Laws të martën në mënyrë që zëri i arsyeshëm
2 përmes pranimi se lufta çlirimtare të mund të bëhet me numrin
3 më -- duke qenë numri, pjesa dërmuese e anëtarëve të UÇK-së që
4 e kanë bërë këtë me arsye të mirë, me dëshirë të mirë, të
5 singertë dhe se -- por në të njëjtën kohë mund të jenë kryer
6 dhe krime të cilat, siç e theksoi ai, duhet të pranohen, dhe
7 për të cilat, natyrisht në mënyrë të pashmangshme, duhet të
8 ketë drejtësi.

9 155 viktimat në këtë çështje dhe të tjerët të cilët kanë
10 vuajtur meritojnë padyshim të gjejnë qetësi dhe drejtësi.
11 Vlerat njerëzore, dëshirat tona të përbashkëta që do t'i donim
12 ne të gjithë për veten dhe për familjet tona po të kishim
13 pësuar një dëm të ngjashëm apo në të njëjtën mënyrë.
14 Megjithatë, është gabim që ZPS-ja të ndjekë persona si Veseli,
15 në mënyrë të kotë me shpresën se kjo do të sjellë në zgjidhje
16 shpirtërore për viktimat.

17 Ajo që dua të them është që mund të shohim nga mendimi
18 bosh apo reflektimi bosh i ZPS-së në këtë çështje se ne nuk
19 mund të paraqesim këtë NKP pa përbërësin e shërbimit të
20 zbulimit, veçanërisht duke ditur se disa prej atyre që kanë
21 kryer krime në terren kanë pretenduar se janë të policisë
22 sekrete apo të shërbimeve të zbulimit apo diçka sekrete me
23 formula të ngjashme. Si do të mundej që shërbimi i zbulimit në
24 Shtabin e Përgjithshëm të lihet jashtë? Ata duhet ta mendojnë
25 këtë. Është një shembull klasik për të konstatuar fajësinë e

1 dikujt qoftë edhe në gjashtë rreshta të shkruar në një letër
2 të shkruar nga një njeri i ndershëm.

3 Duke e bërë këtë gjë, ZPS-ja ka lenë mënjanë punën
4 legjitime të ndërmarrë nga z. Veseli dhe të bërë në UÇK, dhe e
5 kanë lënë mënjanë shembullin që ai ka krijuar gjatë të gjithë
6 luftës për të promovuar UÇK-në jashtë vendit, dhe pastaj
7 mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare për të bashkuar
8 popullin e Kosovës dhe për të arritur marrëveshjen e paqes e
9 cila -- për të cilën u përgëzuan nga të gjithë si një prej
10 tranzicioneve më të suksesshme drejt paqes, dhe një shembull i
11 spikatur i partnershipit kombëtar dhe ndërkombëtar në arritjen
12 një rezultati përfundimtar të qëndrueshëm dhe unanim. Kjo
13 është platforma më e duhur dhe e vlerësueshme për të arritur
14 drejtësi në më shumë -- duke patur parasysh të gjitha
15 konfliktet që ndodhin në rajonet e ndryshme të botës.

16 Drejtësia është një konstante që i jep çdo personi dhe
17 çdo viktime atë që meriton. Viktimat meritojnë atë që ju
18 përket atyre ashtu siç meriton edhe z. Veseli atë që i përket
19 atij. Meriton, pra, një gjykim të drejtë dhe të duhur dhe
20 vendim të drejtë dhe të duhur. Ai duhet të lirohet dhe të
21 shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzuat. Të bëhet ndryshe
22 do të ishte një padrejtësi e madhe.

23 Faleminderit, të nderuar Gjykatës. S

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 z. Dixon.

1 Do të bëjmë pushimin e drekës dhe fillojmë në 2.30 siç e
2 kemi parashikuar.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
5 me Mbrojtjen e Selimit. Ndërpresim seancën deri në orën 2.30.

6 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.39

7 --- Seanca rifillon në orën 14.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

9 Jemi gati tani të vazhdojmë me deklaratën përmyllëse të
10 Selimit.

11 z. Roberts, keni fjalën.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

13 Mirëdita juve dhe të gjithëve në Gjykatë dhe jashtë saj.

14 Është nder dhe privilegji im të filloj parashtrimet

15 përfundimtare të mia në emër të klientit tim Rexhep Selimi,

16 pothuajse tre vite pasi paraqita fjalën, parashtrimet hyrëse

17 në emër të tij në prill 2023. Që nga ajo datë, z. Selimi ka

18 pritur me durim dhe me respekt gjatë gjithë gjykimit. Ka marrë

19 pjesë në çdo seancë qoftë fizik apo përmes videolidhjes dhe do

20 të dëgjoni z. Selimi kur të shprehet ditët e fundit të këtij

21 procesi.

22 Z. Selimi është tërësisht i pafajshëm për secilin prej

23 krimeve të pretenduara në aktakuzë. Siç e ka vërtetuar

24 Mbrojtja në mënyrë të gjerë në dosjen e saj përfundimtare, 380

25 faqe, ZPS-ja thjesht nuk ka arritur të përmbushë detyrimin e

1 saj për të vërtetuar asnjërën prej këtyre krimeve të
2 pretenduara përtej dyshimit të arsyeshëm. Kaq është, dhe kjo
3 është çështja jonë me pak fjalë, qëndrimi jonë. Mbrojtja nuk
4 ka detyrim që të vërtetojë se këto pretendime të Prokurorisë
5 janë të gabuara duke ngritur pretendime kundër z. Selimi ZPS-
6 ja nuk mund të transferojë përgjegjësinë, të përcjellë
7 përgjegjësinë tek Mbrojtja. ZPS-ja duhet të paraqesë prova që
8 kanë vlerë provuese janë koherente dhe relevante dhe dëshmi
9 dëshmitarësh të mbështetshme për të vërtetuar pretenduar
10 kundër z. Selimi, përtej dyshimit të arsyeshëm. Në të gjitha
11 këto aspekte Prokuroria ka dështuar ta bëjë këtë në mënyrë më
12 të qartë.

13 Do të ndaj kohën që është dhënë me ekipin e Mbrojtjes së
14 z. Selimi, pra, me z. Tully dhe z. Mair, dhe znj. Sheremeti.
15 Pres që të flas -- mendoj të flas për dy orë përpara se
16 kolegët e mi të marrin fjalën, dhe pastaj do të bëj
17 parashtrime përfundimtare. Gjatë të gjithë këtyre
18 parashtrimeve ne do të kërkojmë t'i përgjigjemi dosjes
19 përfundimtare të Prokurorisë dhe po ashtu të hedhim dritë dhe
20 të sqarojmë pa përsëritur disa aspekte në parashtrimet tona
21 përfundimtare.

22 Ndryshe prej Prokurorisë ne nuk kemi asgjë për të fshehur
23 lidhur me natyrën dhe përmbajtjen e provave tona. Në
24 parashtrimet tona gojore ne synojmë që të jemi sa më hapur dhe
25 transparentë që të jetë e mundur lidhur me qëndrimin tonë në

1 vend dhe jo që të fshihemi pas fjalive të pakuptimta apo të
2 dykuptimta. Do të trajtojmë provat që janë paraqitur në këtë
3 çështje dhe se çfarë ato, në fakt, na vërtetojnë dhe jo, atë
4 që ne shpresojmë që ato vërtetojnë. Do ta bëjmë këtë në mënyrë
5 të hapur për t'ju ndihmuar juve, Gjykatës, që të gjykoni
6 pretendimet, të vlerësoni dhe të vendosni për gjykim -- për
7 pretendime të ndryshme të ngritura nga ZPS-ja.

8 Të nderuar Gjykatës, ju keni patur mundësinë që të lexoni
9 parashtrimet e gjera të paraqitura nga avokati i z. Thaçi dhe
10 i z. Veseli. Ne i pranojmë ato dhe i mbështesim tërësisht dhe
11 nuk kemi -- dhe nuk synojmë që t'i përsërisim ato. Ne
12 qëndrojmë tërësisht pranë argumenteve tona faktike --
13 argumenteve tona ligjore dhe faktike të paraqitura me shkrim
14 në dosjen tonë përfundimtare gjatë të gjithë gjyqimit. Në
15 veçanti kundërshtimet ligjore lidhur me ekzistencën natyrën,
16 fushëveprimin e përgjegjësisë e NKP-së sipas të drejtës
17 zakonore ndërkombëtare si dhe kundërshtimi i drejtpërdrejtë i
18 NKP-së III për synimin konkret të krimeve siç përcaktohet në
19 dosjen -- është shpjeguar në dosjen tonë përfundimtare.

20 Sot synoj që të trajtoj thjesht tre çështje, aspekte të
21 cilat kanë të bëjnë me thelbin e pretendimeve të ZPS-së.

22 Pretendimi i parë, pretendimi për NKP në tërësi,
23 përfshirë natyrën e saj, qëllimi dhe pjesëmarrësit. Pretendimi
24 i -- kontributi i pretenduar i z. Selimi në këtë NKP, i
25 drejtpërdrejtë dhe strukturor përshirë ato pretendime,

1 përfshirë pretendimet për praninë e tij fizike -- pjesëmarrjen
2 e tij fizike në incidente si dhe rolin dhe autoritetin e tij
3 si inspektor i përgjithshëm dhe brenda Shtabit të
4 Përgjithshëm. Dhe në fund, synimi i pretenduar i z. Selimi.
5 Deklaratat e z. Selimi.

6 Përpara se të hyj në këtë çështje thelbësore dua thjesht
7 të trajtoj një çështje procedurale dhe kjo është çështje
8 themelore qendrore që, në fakt, ka ndikim tek një sasi e madhe
9 -- një pjesë e madhe e dosjes përfundimtare të Prokurorisë dhe
10 argumentet përfundimtare të paraqitura që ka të bëjë pra, me
11 mbështetjen -- fakti që ZPS-ja mbështetet në intervistën që z.
12 Selimi i ka dhënë ZPS-së dhe intervistat e tjera që ka dhënë
13 në Gjykatat e Kosovës, TPNJ-së dhe në media.

14 Sipas vlerësimit të Mbrojtjes intervista e Selimit dhënë
15 ZPS-së vetëm përmendet 326 herë në dosjen përfundimtare. Në
16 shumë prej atyre rasteve kjo intervistë është burimi i vetëm
17 mbi të cilën mbështetet ZPS-ja, përfshirë lidhur me faktet
18 materiale kundër bashkëtaakuzuarve dhe vetë kundër Selimit.

19 Roli i dyfishtë i z. Selimi -- roli i dyfishtë apo
20 detyrat e dyfishta të z. Selimi si ministër i punëve të
21 brendshme dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, me një këmbë
22 në ushtri dhe një tjetër në qeveri.

23 Ju keni dëgjuar nga avokati i z. Thaçi disa herë se ata
24 vlerësojnë se kjo intervistë është- se si Prokuroria është
25 mbështetur në këtë intervistë. Ne vlerësojmë se ajo është

1 mbështetur tërësisht. Tani siç e ka thënë Trupi Gjykues në
2 mënyrë të qartë, këto deklarata, intervista dhe transkripte të
3 z. Selimi, këtyre nuk mund t'ju jepet një peshë e
4 konsiderueshme pa patur konfirmimin për të përcaktuar,
5 vërtetuar pretendimin përtej dyshimit të arsyeshëm. Kjo është
6 një vlerësim kyç dhe i rëndësishëm për juve, për Trupin
7 Gjykues, në momentin që bëhet vlerësimi i provave që janë para
8 tyre. Tani Mbrojtja e dëshmitar - Mbrojtja nuk thirrej
9 dëshmitar, Mbrojtja e Selimit nuk thirrej dëshmitar dhe Selimi
10 përdori të drejtën e tij për të mos dhënë dëshmi. Për
11 rrjedhojë, në këtë Gjykatë asnjë prej fjalëve që mendohet që
12 janë thënë nga Selimi në intervistat e tij dhënë ZPS-së apo në
13 intervistat e tjera nuk janë verifikuar, kontekstualizuar apo
14 verifikuar nga ai. Nuk i ka korigjuar, qartësuar apo
15 ndryshuar intervistat mbi të cilat mbështetet Prokuroria,
16 përkundër shumë dëshmitarëve të Prokurorisë të cilët kanë
17 verifikuar me kujdes deklaratat e tyre të mëparshme shpesh me
18 ndihmën e avokatit, dhe të cilat kanë dhënë shpesh kanë bërë
19 korigjime të gjera në deklaratat e tyre. Z. Selimi nuk ka
20 bërë betim përpara juve për saktësinë e dëshmisë që i ka dhënë
21 ZPS-së.

22 Dhe siç e di Trupi Gjykues një shqyrtim dhe verifikim i
23 hollësishëm që iu jepet -- që dëshmitarët duhet të bëjë të
24 cilët pastaj paraqiten për të dhënë dëshmi në Gjykatës ka për
25 qëllim që gabimet e bëra në deklaratën e mëparshme, lëshimet,

1 ekzagjerimet, mendimet e gabuara për lëshimet e tjera në
2 intervistat e tyre të mëparshme të korrigjohen. Duke qenë se
3 ai nuk -- ai po merrej në pyetje për ngjarje që kanë ndodhur
4 përpara 20 vitesh me pak kontekst u përgjigj atyre pyetjeve pa
5 patur shënime apo referencat e tjera apo burime materiale. Nuk
6 është e habitshme që aty mund të ketë gabime, pra, në këto
7 deklarata.

8 Tani Prokuroria filloi të martën duke thënë që:

9 "Kishin parë rrallëherë ndonjë dosje përfundimtare në të
10 cilën vetë Mbrojtja ishte kaq shpërfillëse ndaj deklaratave të
11 klientit të tyre."

12 Kjo është në transkript. Mund të jetë e saktë,
13 megjithatë, z. Selimi nuk po akuzohet se ka dhënë një tregim
14 mbi të cilin nuk është i besueshëm apo i mbështetshëm apo që
15 nuk kujtohen ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën e largët.
16 Gabimet, lëshimet në kujtesën e tij mund të jenë, dhe këto në
17 fakt, minojnë mbështetshmërinë dhe peshën që duhet t'i jepet
18 kësaj prove.

19 Tani si gjithmonë Trupi Gjykses duhet të jetë tërësisht i
20 vetëdijshëm për këto faktorë si dhe kufizimi i rreptë që ka
21 vendosur Paneli i Apelit në vlerësimin e peshës që duhet t'i
22 jepet dëshmisë së tij.

23 Sa i takon çështjes procedurale që u trajtua, do të doja
24 të kaloj tek thelbi duke trajtuar Ndërmarrjen Kriminale të
25 Përbashkët që është pjesa e akuzës të Prokurorisë. Dhe dua të

1 them shumë qartë që në fillim se nuk ka ekzistuar ndonjë NPK
2 në të cilën ishte përfshirë z. Selimi apo të bashkëakuzuarit e
3 tij asnjë moment të periudhës së aktakuzës. Kjo është kështu,
4 ka qenë dhe mbetet, dhe ky është qëndrimi që mbetet, qëndrimi
5 kryesor parësor i Mbrojtjes. Në mungesë të Ndërmarrjes
6 Kriminale të Përbashkët nuk mund të ketë përgjegjësi për z.
7 Selimi për kryerje të krimeve përmes kësaj forme të
8 përgjegjësisë.

9 Dhe themi që për arsye të ndryshme, por kryesisht
10 pretendimi i ZPS-së për Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët
11 është i mangët në logjikë dhe i mangët në prova. Dhe kjo
12 shihet të çdo aspekt të NKP-së. Dhe tani do të ndaj
13 Ndërmarrjen Kriminale të Përbashkët, aspektet e ndryshme të
14 saj duke filluar me objektin e saj, pra të NKP-së.

15 Të nderuar Gjykatës, ju jeni tërësisht në dijeni se NKP-
16 ja siç paraqitet në aktakuzë për këtë gjë në paragrafin 32, se
17 në mes të marsit 1998 dhe shtator 1999 të akuzuarit dhe
18 anëtarë të Ndërmarrjes Kriminale e Përbashkët ndanë qëllimin e
19 përbashkët për të marrë dhe ushtruar kontroll në gjithë
20 territorin e Kosovës përmes frikësimit të paligjshëm,
21 keqtrajtimit dhe kryerjes së dhunës dhe largimit të atyre që
22 konsideroheshin kundërshtarë.

23 Tani, siç e kemi thënë në mënyrë të përsëritur në debatet
24 juridike të mëparshme në deklaratat hyrëse, në vetvete qëllimi
25 për të marrë dhe ushtruar kontroll në Kosovë nuk është

1 kriminal dhe është shumë larg nga kjo. Është e vetmja mënyrë
2 për t'i dhënë fund shtypjes sistematike dhe brutale të
3 popullsisë shqiptare në Kosovë nga forcat e dhunshme të
4 Milosheviqit.

5 Në këto rrethana ku objektivi i NKP-së është në vetvete
6 jokriminal, ndryshe si do të ishte kjo gjë në qoftë se do të
7 ishte Ndërmarrje Kriminale për të kryer torturë, vrasje,
8 Mbrojtja ka kundërshtuar përgjegjësinë e NKP-së -- që mund të
9 ketë përgjegjësi NKP në këtë rast. Ne e kemi thënë këtë në
10 paragrafin 567, 568 të dosjes tonë.

11 Ndërkohë që ndonëse disa Gjykata kanë lejuar
12 përgjegjësinë kriminale në rastet kur NKP thjesht synon që të
13 bëjë krime brenda statutit si mjet për të arritur objektivat e
14 tyre. Ne themi që kjo e zgjeron formën e ndërmarrjes -- e
15 përgjegjësisë së Ndërmarrjes Kriminale e Përbashkët të
16 formuluar nga Dhoma e Apelit në çështjen Tadic.

17 Ne e kemi ngritur këtë përpara dhe është trajtuar -- dhe
18 është konfirmuar se përkufizimi ligjor i qëllimit të
19 përbashkët dhe kriterit për NKP-në me qëllimin e përbashkët
20 ishin çështje që duhej të trajtoheshin në gjykim. Dhe ne themi
21 që forma e paraqitjes nga ZPS-ja në këtë rast dhe mënyra se si
22 ky rast, kjo çështje është paraqitur është qendrore dhe pika
23 kryesore për marrjen e vendimit nga ana e juaj.

24 Dhe në fund, në dosjen tonë përfundimtare në paragrafin
25 7, dhe gjithashtu në deklaratën hyrëse, Prokuroria ka

1 deklaruar se anëtarë të NPK-së me qëllim që të arrinin
2 qëllimin e pretenduar të marrjes dhe ushtrimit të kontrollit
3 në gjithë Kosovën kanë kryer krime kundër kundërshtareve të
4 perceptuar si të tillë.

5 Tani, formulimi duket se pranon se kryerja e krimeve mund
6 të -- duhet të ketë qenë rruga kryesore sipas të cilës plani i
7 përbashkët është zbatuar apo mënyra e zbatimit.

8 Pra, kryerja e krimeve duhet të ketë qenë mënyra kryesore
9 e realizimit të planit të përbashkët. Kjo nuk mund të jetë
10 rastësore për planin e përbashkët. Kjo është mënyra se si ZPS-
11 ja -- se si paraqitja e pretendimit të ZPS-së duhet, pra,
12 duhet të kuptohet. Nuk është e mjaftueshme që ZPS-ja thjesht
13 të paraqesë prova të një qëllimi jokriminal, në këtë rast për
14 të marrë dhe ushtruar kontroll në gjithë territorin e Kosovës
15 dhe që detyrimisht kjo përfshinte krime apo krime siç janë
16 përcaktuar në paragrafin e aktakuzës.

17 Dhe qëndrimi jonë është se si ju, Gjykatës, duhet të
18 vlerësoni NKP-në. Ju duhet të pranoni se ata janë pajtuar se
19 objektivi ishte kryesisht që të -- do të gjenin, të
20 konstatonin se kishte një pajtim, pra, një marrëveshje që të
21 bëheshin ato krime të renditura dhe që ato nuk ishin thjesht
22 të rastësishme në mënyrën se si kanë ndodhur.

23 Çështja e objektivit jokriminal në qendër, pra, që është
24 thelbi i provave të Prokurorisë, teoria e Prokurorisë duket se
25 kjo ishte qëllimi kryesor i të akuzuarve, përfshirë z. Selimi,

1 dhe jo lirimi, çlirimi i popullit të shtypur brenda vendit të
2 tyre. Por ishte thjesht një synim për të kapur pushtet në
3 mënyrë egoiste.

4 Në qoftë se duhet të besohet kjo teori, dhe kjo është
5 teori që është teoria kryesore qendrore e provave apo
6 pretendimeve të Prokurorisë z. Selimi dhe të bashkëakuzaurt e
7 tij jo vetëm që kanë arritur që të shmangin Adem -- që të
8 shmangin atë që Adem Jashari bëri, por edhe gjithashtu të
9 manipulojnë dhe të mashtrojnë mijëra vullnetarë të cilët kanë
10 rrezikuar dhe në shumë raste kanë dhënë jetën e tyre duke
11 luftuar për UÇK-në. Ne themi që teoria e Prokurorisë është
12 ofenduese dhe e pabazuar. Sa i takon qëllimit, qëllimit që
13 kishte NPK-ja, ne dëgjuam nga Prokuroria të hënën për qëllimet
14 shtesë përkrah atyre që janë paraqitur në aktakuzë dhe ata
15 deklaruar që:

16 "Objektivi i UÇK-së i arritjes së pavarësisë në Kosovë në
17 asnjë mënyrë nuk e mohon objektivin që kishin anëtarët e NKP-
18 së për të marrë dhe për të ushtruar kontroll në mënyrën siç
19 akuzohen".

20 Në fakt, në vend që të jetë një kundërtregues, logjika të
21 çon se pavarësia duhet të ishte parakusht për ata që të
22 merrnin kontroll të plotë dhe kjo është arsyeja -- një çështje
23 që "dikush me arsye të shëndoshë dhe jurisprudenca e
24 konfirmuar", sipas Prokurorisë se një person mund të ketë
25 objektiva të njëkohshëm të shumtë dhe për këtë iu referuan

1 çështjes Radovan Karadzic ku u konstatua -- konstatimi në
2 çështjen Radovan Karadzic se ai kishte marrë pjesë katër NKP
3 të ndara.

4 Kjo është tani qëndrimi jonë është që është tërësisht e
5 paqartë në këtë pikë nëse Prokuroria pretendon se ai në të
6 njëjtën kohë kishte qëllime të shumëfishta në zemër të kësaj -
7 - në qendër të kësaj NKP-je. A është ky objektivi apo qëllimi
8 i këtyre të akuzuarve, apo thjesht ka ndodhur që kishte -- apo
9 ishin të akuzuar të tjerë bashkë me këtë. A ishte kjo pavarësi
10 që kërkohet të arrihet përmes mënyrave, mjeteve të paligjshme,
11 apo ishte thjesht për t'u arritur përmes mjeteve të ligjshme.
12 Në qoftë se ekziston ndonjë objektivi i paligjshëm që vepron
13 përgjatë planit të pretenduar kriminal të ZPS-së, ZPS-ja nuk
14 jua ka shpjeguar këtë gjë juve. Ajo duhet të përcaktojë cilat
15 veprime ishin në funksion të planit të përbashkët dhe cilat
16 veprime nuk ishin në funksion të saj.

17 Në këtë mënyrë, parashtrimet e Prokurorisë lidhur me këtë
18 motiv ngrenë pikëpyetje më shumë sesa përgjigje.

19 Lidhur me z. Selimi drejtpërdrejtë dhe në mënyrë
20 individuale, provat nuk mbështesin konstatimin sa në një
21 mënyrë apo në një tjetër ka pranuar apo ka bërë marrëveshje të
22 marrë dhe të ushtrojë kontroll në gjithë Kosovën.

23 Tani, megjithatë për të cilën ju jeni në dijeni, duke
24 qenë i përfshirë në luftë për shumë vite përpara periudhës së
25 aktakuzës si pjesë e lëvizje, forcave guerile, klandestine,

1 motivimet e tij nuk ishin marrja e pushtetit personal,

2 motivimet e tij ishin thjesht çlirimi i popullit të tij.

3 Ai asnjëherë nuk ka kërkuar që të emërohet në pozita
4 autoriteti. Asnjë provë nuk sugjeron që ai ka kërkuar të
5 emërohet si inspektor i përgjithshëm apo ministër i rendit
6 publik. Kur Qeveria e Përkohshme pushoi së funksionuari në
7 fund të 1999-s, ai nuk kërkoi pushtet politik. U bë komandant
8 i Akademisë së Mbrojtjes dhe komandant i forcave të trajnimeve
9 në TMK. Ai nuk -- sepse -- këto fakte janë -- nuk përputhen,
10 pra, me këmbënguljen qorre dhe të pafund të pushtetit që
11 Prokuroria pretendon dhe don t'ja atribuojë atij.

12 Tani do të kalojmë tek anëtarët e pretenduar të
13 Ndërmarrje Kriminale e Përbashkët. Sa i përket, na tha
14 Prokuroria të hënën, në mënyrë të qartë, "shpallja fajtor dhe
15 dënimi, kërkohet kundërt Shtabit të Përgjithshëm dhe jo kundër
16 UÇK-së. Në mënyrë të ngjashme dhe të njëjtë nuk kërkohet
17 verdikt fajësie dhe -- dënimi -- verdikti i fajësisë nuk
18 kërkohet dhe dënimi nuk duhet të jepet mbi bazën e vetme të të
19 qënurit thjesht anëtar i Shtabit të Përgjithshëm apo i UÇK-
20 së".

21 Ne do të donim që ta besonim -- ne ashtu besojmë po ashtu
22 siç e tha edhe Mbrojtja e Thaçit, me këto fjalë shumë të mira
23 dhe të urta. Megjithatë, është pikërisht kjo që ZPS-ja po
24 kërkon të bëjë përmes paraqitjes së provave të tyre duke u
25 mbështetur në pohimet e përgjithshme spekulative lidhur me

1 Shtabin e Përgjithshëm dhe UÇK-në në tërësi për të kompensuar
2 boshllëqet dhe mungesat e provave në çështjen e tyre.

3 Siç e kemi thënë në paragrafin 573 të dosjes tonë:

4 "Personat me objektiv të përbashkët nuk janë detyrimisht
5 anëtarë të NKP-së. Është veprimi apo bashkëpunimi midis
6 personave, veprimet e tyre të përbashkëta që i bëjnë personat
7 një grup. Veprimi i përbashkët midis anëtarëve të Ndërmarrjes
8 Kriminale të Përbashkët duhet të vërtetohet".

9 Pra, nuk është e mjaftueshme që ZPS-ja të tregojë se z.
10 Selimi dhe anëtarët e tjerë të NKP-së kishin një objektiv të
11 përbashkët. Ata duhet të vërtetojnë se këta individë vepruan
12 së bashku për realizimin e këtij objekti. Por ZPS-ja e ka
13 zëvendësuar këtë kriter të veprimit të përbashkët me kriterin
14 e përgjegjësisë kolektive. Duken të ngjashme, por diferencat
15 janë shumë të mëdha.

16 Tani kjo -- për të tejkaluar mungesën e provave të
17 diskutimit specifik lidhur me marrëveshje për ndonjë politikë
18 të përbashkët ZPS-ja mbështetet në qëndrimin se -- në gjithë
19 dosjen e saj të marrëveshjes kolektive, vendimmarrjes
20 kolektive edhe kuvendimeve kolektive. Tani kjo përfshihet në
21 paragrafin 64 të dosjes së Prokurorisë, ku ZPS-ja pohon se
22 "Anëtarë të udhëheqjes së UÇK-së dhe strukturave komanduese
23 kanë konfirmuar se Shtabi i Përgjithshëm kishte dhënë urdhra
24 për të vrarë, ndaluar bashkëpunëtorë. Dhe zëvendëskomandanti
25 4401, për shembull, konfirmoi se ndonëse nuk kishte dokumente

1 me shkrim për raste konkrete, kishte vendime kolektive të
2 Shtabit të Përgjithshëm që autorizonte masa të mëtejshme për
3 bashkëpunëtorët”.

4 Siç e kam thënë, ZPS-ja bën, ngre pretendime të tjera të
5 shumta se Shtabi i Përgjithshëm është takuar dhe ka koordinuar
6 në mënyrë të shpeshtë -- dhe është koordinuar në mënyrë të
7 shpeshtë si proces i vendimmarrjes kolektive. Kjo është në
8 paragrafin 103 ose se kanë “bërë diskutime kolektive për
9 marrje vendimesh”. Ka shumë referenca për vendimet kolektive
10 brenda Shtabit të Përgjithshëm.

11 Megjithatë, kundërshtimet e shumta të Mbrojtjes lidhur me
12 këto -- nëse këto pohime ishin të sakta dhe pasqyronin, pra,
13 që pasqyroheshin në dëshminë e dëshmitarit, ato nxjerrin në
14 pah shkallën në të cilën Prokuroria nuk është në gjendje të
15 vërtetojë marrëveshjen, dakordësinë individuale të z. Selimi
16 për qëllimin kriminal që pretendon Prokuroria. Nuk përmendet
17 vendimmarrja kolektive, kuvendime për vendimmarrje kolektive,
18 nuk vërtetohet se z. Selimi në mënyrë individuale u pajtua me
19 politika të tilla dhe ZPS-ja ka dështuar tërësisht në
20 individualizimin e pretendimeve kundër tij.

21 Të martën Prokuroria në mënyrë të heshtur pranoi këtë
22 boshllëk në provat e tyre duke thënë se:

23 “Nuk është fajësi për pasojë të shoqërimit, por është
24 fajësi si me shoqërim të qëllimtë.”

25 Duhet të përgëzoj Prokurorinë për -- që arrin të bëjë

1 mungesën e provave ta paraqesë si një koncept ligjor në favor
2 të tyre dhe në interes të tyre. Koncepti i shoqërimit të
3 qëllimshëm nuk është asgjë më tepër sesa pranimi i heshtur nga
4 ana e Prokurorisë i gabimit në thelb të çështjes së tyre që
5 nuk arriti të individualizojë veprimet e z. Selimi apo të
6 ndonjë tjetër të akuzuari. Kjo vërtetohet në të paktën tre
7 mënyra të ndryshme.

8 Së pari, komunikatat mbi të cilat Prokuroria mbështetet
9 gjerësisht. Asnjë dëshmi e mbështetshme apo e verifikueshme
10 nuk është paraqitur lidhur me faktin se kush i shkruajti, i
11 hartoi këto komunikata. Asnjë anëtar i Shtabit të Përgjithshëm
12 nuk konfirmoi se aty ka patur diskutime lidhur me këto
13 komunikata. Asnjë shënim takimesh të Shtabit të Përgjithshëm
14 nuk përmend këto diskutime. Nuk ka bazë për të atribuar
15 përgjegjësinë gjithë të akuzuarve lidhur me këto.

16 Së dyti, takimet që pretendohet që kanë ndodhur në
17 Shtabin e Përgjithshëm apo mes Shtabit të Përgjithshëm dhe
18 komandantëve të zonave kanë boshllëqe të mëdha dhe këtu se
19 kush mori pjesë në këto takime, kur dhe ku, dhe se si
20 informacioni u nda në këto takime.

21 Së treti, urdhrat e lëshuar nga Shtabi i Përgjithshëm për
22 të vërtetuar sjelljen e perceptuar të Shtabit të Përgjithshëm
23 kundrejt bashkëpunëtorëve. Nuk ka prova se z. Selimi kishte
24 dijeni, ishte i përfshirë apo mbështeste këto urdhra të
25 supozuar. Fakti se z. Selimi ishte i përfshirë thjesht për

1 shkak të pozicionit që ai mbante në Shtabin e Përgjithshëm apo
2 pranisë në Kosovë në atë kohë nuk është asgjë më tepër se një
3 supozim nga ana e Prokurorisë.

4 Paragrafi 110 pretendon se 29 takime të Shtabit të
5 Përgjithshëm kanë ndodhur gjatë periudhë së aktakuzës,
6 megjithatë, ekzistenca e shumicës së këtyre takime është
7 shënuar thjesht si referencë në deklaratën e dëshmitarit apo
8 ndonjë një dokument tjetër. Për një numër të madh të këtyre
9 takimeve nuk ekzistojnë fare shënime, dhe për rrjedhojë ju, të
10 nderuar Gjykatës, nuk mund të jeni të sigurt në asnjë mënyrë
11 se çfarë bëri apo nuk bëri z. Selimi, për çfarë u pajtua po jo
12 si pjesë e Shtabit të Përgjithshëm nëse ai ishte mbështetës
13 apo jo si pjesë e këtij organi.

14 Dhe nuk mund të keni siguri se për çfarë kishte dijeni
15 apo jo ai sa i takon raportimit të Shtabit të Përgjithshëm në
16 tërësi. Të nderuar Gjykatës, dëgjuat disa herë gjatë këtij
17 gjykimi referenca për Shtabin e Përgjithshëm në tërësi dhe po
18 citoj, "I thashë Shtabit të Përgjithshëm", "ky informacion iu
19 dërgua Shtabit të Përgjithshëm", këto janë pretendime kaq
20 gjenerike në të cilat Prokuroria mbështetet për të atribuar
21 përgjegjësinë të gjithëve brenda kësaj organizate.

22 Referencat e përgjithshme të raportimit nga zonat, qoftë
23 policia ushtarake, shërbimet e zbulim-kundërzbulimit apo
24 pjesëtarë të UÇK-së thjesht nuk vërtetojnë se informacionet
25 konkrete i janë dhënë ndonjë individit që pretendohet të jetë

1 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, dhe sigurisht jo z. Selimi.

2 Tani lidhur me individët konkretë për të cilët Prokuroria
3 pretendon që kanë qenë anëtarë të Ndërmarrjes Kriminale të
4 Përbashkët, këta janë të renditur, Azem Syla, Fatmir Limaj,
5 Lahi Brahimaj, Sylejman Selimi, Rrustem Mustafa, Shukri Buja,
6 Latif Gashi dhe Sabit Geci. Kjo është në paragrafin 35 të
7 aktakuzës.

8 ZPS-ja përpiqet të mbështetet në afërsitë politike,
9 ideologjike të pretenduara të këtyre individëve që kanë
10 ndodhur përpara periudhës së aktakuzës, përfshirë z. Selimi.
11 Në veçanti se ai ishte anëtar i LPK-së dhe për pasojë kishte
12 lidhje me të akuzuarit e anëtarë të tjerë përmes këtij organi.
13 Mbrojtja e ka trajtuar këtë në hollësi në paragrafët 307 dhe
14 310 të dosjes së saj. Por, nuk ka ndonjë lidhje tjetër të
15 vërtetë, reale midis z. Selimi dhe qoftë z. Krasniqi apo z.
16 Veseli përpara periudhës së aktakuzës që të jetë e vërtetuar.

17 Në vend që të paraqiten prova për këtë marrëdhënie, apo
18 këto marrëdhënie, apo këtë marrëveshje midis anëtarëve të
19 ndryshëm të NKP-së së pretenduar, Prokuroria mbështetet në
20 vlerësime jorelevante të cilat janë pas kohës së formimit të
21 pretenduar të këtij krimi -- të kësaj marrëveshje dhe edhe pas
22 periudhës së vetë aktakuzës. Për shembull, Prokuroria
23 mbështetet në faktin se z. Limaj, z. Syla, z. Selimi u bënë
24 pjesë e këshillimit të KBDK [Sipas përkthimit] në nëntor 1999,
25 që është periudha -- që është pas periudhës së aktakuzës dhe

1 tërësisht jorelevante lidhur me faktin nëse një marrëveshje
2 për të formuar një NPK.

3 Lidhja e z. Selimi me persona të tjerë që nuk janë
4 personat që akuzohen si anëtarë të NKP-së, gjithashtu
5 paraqitet të jetë bazuar tërësisht në ndërveprime personale të
6 rastësishme dhe jo në prova të një marrëveshje të pretenduar
7 midis tyre. Për shembull, të gjithë të akuzuarit pretendohet
8 që kanë qëndruar në shtëpinë e Lahi Brahimajt. Kjo ka qenë në
9 Jabllanicë përpara periudhës së aktakuzës.

10 Pretendohet që z. Selimi të ketë pasur lidhje dhe me
11 Sabit Gecin sepse mesa duket ka dalë nga shtëpia e Sabit Gecit
12 kur ka shkuar për të dhënë një fjalim për paraqitjen e parë të
13 UÇK-së në nëntor 1997.

14 ZPS-ja pretendon që edhe z. Lushtaku është një shok i
15 vjetër i z. Selimi. E njëjta edhe për Remin, që po ashtu
16 pretendohej se ishte një njeri i afërt i Rexhep Selimit dhe
17 Adem -- që ka qenë me z. Selimi dhe Adem Jasharin para se të
18 ndodhte sulmi tragjik në familjen e Jasharëve.

19 Dëshpërimi i ZPS-së për të gjetur me doemos lidhje mes
20 këtyre personave, anëtarëve të NKP-së, në fakt, është
21 mbështetur vetëm në faktorin relevant. Të kalosh përpara
22 shtëpisë së z. Geci apo të z. Brahimaj, pa pasur një provë se
23 çfarë roli apo diskutimi mund të kenë pasur ata, është
24 pikërisht ajo që ne po diskutojmë që kjo nuk është provë.

25 Më konkretisht Prokuroria i referohet Fatmir Limajt që ka

1 jetuar me z. Selimi dhe thonë që ky është një element
2 kriminal, dhe mesa duket kjo është baza për marrëveshjen e të
3 krijuarit një plan kriminal, që është përsëritur nga
4 Prokuroria më duket se të hënën, gjatë kohës që bënë
5 parashtrimet e veta.

6 Sigurisht ka shumë akuza kundër z. Limaj ose pretendime
7 kundër z. Limaj në dosjen e Prokurorisë, por z. Limaj nuk
8 është një nga të akuzuarit këtu, nuk është në gjendje që t'u
9 përgjigjet këtyre pretendimeve. Por është e vështirë nëse
10 shohim fushëveprimin dhe natyrën e këtyre pretendimeve të mos
11 thuash që, në fakt, z. Selimi akuzohet thjesht se ka njohur z.
12 Limaj. Akuza që drejtohen për z. Limaj dhe që janë transferuar
13 për z. Selimi thjesht sepse z. Selimi ka pasur njohje
14 personale me z. Limaj. Kjo është shumë e papërshtatshme.

15 Tani sa i takon emrave të anëtarëve të pretenduar të NKP-
16 së, emra që përsëriten vazhdimisht në këtë çështje gjyqësore
17 të të gjithë NKP-së të cilët janë diskutuar. Një emër që
18 përmendet është Adem Jashari, i cili ka qenë shumë i përmendur
19 në këtë çështje gjyqësore. Është përmendur si një person që ka
20 marrë pjesë në luftimet e Prekazit në 1998-n, të marsit të
21 1998-s nga Prokuroria - e keni këtë në dosjen e Prokurorisë në
22 paragrafin 1033 - ku në fakt e anashkalojnë komplet masakrën
23 që i ka ndodhur kësaj familje. Përmenden dhe disa raste të
24 tjera sikur të jetë me z. Veselin dhe z. Thaçi në 1992 - këtë
25 Prokuroria e ka në paragrafin 788 - apo që është prezantuar me

1 z. Selimi nga Sylejman Selimi në 1994. Ky është paragrafi 98.
2 Dhe po ashtu është -- po ashtu rreth datës 4 mars 1998 është
3 takuar me z. Selimi, Sabit Gecin. Sylejman Selimin, Remin dhe
4 Rrahman Ramën për të diskutuar zgjerimin e UÇK-së edhe armët.

5 Përfundimi i logjikshëm që ka nxjerrë ZPS-ja nga këto
6 situata është që këto lidhje mes të akuzuarit dhe z. Jashari
7 janë relevante për augmente të ZPS-së sa i takon NKP-së. Unë
8 mendoj se këtë ZPS-ja e bën sepse sipas ZPS-së edhe z. Jashari
9 është një anëtar i pretenduar i NKP-së të cilit ata nuk i
10 përmendin emrin. Pra, nuk mund të diskutosh thelbin e NKP-së
11 siç pretendon Prokuroria dhe të pretendosh që çdo anëtar i
12 lartë në UÇK me doemos paska qenë pjesë e NKP-së, përshirë
13 këtu z. Jashari.

14 Megjithatë, unë mendoj që nëse e pyet Prokurorinë tani,
15 Prokuroria nuk do të jetë në gjendje të përgjigjet. Nëse e
16 pyesni a ka qenë z. Jashari pjesë e kësaj NKP-je që pretendon
17 kështu, Prokuroria duhet të jetë në gjendje ta vërtetojë këtë
18 gjë. Po unë shpresoj, të nderuar Gjykatës, që ju në një moment
19 t'i bëni këto pyetje të vështira dhe të mos e lejoni
20 Prokurorinë të sillet në këtë mënyrë.

21 Tani dua të flas lidhur me oponentë ose oponentët e
22 pretenduar, sikurse i paraqet Prokuroria në dosjen e vet.

23 Fillimisht sa i takon përkufizimit të "bashkëpunëtorëve".
24 Pikënisja në lidhje me bashkëpunëtorët duhet të jetë që
25 personat që perceptoheshin se ishin në një anë, të një pale

1 gjatë një konflikti, por në realitet ndihmonin palën tjetër
2 mund të jenë realisht shkak për t'u shqetësuar. Dhe dua të
3 theksoj, siç e ka pranuar dhe Prokuroria, ndalimet mund të
4 jenë të ligjshme dhe legjitime kur ka arsye të mjaftueshme për
5 të besuar se cenohet siguria. Dhe këtu mund ta lexoni gjykimin
6 që ka nxjerrë Paneli i Apelit në çështjen Shala, dhe kur ka
7 "shqetësime për shkak të njohurive, 'cilësive që ka ky person,
8 dhe ky person mund të jetë një kërcënim i vërtetë për sigurinë
9 aktuale dhe të ardhshme të vendit'".

10 Sigurisht ekzistojnë interpretime të ndryshme dhe të
11 konsiderueshme në lidhje me bashkëpunëtorët dhe ndryshe është
12 interpretuar mes dëshmitarëve dhe ZPS-së. Por duke qenë se nuk
13 kemi një përkufizim të vetëm, as ZPS-ja as Mbrojtja nuk
14 pajtohen me këtë pikë.

15 Pra, nuk ka pasur ndonjë përkufizim formal të
16 bashkëpunëtoreve nga Shtabi i Përgjithshëm sepse kjo do t'i
17 jepte mundësinë anëtarëve të NKP-së të shënjestronin më shumë
18 persona si bashkëpunëtorë, të paktën kështu e kuptoj unë
19 rastin e Prokurorisë.

20 Megjithatë, nuk ka prova që të akuzuarit të jenë
21 përpjekur që qëllimisht të mos i përkufizojnë bashkëpunëtorët
22 sepse preferonin të kishin një përkufizim më të gjerë, më të
23 vagullt. Nuk ka ndonjë shënim për ndonjë takim, asnjë
24 dëshmitar nuk e ka mbështetur asnjëherë këtë pretendim të
25 Prokurorisë që me demok UÇK-ja nuk ka dashur të ketë

1 përkufizim formal për bashkëpunëtorët.

2 Në fakt, nuk ka pasur asgjë me shkrim lidhur me
3 bashkëpunëtorët nga Shtabi i Përgjithshëm, por kjo nuk do të
4 thotë që është bërë qëllimisht prej tyre kjo gjë.

5 Sa i takon z. Selimi -- sipas provave mënyra se si e ka
6 kuptuar ai bashkëpunëtorët po ashtu është përkufizuar në
7 mënyrë shumë të ngushtë. Dua t'jua tregoj këto përmes dy
8 pretendimeve që ngre Prokuroria. Një, që përkufizuar në mënyrë
9 të ngushtë bashkëpunëtorët, dhe donte që kjo të ndiqej.

10 E para, një person që është ndaluar në Likoc në gusht
11 1998 është trajtuar hollësisht në dosjen sa i takon ndalimit
12 të këtij personi. Mbrojtja konteston identifikimin e z. Selimi
13 në këtë marrje të pretenduar në pyetje sipas Prokurorisë në
14 praninë e z. Selimi një person i ndaluar është pyetur për
15 bashkëpunimin e tij të mundshëm me zyrtarët serbë, dhe se
16 prova e tyre është që ky person që pretendohet se ka qenë z.
17 Selimi e ka këshilluar personin që po merrte në pyetje
18 personin tjetër që ta linte të ikte pasi i bëri pyetjet
19 përkatëse. Personi nuk ja mori parasysh kërkesën z. Selimi.
20 Pra, z. Selimi edhe pasi e dëgjoi se ky personi supozohet se
21 ishte bashkëpunëtor sidoqoftë personit që po e merrte në
22 pyetje [i tha] ta linte të lirë këtë person, sepse z. Selimi
23 nuk besonte se ky ishte një bashkëpunëtor. Pra, edhe vetë
24 Prokuroria thotë që z. Selimi s'e ka konsideruar
25 bashkëpunëtor, nuk ka dashur që të merrej asnjë masë kundër

1 tij.

2 Së dyti, lidhur me person në zonën e Llapit. Prokuroria
3 pretendon në paragrafin 587 të dosjes se Remi ka autorizuar
4 arrestimin e këtij personi, se pretendoi se ishte një
5 bashkëpunëtor i serbëve që ishte mbajtur më pas i ndaluar në
6 Bajgorë. Siç shton ZPS-ja, ky person që kishte lidhje me
7 Shtabin e Përgjithshëm përfundimisht u lirua nga vendi ku
8 mbahej i ndaluar pasi ndërhyri Shtabi i Përgjithshëm dhe mbeti
9 nën mbikëqyrjen e Remit.

10 Pra, prapë Mbrojtja e konteston këtë gjë. Z. Selimi nuk e
11 dinte nëse ishte ndaluar apo arrestuar vërtetë ky person nga
12 komanda e Llapit, ndonëse ky ishte një person ish-polic serb,
13 sidoqoftë z. Selimi donte që ky person thjesht të ishte një
14 person që të luftonte për UÇK-në. Pra, edhe në këtë rast
15 hidhen hije dyshimin lidhur me përkufizimin e bashkëpunëtorëve
16 që i atribuohet z. Selimi.

17 Nuk ka pasur ndonjë komunikim për bashkëpunëtorë të
18 pretenduar lidhur me -- që të lidhet me z. Selimi. Ka një
19 pretendim kundër z. Selimi në lidhje me Kleçkën në prill 1999
20 që do ta diskutoj më vonë, dhe Mbrojtja këtë e ka diskutuar
21 fuqimisht në dosjen e vet përfundimtare. Por dhe vetë
22 Prokuroria [tha], personi në fjalë nuk ka qenë bashkëpunëtor
23 por ka qenë vetë anëtar i UÇK-së që u ndalua për shkelje
24 disiplinore. Si pasojë, nuk mund të thuash që ka qenë
25 bashkëpunëtor siç pretendon Prokuroria. Prokuroria nuk ka

1 nxjerrë asnjë provë pra, që z. Selimi të ketë pasur një
2 interpretim më të gjerë të termit bashkëpunëtor apo të ketë
3 kërkuar që ky përkufizim të zbatohet nga të tjerë në UÇK.

4 Sa i takon kategorisë së dytë të oponentëve, Prokuroria
5 ka argumenta shumë të dobëta në lidhje me këtë, kontradiktore,
6 të paqarta, siç u duk shumë qartë në lidhje me LDK-në. Ne e
7 dimë që nuk ka ndonjë pikëpamje të vetme përfundimtare nga
8 LDK-ja lidhur me synimet dhe mjetet e UÇK-së. Vërtetë ka qenë
9 politika e tyre të mos kishte dhunë, LDK-ja në fakt, kishte
10 pikëpamje të ndryshme dhe siç është shpjeguar nga dëshmitarë
11 të ndryshëm të Prokurorisë shumë anëtarë të LDK-së në fakt, më
12 pas u bënë anëtarë të UÇK-së. Në fakt, të ishe anëtar i LDK-së
13 nuk të pengonte të ishte pjesë e UÇK-së.

14 Në kohën e periudhës së aktakuzës, në fakt, shumë anëtarë
15 të LDK-së besonin se ishte e nevojshme të merrnin armët në
16 mënyrë që edhe ata të arrinin synimet e tyre. Edhe anëtarë të
17 Qeverisë në Mërgim e kuptuan se ishte nevoja të kishin një
18 forcë të armatosur në mënyrë që të çlironin vendin. Pikërisht
19 për këtë janë mbajtur bisedimet në Oslo në maj 1998 dhe të
20 marrëveshjes që u nënshkrua në fund të vitit. Edhe një herë,
21 nuk ka pasur një pikëpamje të vetme të unifikuar kundër UÇK-
22 së.

23 Të flasim tani për zbatimin e planit të përbashkët, ose
24 zbatimin e pretenduar të planit të përbashkët sipas
25 Prokurorisë.

1 Ky plan i përbashkët është zbatuar kryesisht përmes
2 urdhrave dhe komunikatave. Edhe pretendohet se është realizuar
3 edhe përmes rregulloreve, por këtë e kemi trajtuar në dosjen
4 tonë. Mbrojtja e ka trajtuar me shumë hollësi faktin që z.
5 Selimi s'ka pasur asnjë rol në përgatitjen e këtyre
6 dokumenteve. Provat në vetvete nuk e mbështesin aspak
7 ekzistencën e një plani të përbashkët për të shënjestuar në
8 mënyrë të paligjshme oponentët.

9 Argumenti kryesor i Prokurorisë që gjendet në paragrafin
10 67 të dosjes, është që komunikatat kishin një qëllim të
11 dykahtë. Ishin si udhëzime që u shpërndareshin komandantëve të
12 zonave që të shënjestronin bashkëpunëtorët, por shërbenin dhe
13 si paralajmërim për proponentët e mundshëm dhe ata aktual.
14 Megjithatë, asnjë nga këto qëllime nuk mbështetet as me
15 logjikë dhe as me provat e Prokurorisë.

16 Sa i takon argumentit se ishin udhëzime, dhe kjo është e
17 trajtuar në dosjen 358 të Prokurorisë, sidomos për zonën e
18 Llapit ku pretendohet se "komanda e zonës së Llapit i ka
19 trajtuar komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm si udhëzime për
20 mënyrën si duhet të trajtoreshin bashkëpunëtorët dhe ata që
21 perceptoreshin se ishin persona që pengonin punimet e UÇK-së".

22 Dhe kjo buron tërësisht nga dëshmia e Dëshmitarit 04746
23 që ka dhënë një dëshmi për këtë argument që nuk është aspak
24 bindëse. Ai nuk ka thënë konkretisht cilat komunikata
25 specifike paskan qenë këto që ishin udhëzime kundër oponentëve

1 në mënyrë që të kemi mundësi t'i verifikojmë a ka qenë vërtetë
2 kështu. Ai iu referua Komunikatave 53 dhe 54 si baza e
3 mundshme. Komunikata 53 thotë që të merren masa ndëshkuese
4 kundër elementëve kolaboraciontë prej Shtabit të Përgjithshëm.
5 Komunikata 54 paraqet një fjali ku thuhet se "ata që kryejnë
6 luftë speciale do të trajtohen në përputhje me ligjet në
7 rrethana lufte".

8 Kjo zakonisht mund të thuhet për këdo që lexon
9 komunikatat që Shtabi i Përgjithshëm do të marrë masa në
10 përputhje me ligjet në kohë lufte sa i takon bashkëpunëtorëve.
11 Po kjo nuk mund të jetë autorizim qoftë i drejtpërdrejtë apo i
12 tërthortë që do të merren patjetër këto masa nga zonat apo
13 edhe nivele më të ulta. Ky dëshmitar as nuk dha ndonjë gjë,
14 ndonjë informacion specifik se çfarë masash do të merrte ky
15 person sipas këtyre komunikatave. Nuk na tha nëse sipas
16 komunikatave ai autorizonte të arrestonte apo të ndalonte
17 bashkëpunëtorët apo çfarë duhet të bënte në bazë të këtyre
18 komunikatave.

19 E përmendi edhe avokati i z. Thaçi. Në fakt, ishin bërë
20 ndalime në Bajgorë dhe Bare sipas Prokurorisë që prej 2
21 gushtit 1998, kohë më përpara se të lëshoheshin komunikatat
22 konkrete. Dhe kjo është konfirmuar, në fakt, me provën
23 materiale P167 që është në fakt një vendim për lirim të një
24 nga personave që është ndaluar në gusht dhe shtator në zonën e
25 Llapit, por në fakt aty nuk përmendet fare as ndonjë

1 komunikatë e Shtabit të Përgjithshëm.

2 Sa i takon logjikës, nëse teoria e ZPS-së është e saktë,
3 dhe komunikatat në fakt, kishin synim të udhëzonin personat në
4 nivel zone që të kryenin krime kundër oponentëve, atëherë pse
5 nuk i bënë komandantët e zonave këto gjëra dhe pse nuk i
6 raportuan Shtabit të Përgjithshëm? Pse u lëshua prova 1D29 për
7 të marrë masa kundër krimeve nëse këto krime kundër
8 kolaboracionistëve të pretenduar synoheshin nga Shtabi i
9 Përgjithshëm? Pse u përpoqën t'i fshinin komandantët e zonave
10 këto ndalime nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm?

11 Kjo mungesë logjike nga e Prokurorisë është befasuese.

12 Komandantët të tjerë zonash apo anëtarë të tjerë që kanë
13 dhënë dëshmi si dëshmitarë të ZPS-së po ashtu nuk e kanë
14 konfirmuar këtë teori apo interpretim të Dëshmitarit 4746.
15 Dëshmitari 4401, kur e pyetën për këtë na shpjegoi se ka qenë
16 thjesht interpretim personal i personit lidhur me këto
17 komunikatave pa specifikuar, pa evidentuar në një komunikatë
18 konkrete ku vërtetë thuhej, ja ky është një udhëzim.

19 Ka dhe një mospërputhje logjike themelore mes mbështetjes
20 në komunikatat e Shtabit të Përgjithshëm si bazë për udhëzime
21 për komandantët e zonave dhe urdhëresa konkrete që pretendohet
22 se ishin lëshuar prej Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nëse
23 komunikatat ishin kaq të qarta dhe përmbanin udhëzime për
24 komandantët e zonave të ndalonin bashkëpunëtore atëherë pse
25 duhet të nxirrte urdhra më pas Shtabi i Përgjithshëm? Pse u

1 lëshua urdhri konkret që ka marrë numrin P168 më 2 dhjetor?
2 Sepse komunikatat, në fakt, nuk ishin autorizime të këtij
3 lloji dhe nuk mund të thuash që komunikatat kishin pikërisht
4 këtë qëllim.

5 Sa i takon pjesës së dytë të argumenteve të Prokurorisë
6 lidhur me komunikatat, pra, që komunikatat flisnin për vdekjen
7 e bashkëpunëtorëve për të paralajmëruar të tjerët. Edhe një
8 herë, komunikatat nuk e mbështesin këtë interpretim. Kjo është
9 ngritur disa herë në dosjen e Prokurorisë, por e kanë
10 përmbledhur më shumë në dosjen përfundimtare në paragrafin 60
11 lidhur me komunikatën 28.

12 Tani, fillimisht komunikata 28 është e janarit 1997,
13 përpara se z. Selimi apo ndonjë prej të akuzuarve të ketë qenë
14 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm.

15 Por, nëse u jepeshin paralajmërimet bashkëpunëtorëve
16 përmes komunikatave, atëherë duhet të ishin dhe të besueshme
17 që personi që do t'i lexonte vërtetë do të besonte se masat që
18 përshkruheshin në to vërtetë ishin kryer, vërtetë ishin
19 realizuar. Megjithatë Prokuroria nuk ka dhënë ndonjë provë që
20 ka qenë vërtetë kështu.

21 Dhe më tej, Prokuroria nuk na dhënë ndonjë viktimitë në
22 aktakuzë, ndonjë person të përmendur në komunikatat e Shtabit
23 të Përgjithshëm si bashkëpunëtor, edhe që të jetë marrë masa
24 kundër këtij personi nga Shtabi i Përgjithshëm. Dhe kjo do të
25 thotë që emrat në komunikata kanë qenë kryesisht propagandë.

1 Tani, të hënën, ZPS-ja tha që nuk është e vërtetë që
2 komunikatat kanë qenë propagandë dhe na dha disa masa që ishin
3 marrë kundër bashkëpunëtorëve në paragrafët 147 dhe më tej në
4 dosjen e Prokurorisë. Është e vërtetë sepse i kanë përsëritur
5 emrat që kanë qenë në këto komunikata, por në fakt nuk
6 tregojnë që vërtetë kanë ndodhur ngjarjet. Nuk kanë asnjë
7 provë për të na treguar që kanë ndodhur ngjarjet siç
8 përshkruhen në komunikata.

9 Gjithashtu, nëse viktimat që renditen në aktakuzë, apo
10 ishin vërtetë grupi i oponentë që masat kundër tyre ishin si
11 paralajmërim për bashkëpunëtorët, atëherë këta persona do të
12 përmendeshin konkretisht në komunikata dhe do të thuhej që
13 ishin vrarë për shkak të bashkëpunimit të tyre. Vetëm në këtë
14 mënyrë mund të kishin funksionuar këto paralajmërimet.

15 Më falni, po vazhdoj më tej. Në fund, në lidhje me këtë
16 pikë, Mbrojtja thekson se komunikata 59 dhe dëshmia e
17 Dëshmitarit 04401 në lidhje me këtë temë duhet mbajtur
18 parasysht.

19 Pra, edhe një herë ne theksojmë se komunikatat nuk kanë
20 qenë thelbi i NKP-së si pretendon ZPS-ja.

21 Dëshmitari 4401 vërtet dha dëshmi dhe tha që komunikatat
22 shërbenin si paralajmërim, por që ishin kryesisht propagandë.
23 Dhe në të njëjtën linjë me provat për natyrën udhëzuesve të
24 pretenduar të komunikatave, edhe një herë po ju themi, që nuk
25 u dha asnjë komunikatë specifike, asnjë ndonjë bazë specifike

1 për të mbështetur pretendimin konkret.

2 Prokuroria në paragrafin 322 mbështetet në Komunikatën
3 59, për të mbështetur teorinë e tyre të përgjithshme sa i
4 takon qëllimit të bashkëpunëtoreve. Në veçanti, ZPS-ja
5 pretendon se një vit pasi u botua Komunikata 59, pasi kishte
6 përfunduar lufta dhe pas periudhës së aktakuzës, z. Selimi ka
7 vazhduar të çojë më tej narrativen se Gani Geci ka qenë
8 tradhtar dhe ka vrarë Rexhën në emër të FARK-ut, duke pasur
9 dijeni të plotë të falsitetit të këtij pretendimi, por dhe
10 duke e ditur rrezikun përbënte kjo për Gecin dhe për familjen
11 e tij.

12 Kjo është trajtuar veçanërisht në paragrafin 612, 615 të
13 dosjes së Prokurorisë. Gani Geci ka qenë drejtpërdrejtë
14 përgjegjës në Komunikatën 59 për vdekjen e komandantit të UÇK-
15 së Abedin Rexha. Komunikata nuk përmend masat që janë marrë
16 kundër z. Geci, as nuk jep udhëzime të tjerëve që ta bëjnë
17 këtë gjë.

18 Kur foli z. Selimi për këtë incident një vit më pas,
19 kishte informacione në dispozicion se z. Geci ka qenë
20 përgjegjës për vdekjen e z. Rexha. Z. Selimi në këtë artikull
21 pretendon se vrasja e Rexhës është përshkruar në Komunikatën
22 59. Komunikata qartazi përcakton se është vrarë -- dhe thotë
23 se është vrarë prej Gani Gecit dhe ka përsëritur thjesht
24 pretendimin se z. Geci ka vrarë z. Rexha.

25 Nuk është thënë asgjë në këtë intervistë që z. Geci ka

1 drejtuar forcat serbe sepse njihej si kolaboracionist, por z.
2 Selimi thjesht pyet në mënyrë retorike nëse vrasja ka qenë
3 politike dhe kërkon nevojën për të analizuar kush e vrau dhe
4 pse. Pra, nuk është problemi nëse e vrau Gani Geci Abedin
5 Rexhën apo nëse z. Selimi me të drejtë e ka akuzuar se e ka
6 bërë ai këtë gjë më 30 tetor 1999. Ajo që është e rëndësishme
7 është që kjo komunikatë përputhet me teorinë e ZPS-së që
8 komunikatat përdoren për shënjestruar oponentët. Po z. Geci
9 nuk shënjestrohej në këtë komunikatë se ishte anëtar i LDK-së,
10 por sepse besohej në mënyrë të arsyeshme se ai kishte vrarë
11 një komandant të UÇK-së dhe kjo është një temë tërësisht
12 tjetër që nuk është pjesë e planit të pretenduar të
13 përbashkët.

14 ZPS-ja po ashtu pretendon se Shtabi i Përgjithshëm ka
15 lëshuar urdhra dhe rregullore që ose kanë "ndihmuar ose kanë
16 pasur për synim zbatimin e qëllimit të përbashkët". Nëse
17 shikoni me vëmendje këtë dokument, do të shikoni se në fakt
18 këto urdhra synonin organizimin e ligjshëm të njësiteve të
19 pastruara dhe zbatimin e shtetit të së drejtës dhe nuk
20 kishin qëllim kriminal siç pretendon ZPS-ja.

21 ZPS-ja pretendon se Shtabi i Përgjithshëm lëshoi urdhra
22 për krimin e njësiteve të policive ushtarake dhe mbështetet në
23 disa versione të një urdhri në panënskruar të pretenduar se
24 është lëshuar në 2 korrik 1998 nga Shtabi i Përgjithshëm, që
25 policia ushtarake të ndalonte personat e dyshimtë. Mund ta

1 shikoni këtë në provën P03675. Këto dokumente nuk iu treguan
2 askujt. U kërkuan përmes një mocioni jogoroj. Asnjë dëshmitar
3 nuk komentoi, as nuk u vendosën në kontekst, thjesht nuk
4 përmenden as oponentë, as personat që supozohet se
5 shënjerstronte vetë --

6 Në urdhër pretendohet, në fakt, në urdhër thuhet që të
7 krijohen ambientet e ndalimit dhe të ndaloheshin
8 bashkëpunëtorë, por edhe një herë, nuk ka urdhër me shkrim nga
9 ZPS-ja, por janë mbështetur në një dëshmi të vagullt dhe të
10 pabazuar të një dëshmitari të ZPS-së, 04746 dhe dëshmia e tij
11 u mor parasysht.

12 Sidoqoftë edhe sikurse të ketë urdhra për krijimin e
13 ambienteve të ndalimit nga policia ushtarake, nuk do të thotë
14 që këto bëhen për të realizuar një qëllim kriminal. Njësitë e
15 policisë ushtarake ndërmorën disa masa për funksionimin e UÇK-
16 së ,por nuk kishte asgjë të bënte me ndalimin e personave të
17 dyshimtë.

18 Po ashtu, duke marrë parasysht faktin që ZPS-ja vetë ka
19 thënë që ndalimi në vetvete nuk është i paligjshëm, dhe
20 ligjshmëria e masave që merren kundër bashkëpunëtorë të
21 dyshuar, krijimi i ambienteve të ndalimit, nuk do të thotë
22 domosdoshmërisht që synohet realizimi i një qëllimi kriminal.
23 ZPS-ja është mbështetur në tri urdhra P00741.3, 168 dhe
24 1017_ET.

25 Është e paqartë nga çështja e ZPS-së në këto urdhra, në

1 fakt, kanë qenë për realizimin e qëllimit të përbashkët nga
2 Shtabi i Përgjithshëm apo Shtabi i Përgjithshëm ishte i
3 shqetësuar se po ndodhnin raste në nivele më të ulëta dhe po
4 merrte masa për të ndaluar këto vepra penale siç duket në
5 pamje të parë të këtij dokumenti. Pra, kjo pikërisht kjo
6 kontradiktë tregon se si ZPS-ja në fakt është inkohere në
7 argumentet e veta.

8 Një urdhër lëshuar nga Zyrapi më 28 nëntor 1998 ku thonte
9 që komandantët e zonave duhet "të rrisnin e numrin e
10 kontrollit" edhe që "të ndalohen sjelljet negative apo
11 veprimet negative nga popullata". Por këto përputhem pikërisht
12 me urdhëresat e Shtabit të Përgjithshëm që të merreshin masa
13 kundër veprimtarive të paligjshme.

14 Urdhri i dytë, për shembull, lidhet me një kërcënim
15 konkret që është bërë nga persona të armatosur që ishin në
16 Gjakovë. ZPS-ja pretendon se ata nuk ishin në -- anëtarë të
17 policisë vendore nuk ishin pjesë e forcave të armatosura
18 serbe, mund të shikoni paragrafin 297, ka në fakt prova që
19 këta persona ishin të armatosur edhe ishin pjesë e këtyre
20 forcave, siç e ka konfirmuar dëshmitari që është cituar nga
21 ZPS-ja. Këta nuk ishin thjesht disa policë të paarmatosur,
22 miqësorë, siç pretendon Prokuroria, por ishin individë të
23 armatosur mirë, të pajisur mirë që të luftonin kundër UÇK-së.

24 Dokumenti tjetër P01017, që është pranuar përmes
25 Dëshmitarit 04576, bazuar në një pretendim të tij për faktin

1 që ka parë një dokument dhe ka thënë që ishte një dokument i
2 ngjashëm me librin e tij dhe një -- dhe ishte një propozim që
3 dëshmitari, në fakt, e pranoi. Ju, të nderuar Gjykatës, e
4 pranuat këtë dokument dhe e pranuat sipas këtij argumenti,
5 është në transkript 12700:

6 "Trupi Gjykses do ta pranojë dokumentin, por në fakt ka
7 vlerë shumë të ulët provuese. Do të vendosim më vonë për
8 peshën që do t'i japim dhe është e mundshme, në fakt, që të
9 mos i japim shumë peshë dokumentit në fjalë".

10 ZPS-ja në asnjë moment nuk u përpoq që ta vendoste në
11 kontekst këtë dokument me asnjë dëshmitar, nuk ia tregoi as
12 Dëshmitarit 04752, dhe ne mendojmë që Trupi Gjykses nuk duhet
13 t'i japë asnjë peshë këtij dokumenti.

14 Të nderuar Gjykatës, unë mbarova gjysmën e fjalimit tim,
15 por mund t'ju them që argumentet e ZPS-së lidhur me NKP-në nuk
16 kanë logjikë, nuk janë në përputhje, janë të pabazuara.
17 Pavarësisht fjalëve që thotë Prokurori, që mbështeten në fajin
18 për shkak të njohjeve, përgjegjësisë penale, por këto janë
19 tërësisht spekuluese, të pabazuara nuk mund të mbështeten në
20 deklarata publike dhe në pretendime që, në fakt, nuk i
21 maskojnë dot pasaktësitë e tyre.

22 Pas pushimit do të vazhdoj me pjesmarrjen e pretenduar të
23 z. Selimi në NKP.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
25 çerek ore pushim deri në orën 3.45.

1 --- Seanca ndërpritet në orën 15.30.

2 --- Seanca rifillon në orën 15.45

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Roberts,
4 kur të jeni gati mund të vazhdoni.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.
6 Shpresoj që deri në fund të ditës të mund të përfundoj me
7 prezantimin. Mbase do t'ju kërkoj pesë ose dhjetë minuta
8 shtesë në qoftë se jam pranë përfundimit të prezantimit,
9 megjithatë do ju them kur të vijë momenti i përshtatshëm.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Okej. Në
11 rregull. Na thoni.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Sikurse e thashë dhe më përpara
13 tani do të kaloj tek pjesa e kontributit të pretenduar të z.
14 Selimi në NKP.

15 Sikurse përcaktohet qartë në paragrafin 110 të Vendimit
16 të Konfirmimit:

17 "Ligjërisht nuk është i nevojshëm që kontributi i kryesit
18 të NKP-së të jetë i domosdoshëm ose i konsiderueshëm, por
19 duhet të jetë të paktën kontribut i qenësishëm në krimet për
20 të cilat personi konstatohet se është përgjegjës."

21 Kjo është pranuar shprehimisht nga ZPS-ja gjatë
22 konferencës përgatitore të ZPS-së më 15 shkurt 2023, në
23 transkript në faqen 1964 dhe pasqyron konstatimet në vendimin
24 sipas rregullit 98 bis kundër Mladic data 15 prill 2014 dhe në
25 aktgjykimin e Shalës dhe aktgjykimin e Krajisnik.

1 Kjo nuk është vetëm thjesht fasadë ose nuk është një
2 kokëçarje që mund të anashkalohet, por është një kërkesë shumë
3 e rëndësishme për sa i takon përgjegjësisë penale për NKP. Dhe
4 asnjë prej këtyre kontributeve të supozuar nga z. Selimi në
5 NKP nuk e kalojnë këtë standard strikt.

6 Asnjë prej këtyre kontributeve të pretenduara nga ZPS-ja
7 nuk qëndrojnë. Për shembull, ZPS-ja pretendon se z. Selimi
8 është përfshirë në organizimin e transportit të armëve, në
9 paragrafin 187, në caktimin e kufijve të zonave, në paragrafët
10 213 e 370, në përforcimin e njësive ekzistuese, paragrafi 390,
11 ose në autorizimin e shpërndarjes së fondeve dhe kjo jepet në
12 paragrafin 206.

13 Prokuroria nuk ka bërë asgjë, as me gojë dhe as me
14 shkrim, për të demonstruar se si këto kontribute kanë dhënë
15 kontributin e tyre për kryerjen e krimeve të ngritura në
16 aktakuzë. Asnjë prej këtyre shembujve janë kriminalë ose as
17 tangentialisht nuk janë drejtuar drejt krimeve. Nuk është asgjë
18 tjetër veç se një funksionim i përgjithshëm i një ushtrie që
19 po lindte.

20 Për të dhënë përgjegjësi për veprime të tilla duhet që të
21 bëhet dallimi ndërmjet sjelljes së fajshme dhe sjelljes së
22 pafajshme. Kontribute të ngjashme janë bërë nga dhjetëra,
23 qindra, madje edhe nga mijëra anëtarë të UÇK-së. A mos vallë
24 po thotë ZPS-ja që ata të gjithë kanë dhënë kontribut
25 domethënës për NKP?

1 Argumentet e ZPS-së sa i takon z. Selimi dhe kontributit
2 të tij të pretenduar jepen në paragrafët 525 deri në 543 të
3 dosjes përfundimtare të ZPS-së, do të mundohem që secilin prej
4 këtyre pretendimeve t'i cek njëra pas tjetrës në mënyrë të
5 tillë që Gjyqtarë të nderuar ju të bindeni që nuk ka
6 ekzekutuar asnjë përgjegjësi e tillë.

7 Së pari, do të kalojmë në paragrafët 528 deri në 532 që
8 kishin të bënin me formulimin, zbatimin e planeve, politikave,
9 rregullave, strukturave dhe raportimin. Në këto paragrafë ZPS-
10 ja duket sikur bazohet kryesisht tek pozicioni i pretenduar i
11 autoritetit ose kompetencës së z. Selimi dhe që ky autoritet
12 apo kompetencë ka kontribuar për kryerjen e krimeve. Ne themi
13 që kjo është shprehimisht e pamjaftueshme. Sepse sikurse
14 njihet nga ICC-ja në çështjen Mbarushimana, pavarësisht që
15 zbatohet përgjegjësia sipas nenit 25(3)(d) e statutit, aty
16 thuhet që:

17 "Provat e parashtruara nga Prokuroria janë të
18 pamjaftueshme për të mbështetur konstatimet deri në pragun e
19 arsyeve themelore për të besuar që roli i të dyshuarit si
20 anëtar i grupit kriminal cilësohet se ai ka dhënë një
21 kontribut domethënës për sa i takon krimeve të kryera."

22 E di që ZPS-ja u përpoq që të mos krijonte një lidhje
23 midis këtij aktgjykimi të Gjykatës Ndërkombëtare Penale dhe
24 çështjes në fjalë. Megjithatë ne parashtrojmë se një pozicion
25 ose autoriteti i caktuar nuk çon në kontribut domethënës për

1 krimet. Ndërkohë që ZPS-ja nuk ka bërë asgjë që të thotë të
2 kundërtën.

3 Po ashtu, ZPS-ja pretendon që autoriteti i Selimit si
4 inspektor i përgjithshëm janë tërësisht jo bindëse. Megjithëse
5 Mbrojtja i ka dedikuar një pjesë domethënëse të dosjes së vet,
6 kam përshtypjen që 100 e ca paragrafë, ose për të qenë më i
7 saktë nga paragrafi 349 deri në paragrafin 451, dëshiroj që
8 t'i marrë njëra pas tjetrës disa prej pretendimeve të ZPS-së.

9 Së pari, ZPS-ja pretendon që të paktën deri në korrik të
10 1998-s Selimi ka qenë emëruar si inspektor i përgjithshëm,
11 megjithatë Prokuroria nuk thotë asnjë gjë sa i takon bazës ku
12 e mbështet këtë pretendim të vetin. ZPS-ja nuk identifikon
13 asnjë dokument ose asnjë dëshmi dëshmitari që heq paqartësitë.
14 Dhe duke pasur parasysh mungesën e dokumenteve lidhur me
15 emërimin e z. Selimi në këtë pozicion apo dëshmitarëve lidhur
16 me emërimin e z. Selimi, mendoj, që Trupi Gjykses nuk mund të
17 bindet përtej dyshimit të arsyeshëm sa i takon kohës kur është
18 bërë emërimi.

19 Së dyti, sa i takon autoritetit, ZPS-ja parashtron në
20 dosjen e vet që cilësinë e tij si inspektor i përgjithshëm, z.
21 Selimi ishte në "të njëjtin nivel" si komandant i
22 përgjithshëm, i raportonte atij drejtpërdrejt dhe në mungesë
23 të tij i raportonte zëvendëskomandantit. Këtë Prokuroria e
24 thotë në paragrafin 106 të dosjes së vet.

25 Si me pjesën tjetër të argumenteve të ZPS-së, ky

1 pretendim është hamendësues dhe nuk e bën të qartë se çfarë do
2 të thotë ose ku do të dalë ZPS-ja. A po thotë ZPS-ja që z.
3 Selimi ishte në të njëjtin nivel si komandant i përgjithshëm
4 dhe ishte si një lloj komandanti alternativ i UÇK-së? Kështu
5 duhet ta kuptojmë në qëndrimin e ZPS-së lidhur me këtë pikë?

6 Në fakt kështu duket sikur është rasti, sepse në
7 paragrafin 529 ZPS-ja thotë që:

8 "Si inspektor i përgjithshëm, Selimi ishte mbi drejtorinë
9 në nivelin e komandantit të përgjithshëm."

10 Megjithatë në asnjë vend në argumentet e veta ZPS-ja nuk
11 e ka pretenduar, e aq më pak ta ketë provuar, që inspektori i
12 përgjithshëm të ishte në atë nivel dhe të kishte atë
13 autoritet. Kjo nuk gjendet në dosjen paraprake të ZPS-së, pasi
14 aty ZPS-ja thjesht thotë që inspektori i përgjithshëm i
15 raportonte komandantit të përgjithshëm dhe nuk pretendon që ai
16 ishte në të njëjtin nivel si komandanti i përgjithshëm. Dhe
17 sigurisht që kjo është ndryshe nga ajo çfarë ka dhënë në
18 intervistë Dëshmitari W04752 dhe z. Thaçi dhe çfarë ZPS-ja
19 mendon që është organigrama e UÇK-së.

20 Megjithatë, gjatë këtij gjykimi asnjë dëshmitar nuk ka
21 dhënë prova lidhur me këtë pikë dhe dëshmia e paqartë e z.
22 Thaçi gjatë intervistimit të ZPS-së, në të cilën është
23 mbështetur kryesisht ZPS-ja, nuk mund të quhet e mbështetshme
24 ose e bazueshme sepse z. Selimi nuk pati mundësi që t'i bënte
25 pyetje z. Thaçi dhe kjo gjë nuk është konstatuar as nga

1 dëshmitarë të tjerë 4401, për shembull, ose 4752, 4290 dhe
2 askush nuk ka thënë që inspektori i përgjithshëm ishte mbi
3 drejtorinë.

4 Ndërkohë, për shembull, Dëshmitari W04752 pyetur lidhur
5 me këtë pyetje ka thënë si më poshtë:

6 "... inspektori nuk ishte në të njëjtin nivel, nuk ishte
7 i barabartë me të tjerët, me drejtorinë. Nuk ishte. Por ai
8 ishte në nivel të komandantit të përgjithshëm. Çfarë do të
9 thotë që ai merrte udhëzime nga komandanti i përgjithshëm sa i
10 takon inspektimeve dhe detyrave të tjera që duhet të
11 përmbushte."

12 Pra, dëshmia e këtij dëshmitari nuk është ajo që
13 interpreton ZPS-ja. Që "inspektori i përgjithshëm nuk ishte në
14 nivel të komandantit të përgjithshëm" atë çfarë nënkuptonte
15 dëshmitari duke bërë këtë formulim ishte që z. Selimi thjesht
16 merrte udhëzime prej komandantit të përgjithshëm.

17 Ndërkohë pjesa tjetër e dëshmisë së Dëshmitarit W04752,
18 si dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe prova të tjera
19 materiale, konfirmojnë që inspektori i përgjithshëm nuk ishte
20 mbi drejtorinë, por në të kundër, kishte rol dhe autoritet
21 shumë më të pakët sesa drejtorinë. Për shembull, roli i
22 inspektorit të përgjithshëm ishte i ri dhe i paqartë si për të
23 ashtu për persona me të cilët ndërvepronte ai, jepen në
24 paragrafët 363, 371 të dosjes tonë. Inspektori i përgjithshëm
25 nuk kishte staf, nuk kishte vartës edhe raportim. Inspektori i

1 përgjithshëm nuk kishte autoritet mbi njësi konkrete, kjo
2 jepet në paragrafët 421 deri në 429. Ai as nuk ftohej në
3 takimet e Shtabit të Përgjithshëm ku ftoheshin vetëm drejtorët
4 e drejtorive, kjo përcaktohet më në detaje në paragrafin 380.

5 Edhe lidhur udhëzimet që merrte nga komandantët e
6 përgjithshëm, komandanti i UÇK-së Azem Syla, sipas Dëshmitarit
7 W04752 konfirmoi që Syla ka qenë jashtë Kosovës në periudhën
8 në nëntor 1998 dhe prill 1999, dhe për rrjedhojë ishte e
9 vështirë që Selimi t'i raportonte Sylës dhe të komunikonte me
10 të. Kjo jepet në transkript të çështjes gjyqësore. Dhe jo
11 vetëm kaq por gjithashtu Dëshmitari W04752 tha që nuk ka parë
12 asnjë raport të shkëmbyer ndërmjet Sylës dhe Selimit.

13 Dhe, në fakt, është e qartë që inspektori i përgjithshëm
14 nuk ka qenë mbi drejtoritë, gjë e cila ilustruhet edhe nga
15 versionet e ndryshme të rregulloreve disiplinore ku nuk
16 përmendet fare çfarë pozicioni ose çfarë posti, çfarë
17 përgjegjësish kishte inspektori i përgjithshëm.

18 Për shembull, në provën P715 e bën të qartë që inspektori
19 i përgjithshëm nuk kishte kompetencë mbi çështje disiplinore.
20 Kjo konfirmohet nga Dëshmitari W07769 dhe W04752. Ndërkohë që
21 dëshmia e Dëshmitarit W04739 dhe paqartësitë e tij lidhur me
22 këtë pikë si dhe spekulimet lidhur me autoritetin disiplinor
23 të z. Selimi nuk janë të rëndësishme, po ashtu në qoftë se do
24 i referohemi rregulloreve, rregulloret, për shembull, në një
25 prej tyre thuhet që drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm i

1 udhëzojnë dhe i drejtojnë zëvendësit. Po ashtu përcaktohen dhe
2 detyrat për inspektim të Shtabit të Përgjithshëm, ekipe
3 monitorimi, lëshimi i paralajmërimeve, lëshojnë urdhra dhe
4 vendosin gjithashtu edhe kufizime disiplinore.

5 Kështu që ZPS-ja në mirëbesim nga njëra anë të mbështetet
6 në këtë dokument dhe nga ana tjetër të mos marrë parasysht
7 pasojën e paevitueshme që inspektori i përgjithshëm nuk kishte
8 autoritet formal për të ndërmarrë këto masa dhe kjo, në fakt,
9 e rrëzon tërësisht qëndrimin e ZPS-së të hënën këtu përpara
10 jush, të nderuar Gjykatës, që Selimi në pozicionin e tij si
11 inspektor i përgjithshëm kishte funksion operativ, mbikëqyrës
12 dhe disiplinor. Në një dokument ku pretendohet që të
13 renditeshin përgjegjësitë e tij, që u përmend nga Prokuroria,
14 që është prova 3D27, as nuk i referohet fare aktiviteteve të
15 tilla disiplinore.

16 ZPS-ja nuk i është referuar asnjë dokumenti formal,
17 zyrtar të UÇK-së, asnjë urdhri ose asnjë rregulloreje që
18 mbështet pretendimin e tij të boshtë sa i takon autoritetit të
19 z. Selimi.

20 Përkundrazi, ZPS-ja duket sikur mbështetet tërësisht në
21 provën P03749, që është një vizatim pa datë i bërë me dorë që
22 synon ose pretendon që të pasqyrojë strukturën e Shtabit të
23 Përgjithshëm.

24 Ky vizatim me dorë nuk është zyrtar. Nuk ka datë, nuk
25 dihet kush e ka bërë, për çfarë qëllimi dhe fakti që ai është

1 gjendur në shtëpinë e z. Selimi nuk e sqaron më tej këtë
2 çështje. Dhe parashtrimi si prova jo gojore pa asnjë lloj
3 kontekstualizimi nuk i jep asnjë lloj vlere dhe asnjë peshe
4 këtij dokumenti.

5 Sa i takon vetë dokumentit, ZPS-ja nuk ka dhënë asnjë
6 provë sa i takon strukturës së inspektoratit dhe nuk thotë që
7 ky inspektorat përbëhej prej inspektorë, zëvendësinspektorë
8 ose varës të tillë. Në fakt, e kundërta ka rezultuar e vërtetë
9 përmes pyetjeve të dëshmitarëve të Prokurorisë. Pra, as nuk ka
10 asnjë lloj strukture për inspektoratin dhe përveç dokumenteve,
11 të cilat ndoshta janë prodhuar prej personave të ndryshëm dhe
12 që janë të pambështetshëm për shkak të mungesës së detajeve të
13 nevojshme.

14 Edhe përmbajtja e vetë dokumentit nuk e mbështet
15 pretendimin që inspektori i përgjithshëm është në të njëjtin
16 nivel si komandanti i UÇK-së. Në rastin më të mirë, e vendos
17 inspektoratin si vartës së zëvendëskomandantit, dhe disa si
18 paralel me gjykatën ushtarake. E vendos z. Selimi si asgjë
19 tjetër përveç një ndihmuesi ose asistenti për komandantin dhe
20 nuk i jep atij asnjë lloj kontrolli thelbësor.

21 Më tej, në dosjen e vet ZPS-ja thotë që inspektori i
22 përgjithshëm ishte në nivel të lartë dhe ishte në nivel më të
23 lartë sesa shefi i drejtorisë së operacioneve. Dhe përveç
24 provës së 04752, që e kemi trajtuar më sipër, ky pretendim
25 thuhet ose pretendoj që të jetë mbështetur në deklarata të

1 mëparshme të z. Selimi ku ai konfirmon që ka mbajtur rolin e
2 shefit të drejtorisë operative. Megjithatë asgjëkund nuk mund
3 të gjejmë një shpjegim sesi ka mbërritur Prokuroria në
4 përfundimin që inspektori i përgjithshëm ishte në nivel të
5 shefit të drejtorisë operative.

6 Këto pretendime të ZPS-së nuk janë të mbështetura, por
7 janë të mbështetura në dëshpërimin e pafund të ZPS-së dhe
8 përpjekjet e ZPS-së për të arsyetuar çështjen e vet. Por nuk
9 bëjnë asgjë tjetër përveçse nxjerrin në pah paaftësinë e saj
10 lidhur me këtë pikë.

11 Të kalojmë, së dyti, në paragrafët përkatës që janë
12 paragrafët 533 dhe 534, pjesëmarrja në krime ose lehtësimi ose
13 pjesëmarrja e krimeve për të çuar më përpara ose për të
14 avancuar qëllimin e përbashkët.

15 Në dosjen përfundimtare të ZPS-së dhe në parashtrimet e
16 veta, ZPS-ja në mënyrë sipërfaqësore trajton pretendimet
17 individuale ose pretendimet kundër z. Selimi. Ndërkohë, që nga
18 ana tjetër, ne si Mbrojtje i kemi trajtuar këto pretendime në
19 hollësi dhe për më tepër hollësi mund gjeni shpjegimet tona në
20 pjesën V.D.1-8,. Megjithatë, pavarësisht që secila prej këtyre
21 pikave është shtjelluar në hollësi, do të doja që t'i kaloja
22 këto pika shpejt e shpejt për ju tani.

23 Së pari, sa i takon pretendimeve që lidhen me z. Selimi
24 që ka ndaluar një burrë në një fshat në qershor të 1998-s dhe
25 që pretendoi që e ka frikësuar aty, ka relevancë shumë të

1 kufizuar dhe vlerë joprovuese të këtij pohimi. Dhe kjo është e
2 qartë në dosjen e ZPS-së, përkatësisht në paragrafët 81 dhe
3 663, ku nuk jepen pretendime të drejtpërdrejta ose prova të
4 drejtpërdrejta kundër z. Selimi ose nuk thuhet se çfarë i ka
5 thënë, për shembull, z. Selimi këtij personi për ta frikësuar.

6 Këtë akuzë e kemi trajtuar në paragrafët 653 deri në 679
7 të dosjes sonë. Pra, çdo gjë lidhur me këtë pikë mbështetet në
8 dëshminë e një dëshmitari ku ka prodhuar, ku ka fabrikuar, që
9 ka fabrikuar prova kundër z. Selimi dhe të dhënat e tij nuk
10 përbëjnë asgjë tjetër përveçse fjalë që ka dëgjuar sipas tij
11 nga një person që ka vdekur dhe që nuk e ka thënë se kush
12 ishte ky person. Atëherë shpjegimi që jep ai është tërësisht i
13 pabesueshëm dhe përshkrimi i z. Selimi dhe rrethanave
14 përkatëse ngrenë shqetësime të shumta për sa i takon
15 pambështetshmërisë dhe identifikimin e pasigurt të z. Selimi.

16 Së dyti, sa i takon pretendimeve të përcaktuara në
17 paragrafin 41 të aktakuzës që kanë të bëjnë me krimet e
18 pretenduara kundër dy oponentëve në Drenoc në qershor të 1998-
19 s. Sikurse kemi përcaktuar në paragrafët 680 deri në 682 në
20 dosjen tonë, pretendimet për praninë e z. Selimi në këtë rast
21 nuk është pretendimi i pjesëmarrjes sepse kjo në fakt është
22 përcaktuar dhe është pranuar në parashtrimin F3607 në
23 paragrafin 38. Përpjekja e vonuar e Prokurorisë për ta
24 përfshirë z. Selimi si një pjesëmarrës aktiv në këtë ngjarje
25 dhe këtu më konkretisht i referohem paragrafëve 82, 534, 767

1 deri në 768 të dosjes përfundimtare të ZPS-së është i pabazuar
2 dhe në aspektin procedural është i papranueshëm. Kështu është
3 edhe pretendimi i ZPS-së që deklarata që Selimi i ka dhënë
4 ZPS-së e ka implikuar atë, dhe për pasojë është kundër
5 interesit të vet. Sa i takon parashtrimin të vagullt dhe pa
6 referencë të ZPS-së që ky argument "është jologjik dhe i
7 pabazuar", më konkretisht e kam fjalën për transkriptin për
8 faqen 28451 deri në 28452, është një shpjegim tërësisht i
9 pambështetur dhe tërësisht i pakuptimtë. Asnjë prej dëshmive
10 të dhëna lidhur me këtë incident nuk janë të besueshme nuk
11 kemi mbështetshmëri dhe bazueshmëri të provave të prodhuara
12 lidhur me këtë pikë.

13 Së treti, sa i takon pretendimit për praninë e z. Selimi
14 në afërsi në pasojat e luftimeve në Rahovec në korrik të 1998-
15 s, serish të mbuluara në paragrafët 782, 816 të dosjes së
16 Mbrojtjes, të gjitha provat konfirmojnë që nuk ishte sulm mbi
17 Rahovecin të filluara nga Shtabi i Përgjithshëm, por të
18 filluara nga njësitë lokale. Z. Selimi nuk ka qenë i pranishëm
19 kur kanë filluar luftimet, por ka mbërritur më vonë së bashku
20 me 4752, me të cilin ka qenë në front të parë përballë
21 kundërsulmit, pra, kundër ushtrisë jugosllave. Përfshirja e z.
22 Selimi në veprime mbrojtëse nuk kanë të bëjnë me asnjë person
23 që ishte i ndaluar nga njësitë lokale në kontekstin e këtyre
24 luftimeve. As provat shkresore të disponueshme, dhe më
25 konkretisht e kam fjalën për provën P01329, P00067 dhe as

1 dëshmi të tjera të dëshmitarëve nuk tregojnë për asnjë lloj
2 roli të mundshëm të z. Selimi në këtë incident.

3 Sa i takon akuzave kundër z. Selimi që ka qenë i
4 pranishëm gjatë marrjes në pyetje të një oponenti në Likoc në
5 gusht të 1998-s, këto janë trajtuar gjerësisht në paragrafët
6 743 deri në 766 të dosjes përfundimtare të Mbrojtjes. Këtë
7 pikë e ceka dhe më lartë. Ato mbështeten tërësisht në provat
8 të pabesueshme të një dëshmitari, të cilin e kemi parë për
9 herë të parë përpara këtij Trupi Gjykes që implikon z. Selimi
10 edhe në rrahjen e tij, një pretendim që s'e kishte bërë
11 asnjëherë më përpara pavarësisht mundësive të pafund që kishte
12 pasur për këtë gjë. Kompensimi financiar që dëshmitari i ka
13 pranuar ZPS-së që ishte i interesuar duket sikur të ketë
14 mjaftuar që ky dëshmitar t'i gënjente sy për sy Trupit
15 Gjykes. Ndërkohë që ZPS-ja, me të drejtë, nuk është
16 mbështetur në pjesë të caktuara tërësisht të reja dhe të
17 fabrikuar të dëshmisë së tij, nuk ka qenë në gjendje që të
18 rrëzojë të tërë dëshminë e këtij dëshmitari, ndërkohë që ne
19 themi që dëshmia ose duhet të merret si e besueshme ose si e
20 pabesueshme e tëra. Ndërkohë që kjo dëshmi nuk mjafton për të
21 vërtetuar praninë e z. Selimi në këtë incident. Nuk kemi asnjë
22 informacion që ka marrë ZPS-ja sa i takon lirimit të tij apo
23 sa i takon rrahjes së tij ose karakteristika të tjera të cilat
24 lidhen me personin që ai ka identifikuar si z. Selimi dhe që e
25 ka rrahur atë.

1 Sa i takon frikësimit të pretenduar të njësive të lidhura
2 me LDK-në në zonën e Dukagjinit në fillim të shtatorit të
3 1998-Selimi, sikurse pretendohet në paragrafin 45 të
4 aktakuzës, Mbrojtja në fakt i ka trajtuar gjëra e gjatë këto
5 pretendime në paragrafët 817 dhe 881 të dosjes së saj.

6 Veprimet e z. Selimi ishin të kufizuara por ishin të
7 justifikuara duke marrë parasysh kontekstin në atë kohë.

8 Megjithatë dëshiroj që të rikujtoj insinuimin e mëtejshëm
9 të ZPS-së të përfshirjes së Selimit në një komplot të
10 pretenduar për të vrarë persona të caktuar, të përsëritur
11 përsëri në paragrafët 339 të dosjes së ZPS-së. Bëhet fjalë për
12 një pretendim mbështetur në dëshminë e Dëshmitarit W04448, dhe
13 kjo në vetvete nuk bën gjë tjetër vetëm se e përforcon më
14 tepër mungesën e besueshmërisë së dëshmitarëve ku mbështetet
15 ZPS-ja. Për shembull, 4448 ka një historik të gjatë sa i takon
16 dhënies së përgjigjeve të pyetjeve sipas dëshirës së tij dhe
17 interesave të veta e manipuluar ZPS-në, pra, bëhet fjalë për
18 një dëshmitar për të cilin Prokuroria e ka udhëzuar që t'i
19 shkruante autoriteteve të migracionit të Shteteve të Bashkuara
20 duke i thënë atij se sa i rëndësishëm ishte. Pra, të nderuar
21 Gjykatës mendoj që është e mjaftueshme vetëm ajo çfarë ka
22 thënë një dëshmitar tjetër lidhur me të që ka besim zero sa i
23 takon vërtetësisë së provave të fabrikuara dhe Dëshmitarit
24 W04448.

25 Së gjashti. Sa i takon pretendimit në paragrafin 46 të

1 aktakuzës lidhur me pjesëmarrjen e pretenduar të z. Selimi në
2 arrestimin, ndalimin dhe kërcënimin e anëtarëve të
3 delegacionit parlamentar në Qirez. Ne jemi plotësisht dakord
4 me parashtrimet e Prokurorisë që Trupi Gjykses duhet të marrë
5 parasysh të gjitha provat në tërësinë e vet kur të bëjë
6 vlerësimin e akuzave, por ta bëjë këtë gjë Trupi Gjykses duhet
7 të marrë parasysh kundërthëniet ndërmjet dëshmime të
8 dëshmitarëve lidhur me këtë çështje për të cilën ZPS-ja nuk ka
9 bërë asgjë për t'i linjësuar ose për t'i sqaruar. Për
10 shembull, ne këtë e kemi ngritur dhe më përpara e kemi ngritur
11 gjithashtu dhe në dosjen tonë në paragrafët 882 dhe 922.

12 Çfarë ia vlen të theksohet, gjithashtu, është që në
13 dosjen përfundimtare të vet ZPS-ja, pra, ka ndryshuar pak
14 qëndrimin e saj ose akuzat e saj fillestare sa i takon
15 përfshirjes së z. Selimi lidhur me këtë incident konkret. Pra,
16 kishte katër pretendime në fillim fare kundër z. Selimi lidhur
17 me këtë incident, ndërkohë që aktualisht kemi vetëm një
18 pretendim dhe ai është komplet i pabazuar.

19 Së shtati, sa i takon arrestimit, ndalimit edhe ndjekjes
20 kundër Blerim Kuqit, sipas ZPS-së që është parashtruar në
21 paragrafët 502 dhe 503 të dosjes së Prokurorisë, nuk ka asnjë
22 pretendim të drejtpërdrejtë ose prova që vërtetojnë
23 përfshirjen e z. Selimi në këto veprime. Sikur është shpjeguar
24 në hollësi në paragrafët 1009 deri në 1049 në dosjes së
25 Mbrojtjes, provat për këtë incident janë të kufizuara, janë të

1 vagullta, të paqarta dhe nuk jepet asnjë sugjerim që z. Selimi
2 ka qenë i përfshirë në vendimmarrje ose zbatimin e veprimeve
3 të përfshira në këtë rast. Në çdo rast, pra, në themi viktimat
4 e pretenduara në këtë akuzë nuk janë oponentë në përkufizimin
5 e ZPS-së të oponentit siç parashtrohet në paragrafin 32 të
6 aktakuzës.

7 E njëjta gjë është e vërtetë edhe në pretendimin e tetë
8 për përfshirjen individuale ose përfshirjen e z. Selimi
9 konkretisht në krime në lidhje me atë çfarë parashikohet në
10 paragrafin 49 të aktakuzës në lidhje me incidentin e prillit
11 të 1999 në Kleçkë. Kjo është përsëritur disa herë nga ZPS-ja
12 dhe nga Mbrojtësi i Viktimave.

13 Që në fillim, sikur akuzat e tjera në aktakuzë, dua të
14 them që z. Selimi nuk është akuzuar se ka kryer fizikisht
15 ndonjë krim lidhur me këtë incident. Kjo është diçka që jemi
16 informuar vetëm në fund.

17 Në çdo rast, identifikimi i pakonfirmuar dhe i shpikur i
18 z. Selimi, së bashku me të gjithë shpikjen e historisë si
19 dëshmitari pretendon se është takuar me të në mënyrë të tillë
20 që është në gjendje që ta identifikonte atë më pas, është
21 tërësisht e pambështetshme. ZPS-ja nuk ka bërë asnjë, as me
22 shkrim as me gojë, për të përjashtuar ndonjë prej kritikave
23 legjitime për sa i takon këtij identifikimi dhe nuk ka bërë
24 asgjë tjetër veçse ka rithënë dhe një herë kundërshtimin e vet
25 pa dhënë asnjë lloj shpjegimi sikur shpjegimet të mos ishin

1 fare të rëndësishme.

2 Të nderuar Gjykatës, besoj se ju kujtohet përshkrimi
3 fantastik i dëshmitarit të z. Selimi sikur z. Selimi të kishte
4 ardhur nga hëna me një kalë të bardhë disa javë përpara sesa
5 ai të bënte identifikimin e synuar të z. Selimi në Kleçkë.

6 Megjithatë, më duhet të them që kishte shumë probleme për
7 sa i takon identifikimit dhe Prokuroria nuk ka marrë parasysh
8 asnjë prej kundërshtimeve tona sa i takon mënyrës sesi ai ka
9 bërë identifikimin e z. Selimi, këtë nuk e ka bërë, pra,
10 identifikimin dhe detaje të tjera nuk i ka dhënë as me shkrim
11 dhe as me gojë. Ne parashtrojmë që ky identifikim është
12 absolutisht i rëndësishëm.

13 Së nënti. Sa i takon Ymer Xhafiqit, ne dje dëgjua ZPS-në
14 që u mbështet në dëshminë e Dëshmitarit W03724 që ishte
15 informuar nga një person që lidhej me Rexhep Selimin sa i
16 takon nofkës së tij si "Dhjetëshi" dhe se Xhafiqi ishte nën
17 kontrollin e një "formacioni më të lartë". Dhe e kam fjalën
18 këtu më konkretisht për parashtrimet e Prokurorisë të hënën në
19 faqen 28415 në datën 9 shkurt.

20 Megjithatë, atë çfarë ZPS-ja nuk e bëri të qartë ishte që
21 këtë nuk e kishte nga vetja, nuk ishte informacion që e kishte
22 të dorës së parë por ishte një informacion që ia kishte dhënë
23 një kolegu i vet, i cili nuk u shtjellua më tej ndërmjet
24 Prokurorisë dhe dëshmitarit në fjalë.

25 Pra, bëhej fjalë për një identifikim i pabesueshëm nga ky

1 dëshmitar, e kemi kundërshtuar gjerë e gjatë, domethënë, nuk
2 është identifikuar personi që sipas dëshmitarit ishte Selimi
3 dhe ky person nuk është i identifikuar që kishte njohuri për
4 rrëmbimin ose për ndalimin.

5 Ka dhe dy pretendime që Prokuroria nuk duhet t'i mbajë,
6 megjithëse duket që vazhdon t'i mbajë. Njëra ka të bëjë me
7 pretendimin se z. Selimi kërcënoi një gazetar të të drejtave
8 të njeriut, aktivist, në tetor të 1998-s në Jabllanicë, siç
9 përcaktohet në paragrafin 47 të aktakuzës. Kjo bazohej në një
10 provë, dëshmia e një dëshmitari, dëshmia e të cilit u pranua
11 sipas rregullës 155, pa provat që kishin të bëjnë
12 drejtpërdrejtë me z. Selimi sepse në fjalë të Trupit Gjykses
13 pretendimi ishte dhe të do të ishte i pakonfirmuar. U dha nga
14 një dëshmitar, të cilin i akuzuari i z. Selimi nuk pati
15 mundësi ta marrë në pyetje, t'i bëhet pyetje dhe të
16 kundërshtojë pohimet e tij lidhur me të që dha nën betim. Dhe,
17 për rrjedhojë, u përjashtua për shkak se shkaktonte dëm të
18 papranueshëm dhe që ishte dëmi më i madh sesa vlera provuese e
19 dëshmisë së këtij dëshmitari. Kjo është në F01603, paragrafi
20 193, 197. Prokuroria u urdhërua që të përgatisë dhe të
21 dorëzojë një version të këtij dokumenti me heqjen e pjesës që
22 ishte redaktuar.

23 Prokuroria e tërhoqi këtë pastaj në mënyrë të shprehur
24 këtë pretendim, në paragrafin 345 pretendon se:

25 "Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm gjithashtu ishin

1 drejtpërdrejtë të përfshirë në shënjestrimin e kundërshtarëve
2 në zonën e Dukagjinit. Në fund të tetorit 1998, një
3 kundërshtar u shoqërua në Jabllanicë në shtab, ku u mor në
4 pyetje nga një person që u identifikua vetë, u prezantua, si
5 gjë që e konfirmoi Sokol Dobruna, anëtar i Shtabit të
6 Përgjithshëm, pra, personi që u identifikua.”

7 Ky pohim u bazua në tre paragrafë të deklaratës së
8 dëshmitarit, të cilët ZPS-ja nuk ia redaktoi. Këta paragrafë
9 të tjerë, pastaj vazhdojnë të përfshijnë z. Selimi në këtë
10 incident në kundërshtim të plotë me urdhrin e Trupi Gjykses
11 dhe vetë njoftimin. Ne themi që kjo është tërësisht e pavend
12 që ZPS-ja të vazhdojë të mbështetet në këtë dhe që të kërkojë
13 të përfshijë të dy z. Selimi dhe Shtabin e Përgjithshëm në
14 tërësi në këtë incident.

15 Dhe, në fund, lidhur me pretendimet individuale ZPS-ja
16 pretendon përfshirjen e z. Selimi lidhur me një individ që
17 quhet Sami Duga, paragrafi 105 i dosjes së ZPS-së
18 përfundimtare. Nuk përmendet fare në dosjen paraprake. Kemi
19 një pretendim në paragrafin 513 të dosjes paraprake e cila
20 mbështetet vetëm në dëshminë e Dëshmitarit W04839 ,lidhur me
21 një urdhër të pretenduar të z. Selimi në lidhje me individ nga
22 fshati Duga, por kjo pastaj u tërhoq më vonë, urdhri u tërhoq.

23 Edhe këtu, ju Gjykatës, pranuat dëshminë e dëshmitarit
24 W04839 në vendimin F02013, ju thatë që kjo nuk ishte në
25 aktakuzë ky pretendim dhe individit nuk u vra, në fakt, dhe

1 përjashtuat këtë për shkak të dëmit që do të shkaktonte kjo
2 dëshmi. Megjithatë, ky pretendim u soll përsëri nga Prokuroria
3 në paragrafin 1005 të dosjes së tyre përfundimtare,
4 potencialisht në lidhje me një Dugë tjetër. Sidoqoftë,
5 pretendimi duhet të ishte -- nuk duhet të ishte bërë kundër z.
6 Selimi.

7 Së treti, mosparandalimi, moshetimi dhe mosndëshkimi.

8 Ky aspekt që ka të bëjë me përgjegjësinë eprore që është
9 ripaketuar si kontribut i konsiderueshëm i pretenduar në NKP.
10 Z. Selimi nuk ka patur vartës, nuk ka patur autoritetin për të
11 liruar të ndaluar. Perceptimi nga 4743, autoritetit të z.
12 Selimi, lidhet me një çështje të veçantë përkatëse për hetimin
13 që ka të bëjë me hetimin e katër policëve ushtarakë të cilët
14 nuk u ngarkuan me ndonjë vepër penale për krimet penale në
15 aktakuzë. Është krejt ndryshe nga autoriteti real dhe nuk ka
16 të bëjë me pretendimet në aktakuzë, është irelevant për këtë.

17 Aspekte të tjera të njohurisë së pretenduar të krimeve
18 përmes transmetimeve në media janë trajtuar në mënyrë të gjerë
19 nga Mbrojtja në paragrafët 1113, 1153 të dosjes së tyre.

20 Dhe, së katërti, shpërndarja e informacionit për të
21 promovuar qëllimin e përbashkët dhe për të krijuar frikë,
22 mosbesim, urrejtje, kjo është në dosjen e Prokurorisë. Tani ky
23 pretendim për shpërndarjen e informacionit është i kufizuar
24 dhe brenda fushëveprimit të kufizuar të pretendimeve të
25 Prokurorisë në tërësi.

1 Së pari, Prokuroria mbështetet në rolin e Selimit në
2 daljen e parë të UÇK-së në nëntor 1997, që është shumë përpara
3 periudhës së aktakuzës. Tani do të trajtoj përmbajtjen e kësaj
4 më vonë lidhur me synimin e z. Selimi, faktin se kjo është
5 bërë pesë muaj përpara ndonjë krimi të kryer sipas planit të
6 përbashkët të pretenduar gjatë periudhës së aktakuzës. Do të
7 thotë që nuk mund, ai nuk mund të ketë dhënë kontribut të
8 konsiderueshëm.

9 Në mënyrë të ngjashme pohimi, parashtrimi i ZPS-së "se z.
10 Selimi mori pjesë në renditjen apo bërjen e komunikimeve gjatë
11 luftës për t'u siguruar se deklaratat publike të Shtabit të
12 Përgjithshëm do të perceptoheshin dhe të shiheshin si me
13 autoritet", ky është një citim nga dosja e Prokurorisë është
14 edhe ky i pakuptimtë dhe i pabazuar. Dëshmitë mbi të cilat
15 mbështete për këtë janë relativisht të pakundërshtuara --
16 është deklarata relativisht e pakundërshtuar e 4410 i cili
17 thotë se z. Selimi, flet për z. Selimi dhe komentoi se ai do
18 të fliste për luftën por kishte disa vërejtje për të bërë
19 lidhur me mënyrën sesi Televizioni Shqiptar kishte informuar
20 për luftën sepse po raportonte, se raportimi i tyre nuk ishte
21 pasqyrim i saktë i situatës në terren.

22 4410 nuk shpjegoi në asnjë moment komentin që duket i
23 pafajshëm për të cilin ai u pajtua dhe, që z. Selimi siguroi
24 që deklaratat zyrtare të Shtabit të Përgjithshëm kishin
25 autoritet.

1 Çdo kërkesë për ndonjë vlerësim realist dhe objektiv të
2 konfliktit ku ata që, në fakt, ishin në zonat e luftës është
3 tërësisht në kundërshtim me sugjerimin e Prokurorisë se z.
4 Selimi kërkonte të kontrollonte komunikimin apo të komunikonte
5 një qëndrim të caktuar.

6 Pika pesë, emërimi apo miratimi i emërimeve në pozita të
7 caktuara. Mbrojtja i ka trajtuar këto emërimet në policinë
8 ushtarake, aspektet e ndryshme të kësaj gjenden në dosjen e
9 Mbrojtjes në paragrafët 237, 266. Pjesa dërrmuese e emërimeve,
10 në fakt, janë bërë nga komandanti i zonës përkatëse, pa ndonjë
11 rol apo përfshirjen e z. Selimi apo anëtarëve të tjerë të
12 Shtabit të Përgjithshëm.

13 Po këto janë aspekte që kërkojnë pak komente më shtesë.

14 Së pari është fakti se këshilli për personelin dhe
15 drejtoria e personelit. Tani, Prokuroria duket sikur nuk i jep
16 faktit se inspektori i përgjithshëm kishte rol në lidhje me
17 drejtorinë e personelit, duke pretenduar se në nivel të
18 Shtabit të Përgjithshëm drejtoria e personelit bashkëpunoi me
19 inspektorin e përgjithshëm. Kjo është në paragrafin 177.

20 Por edhe këtu Prokuroria i jepte më tepër rëndësi kësaj
21 prove seç ka, në këtë rast, intervista e Adem Grabovcit, i
22 cili deklaroi se bashkëpunimi i ngushtë ishte ose me
23 drejtorinë dhe në ndonjë rast të caktuar me inspektorin e
24 përgjithshëm. Edhe këtu ky individ, dëshmia e tij nuk është e
25 verifikuar sepse nuk është thirrur që të dëshmojë dhe u

1 shpërfill nga Trupi Gjykses -- dhe dëshmia e tij nuk duhet të
2 merret parasysh nga Trupi Gjykses.

3 ZPS-ja gjithashtu pretendon se z. Selimi ishte anëtar i
4 këshillit për personelin, kjo është në paragrafët 178, 538,
5 539 të dosjes së Prokurorisë. Pretendohet që ai ishte
6 përgjegjës për shqyrtimin e propozimeve për emërime, përfshirë
7 edhe për zonat, që do të diskutohej pastaj nga Shtabi i
8 Përgjithshëm. Ky pohim bazohet në dy shënime të dorëshkuara,
9 të dyja i referohen krijimit të komisioneve të ndryshme. Emri
10 i Selimit paraqitet, shihet vetëm në një shënim që nuk mban
11 datë si anëtar i këshillit për personelin. Dokumenti tjetër
12 P1109 nuk e përmend atë, nuk e rëndit atë si anëtar i
13 këshillit për personelin. Edhe pse iu tregua disa dëshmitarëve
14 asnjëri prej tyre nuk e konstatoi mungesën e z. Selimi nga kjo
15 listë dhe/apo korrigjoi dokumentin për ta përfshirë atë.

16 Në fakt provat lidhur me këshillin e personelit edhe
17 sikur të ekzistonte dhe të ishte funksional janë shumë të
18 kufizuara, siç u shpjegua nga Mbrojtja e Thaçit dje.

19 Tani pretendimi në vijim lidhur me takimin e 12 shkurtit
20 1999, ku Prokuroria pretendon që u vendos të zëvendësohet
21 komandant Drini si komandant i zonës së Pashtrikut, ka fare
22 pak të bëjë me këshillin e personelit. Spekulimi i 4752 se
23 ishte këshilli i personelit që ka dhënë arsyet për
24 zëvendësimin e propozuar nuk bazohet në njohurinë e tij.

25 Pretendimi se z. Selimi pastaj udhëhoqi debatin apo

1 diskutimin gjatë takimit që bazohet në rrëfimin e dëshmitarit
2 i cili nuk ishte në gjendje të shpjegonte ku një individ
3 tjetër, i cili ishte dhe ai i pranishëm në takim, dha një
4 rrëfim ndryshe të këtij takimi Prokurorisë dhe shpjegoi se as
5 z. Selimi as anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm nuk ishin të
6 pranishëm, nuk i kujtohej dhe as nuk kujtohej. Dëshmitari i
7 përfshirë, 4739, nuk i kujtohej që kishe pasur ndonjë debat
8 publik me anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm siç kishte
9 pretenduar ai.

10 Mbrojtja trajtoi këto në hollësi, zëvendësimin e
11 komandant Drinit paragrafi 446, 451 në dosjen e tyre.

12 Përpyekja e Prokurorisë në parashtrimet gojore të martën
13 për të kundërshtuar zëvendësimin e komandant Drinit dhe
14 promovimin dhe ngritjen në detyrë të Sylejman Selimit është e
15 pavend po ashtu. ZPS-ja nuk ka paraqitur prova se z. Selimi në
16 fakt ishte përgjegjës në ndonjë mënyrë apo tjetër për këtë
17 veprim. Megjithatë Prokuroria paraqet zgjedhjen e z. Selimi si
18 komandant i UÇK-së dhe zëvendësimin e Azem Sylës që nuk asnjë
19 provë që kjo ishte planifikuar dhe u zbatua nga Rexhep Selimi.
20 Si shumë prej provave të Prokurorisë kjo është thjesht
21 thashetheme dhe insunuim më shumë sesa diçka që bazohet në
22 prova.

23 ZPS-ja pretendon gjithashtu se z. Selimi ishte pjesë e
24 një grupi të kufizuar që kontrollonte emërimet, ku sigurohet
25 që ata, që njerëzit e duhur do të ishin aty për të zbatuar

1 qëllimin e përbashkët, ata do të merrnin emërimet e duhura dhe
2 ngritjet në detyrë. Kjo është një deklaratë bombastike e
3 fuqishme dhe përmend tre emërime nga z. Selimi lidhur me Faton
4 Mehmetaj, P1947, Kadri Kastrati, P1942 dhe një tjetër individ.

5 Tani do t'i trajtojmë këto, nuk ka pretendim apo provë se
6 ndonjë emërim i tij ka shërbyer në ndonjë mënyrë apo një
7 tjetër për të zbatuar qëllimin e përbashkët.

8 Ndërsa z. Mehmetaj pretendohet që ishte përfshirë në
9 krime sipas dosjes së Prokurorisë, emërimi i tij formal nga z.
10 Selimi është bërë në kontekstin e përpjekjeve për të zgjidhur
11 një situatë që përfshinte z. Tahit Zemaj në gusht të 1998.
12 Emërimi i Mehmetajt nga z. Selimi ka ndodhur pasi ai kishte
13 qenë, kishte dhe bërë një punë të tillë në rol të ngjashëm në
14 zonën e Dukagjinit, ku ishte emëruar z. Haradinaj.

15 P920, që lidhet me një anëtar të FARK-ut, është lëshuar
16 të njëjtën ditë si emërim i z. Mehmetaj. Si mundet ZPS-ja në
17 mënyrë të arsyeshëm të pretendojë se ky emërim përmes 920
18 ishte po ashtu pjesë e planit të përbashkët për të vendosur
19 individë që ishin besnikë ndaj z. Selimi në pozita për të
20 zbatuar planin.

21 Z. Selimi mund të ketë dashur të ekzagjerojë rolin e tij
22 duke thënë që ai ka bërë këto emërime komandantët e zonës së
23 Shalës dhe Dukagjinit apo të Llapit, asnjë dëshmitar dhe as
24 prova shkresore nuk e mbështesin pretendimin e ngritur dhe
25 Prokuroria nuk e ka pyetur fare Dëshmitarin W04746 për ta

1 konfirmuar këtë.

2 Në fund, dy emërime dhe marrëdhënia e tyre e raportimit
3 të pretenduar kërkon që të bëhet -- duhet që të bëjmë një
4 koment për këtë.

5 Në paragrafin 503 të dosjes së tyre, Prokuroria pretendon
6 se z. Selimi i caktoi detyrën Nexhmi Kastratit në komandën në
7 burgut, dhe Nexhmi kishte qenë mbikëqyrës i ndalimeve të
8 mëparshme dhe i abuzimeve në bashkëpunim me z. Selimi.
9 Megjithatë, i vetmi emërim që z. Selimi -- në të cilin z.
10 Selimi pretendohet të ketë qenë, përfshirë lidhur me rolin e
11 Krasniqit si komandant i policisë ushtarake të zonës operative
12 të Pashtrikut i cili ndodhi në vitin 1999, është trajtuar në
13 mënyrë të gjerë dhe kundërshtuar në paragrafët 257, 254, 255
14 të dosjes së Mbrojtjes.

15 Lidhur me këtë pretendim të fundit kur z. Selimi ishte
16 ministër i rendit publik, kjo bazohet në dëshminë e 4738 dhe
17 që gjendet në dosjen e Prokurorisë, që përfundimisht nuk u
18 pranua në prova. Pavarësisht mangësisë së bazës së provave --
19 a provave bazë, ZPS-ja, megjithatë, vazhdon të qëndrojë dhe të
20 mbështesë këtë pretendim dhe ta lidhë për të lidhur boshllëkun
21 dhe për të plotësuar boshllëkun e provave me spekulime,
22 mungesën e provave me spekulime.

23 Dhe, në fund, çështja e emërimeve, paragrafi 1278 në
24 dosjen e Prokurorisë pretendon se si komandanti i njësisë Syri
25 i Shqiponjës dhe zëvendëskomandanti i zonës ushtarake -- i

1 policisë ushtarake të zonës së Pashtrikut, Nexhmi Krasniqi
2 raportonte në komandën e zonës së Pashtrikut, përfshirë z.
3 Selimi.

4 Tani Mbrojtja e kundërshtoi këtë në dosjen e tyre, pra,
5 përpjekjen e dëshpëruar të këtij pretendimi që ilustron
6 dëshirën e Prokurorisë për të treguar një lidhje midis z.
7 Selimi dhe atyre që pretendohet që ishin përgjegjës për krimet
8 në aktakuzë. Nuk ka asnjë lidhje të tillë.

9 Së gjashti, dhënia, organizimi dhe lehtësimi i
10 mbështetjes financiare ushtarake logjistike. Kjo është në
11 paragrafin 540 të dosjes së Prokurorisë.

12 Tani edhe këtu përsëri Prokuroria mbështetet në detyra
13 normale ushtarake si kontribut për të thënë që ka patur
14 kontribut të konsiderueshëm në krimet që në lidhje me NKP-në
15 që i përmenda më herët. Për ta thënë thjesht, ata kërkojnë të
16 gjejnë një kontribut të konsiderueshëm për z. Selimi, thjesht
17 sepse ai ka qenë ushtar. Dhe kjo është thjesht e palejueshme,
18 e papranueshme.

19 Megjithatë, në paragrafin 233 të dosjes përfundimtare,
20 Prokuroria gjithashtu, kësaj radhe mesa duket për herë të
21 parë, kërkon që t'i japë një rol politik z. Selimi që nuk
22 është paraqitur as në dosjen paraprake dhe që as mbështetet në
23 prova.

24 Megjithëse Prokuroria përpiqet të pranojë se z. Selimi
25 nuk ishte pjesë e drejtorisë politike, ajo ngre pretendimin se

1 ai në maj të 1998-s, ai përfaqësonte Shtabin e Përgjithshëm në
2 takime me LKÇK-në, përfaqësuesit e LKÇK-së, ku u bë
3 marrëveshja e përfshirjes së forcave të LKÇK-së në UÇK, të
4 cilën ZPS-ja e karakterizon si hyrja e përfshirja në politikë
5 e z. Selimi në çështje politike.

6 Megjithatë, takimi i z. Selimi me LKÇK-në kishte të bënte
7 ekskluzivisht me çështje ushtarake. Në fakt, intervista në të
8 cilën mbështetet Prokuroria për këtë çështje, në atë
9 intervistë ai e bën të qartë se rezultati i këtyre takimeve
10 ishte nënshkrimi i një marrëveshjeje tekniko-ushtarake. Edhe
11 megjithëse LKÇK-ja donte të kishte dhe një marrëveshje
12 politike, z. Selimi qartëson se e vetmja marrëveshje që u bë
13 ishte ushtarake sepse ai refuzoi të fliste për aspektet
14 politike sepse nuk ishte përgjegjësia e tij. Dhe kjo është në
15 P1949 dhe është përsëritur në intervistën e tij dhënë Zëri-t
16 në P4200.

17 Prokuroria në mënyrë të ngjashme pretendon se pjesëmarrja
18 e z. Selimi në bisedimet me Qeverinë në Mërgim, ministrin e
19 mbrojtjes së Qeverisë në Mërgim dhe kryeministrin në korrik të
20 1998-s ilustron hyrjen e tij në aktivitete politike,
21 pjesëmarrjen e tij në aktivitete politike duke u mbështetur
22 përsëri në atë që vetë z. Selimi kishte thënë. Megjithatë dhe
23 këtu pjesa tjetër e shpjegimit që ai jep për atë takim
24 shpërfillet tërësisht nga Prokuroria. Ai nuk organizoi
25 diskutimin, nuk ishte përgjegjës për të dhe, në fakt, kërkoi

1 të kthehej në pjesën e luftimeve në Kosovë sa më shpejt që të
2 ishte e mundur.

3 Në mungesë të takimeve politike pas kësaj pike, pohimi
4 dhe pretendimi i ZPS-së se ai ushtroi një rol politik është
5 tërësisht i paqëndrueshëm.

6 Sa i përket pretendimeve tjera në paragrafin 540 dhe ato
7 kanë të bëjnë, në fakt, ato janë kontribut i z. Selimi i
8 ligjshëm dhe legjitim në luftën e çlirimit dhe jo kontribut
9 për kryerjen e krimeve. Pretendime të tilla si udhëtimi i
10 rregullt në zonat e UÇK-së apo ndihma në planifikimin
11 operacional apo logjistik. Me fjalë të tjera, z. Selimi ishte
12 ushtar. Kontributi i tij në NKP ishte kontributi i tij në UÇK.

13 Një shembull tjetër edhe më i spikatur i mënyrës se si
14 kërkohet të penalizohet thjesht pjesëmarrja në luftime apo
15 lufta që bëri është e vështirë të imagjinohet. Në asnjë moment
16 në këto pretendime, ZPS-ja nuk shpjegon sesi z. Selimi fakti
17 që ai udhëtoi në zonën në fakt përbën kontributin e kryer ndaj
18 krimeve.

19 Ngjashëm, pretendimi se z. Selimi siguroi që "anëtarët e
20 NKP-së dhe instrumentet e tyre të kishin burimet e nevojshme
21 për të arritur dhe realizuar qëllimin e përbashkët", pa thënë
22 se cilët anëtarë janë këta, cilët instrumente janë këta, cilat
23 janë burimet dhe çfarë synonte ai të arrinte.

24 Tani, mund të kishin menduar që provat vijnë nga
25 poshtëshënimet që renditin provat në të cilat mbështeten për

1 këtë pretendim, por asnjë në këto referenca lidhur me z.

2 Selimi.

3 Dhe këtu do të përsërisja komentet e bëra nga mbrojtësi i
4 z. Thaçi lidhur me nevojën që të shkojmë të shohim në është në
5 poshtëshënimet në dosjen e Prokurorisë për të gjetur ndonjë
6 referencë. Ajo është e mbushur aty me fraza të parëndësishme,
7 fjali të parëndësishme që nuk mbështeten, tërësisht të
8 pambështetura dhe të pabazuara nga provat që supozohet që të
9 jenë përmendur apo cituar nga Prokuroria.

10 Këto parashtrime dhe pretendime të pambështetura në
11 dosjen e Prokurorisë nuk mund të jenë të paqëllimshme. Ato
12 duhet të jenë të pavetëdijshme që provat e tyre nuk mbështesin
13 kontributin e konsiderueshëm të z. Selimi në krimet që
14 pretendohen në aktakuzë. Dhe, megjithatë, duket që Prokuroria
15 vazhdon të shpresojë që duke ju mbuluar me poshtëshënime, duke
16 ju dorëzuar juve, të nderuar Gjykatës, mijëra poshtëshënime do
17 të kompensojnë, kjo do të mbulojë mungesën e provave të
18 besueshme dhe të mbështetshme.

19 Tani, pretendimi i fundit lidhur me kontributin e
20 supozuar të z. Selimi në NKP si koordinues dhe ndërlidhës
21 midis anëtarëve të NKP-së dhe instrumenteve të tyre. Ky është
22 paragrafi 541, 543.

23 ZPS-ja mbivlerëson, i jep rëndësi të tepërt, mbivlerëson
24 rëndësinë, natyrën dhe shpeshtësinë e inspektimeve bazuar në
25 prova të dhëna në këtë çështje.

1 Ajo gjithashtu nuk shpjegon se si inspektimet e bëra nga
2 z. Selimi, në fakt, përbëjnë kontribut në kryerjen e krimeve.
3 Kjo mangësi dhe ky lëshim është fatal në provat apo në
4 pretendimet e tyre.

5 Në fakt, aspekti i Prokurorisë, provave të tyre apo
6 pretendimeve në këtë për këtë akuzë të fundit është se z.
7 Selimi ishte i respektuar, i besuar nga individë dhe kjo do të
8 thoshte për rrjedhojë që ai mund të vepronte si ndërlidhës
9 midis politikës së Shtabit të Përgjithshëm dhe terrenit. Kjo
10 është në paragrafin 541. Dhe kjo bazohet, thjesht mbështetet
11 në shpresën më shumë në spekulime sesa në prova.

12 Marrëdhënia pozitive e z. Selimi në terren me ushtarët e
13 UÇK-së, është simptomatike e mënyrës se si ai sillej dhe se si
14 ishte gati të rrezikonte jetën e vet për të luftuar në vijën e
15 frontit me këta individë, që s'kishin asgjë të bënin me sulmet
16 e pretenduara të NKP-së së pretenduar ndaj kundërshtarëve. Siç
17 dëshmoi dhe 4752 në një fragment shumë të saktë të në cilin
18 Prokuroria u mbështet, ai nuk kishte asnjë problem me
19 komandantët e zonave sepse ai shoqërohej nga z. Selimi dhe, jo
20 kur z. Zyrapi bënte diçka të keqe, por kur ai po përpiqej të
21 krijonte lidhje të mbrojtjes për të parandaluar ofensivën
22 serbe.

23 Në asnjë moment Prokuroria nuk mori kohë që të shpjegojë
24 cila ishte lidhja midis këtyre udhëtimeve apo inspektimeve dhe
25 marrëdhënieve të mira me ushtarët e UÇK-së në terren dhe sesi

1 kjo kontribuojë në krimet që ZPS-ja pretendon të kenë ndodhur
2 përmes NKP-së. Në fakt janë vetëm në dy paragrafët e fundit të
3 të gjithë pjesës ku trajtohet përgjegjësia e z. Selimi,
4 Prokuroria vetëm në ato dy paragrafë ngre dy pretendime lidhur
5 me konceptin mbi të cilin provat e tyre apo pretendimet e tyre
6 duket se bazohen.

7 Në paragrafin 542 Prokuroria pretendon se si anëtar i
8 Shtabit të Përgjithshëm z. Selimi formalizoi strukturat
9 komanduese, caktoi vijat e frontit të zonave operacionale apo
10 kufijtë e zonave, duke transmetuar e duke përcjellë vijën
11 hierarkike të Shtabit të Përgjithshëm, disiplinën dhe kjo
12 është pjesa relevante dhe duke shënjestruar aktorët e luftës
13 speciale. Në paragrafët vijues, z. Selimi lidhur me vizitat e
14 pretenduara në zonën e Llapit dhe Shalës, pretendohet se ka
15 transmetuar apo dhënë, përcjellë udhëzimet për të identifikuar
16 dhe për të trajtuar luftën speciale shprehimisht, duke lidhur
17 kundërshtarët politikë me këtë kategori dhe duke udhëzuar
18 strukturat vendore në pajtim me këtë.

19 Tani, lufta speciale është një koncept që është përmendur
20 në shumë raste në këtë gjykim nga ZPS-ja, sikurse thjesht
21 përmendja e termit vetë është kriminale dhe nuk duhet asgjë
22 tjetër për të implikuar të akuzuarit. Megjithatë, përdorimi i
23 përsëritur i këtij termi nuk përmbush, nuk përkufizon atë me
24 qartësi dhe ky koncept apo që ky koncepti ishte i njëjti ai që
25 kishte z. Selimi apo të akuzuarit e tjerë dhe kjo është

1 simptomatikë e planit të përbashkët kundër kundërshtarëve.

2 Paragrafi 52 i dosjes përfundimtare, në referencën e saj
3 për luftën speciale, ZPS-ja pohon se kjo fjali "përfshin
4 çdolloj diskursi politik, fjalimi politik apo qëndrimi që
5 perceptohet se minon mbështetjen e UÇK-së", përfshirë
6 "kritikën e UÇK-së dhe operacioneve të saj që është quajtur
7 'keqinformim' dhe 'propagandë', si shprehjen e pikëpamjeve që
8 konsiderohet 'pacifiste' apo që pranojnë humbjet".

9 Në paragrafin 53, përfshin, vijon "duke pretenduar se çdo
10 formim i institucioneve".

11 Kjo është e papranueshme. Në vend të kësaj --

12 Na kanë mbetur pesë minuta, pra, me lejen tuaj mund të
13 vazhdoj shtatë minuta kohë më duhen.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të doja që të kalojmë tek
17 çështja e synimit.

18 Dhe kur themi synimi është "mungesa e provave" se z.
19 Selimi i kishte ndonjë synim për të kryer krimet në të
20 aktakuzë apo të marrë pjesë në planin e përbashkët që
21 përfshinte kryerjen e këtyre krimeve siç pretendon Prokuroria.

22 Pohimi i përgjithshëm i Prokurorisë te roli i të
23 akuzuarit dhe formulimi, zbatimi i qëllimit të përbashkët
24 tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë synimin e tyre për të marrë
25 pjesë në të dhe për të kryer krimet në aktakuzë, kjo është

1 diskutuar në hollësi, siç janë diskutuar edhe mbështetja e
2 Prokurorisë në planin e përbashkët të pretenduar dhe
3 kontributin e konsiderueshëm të pretenduar për secilin prej të
4 akuzuarve, përfshirë përfshirjen e pretenduar të z. Selimi në
5 incidentin e Kleçkës.

6 Pa asnjë provë se ndonjë nga veprimet e z. Selimi
7 përbëjnë diçka më shumë, përbëjnë kontribut të konsiderueshëm
8 në NKP, pa mbështetje nuk mund të pranohen si të besueshme
9 asnjë prej tyre për të përcaktuar synimin e tij.

10 Në fakt, Prokuroria mbështetet mesa duket në tre
11 pretendime të ndara apo dy pretendime të pakonfirmuara për të
12 vërtetuar synimin e supozuar të tij prapa NKP-së.

13 Së pari, një pretendim që i përshtatet Prokurorisë, po
14 është edhe i pakonfirmuar i kërcënimit që të supozuar që z.
15 Selimi i ka bërë një individ - besoj që kjo ka të bëjë me
16 transkriptin e datës 26 qershor 2024 - e cila është thënë nga
17 një dëshmitar tërësisht i anshëm dhe i diskredituar i cili në
18 mënyrë të rrejshme akuzoi z. Selimi për vrasjen e të afërmit
19 të tij. Mbrojtja kundërshton që kjo të jetë thënë dhe asnjë
20 provë nuk mund t'i jepet kësaj dëshmie apo kësaj prove nga
21 Trupi Gjykses.

22 Asnjë peshë nuk mund t'i jepet apo rëndësi kërcënimit të
23 pretenduar nga z. Selimi drejtuar ndaj komandant Drinit që
24 pretendohet të jetë dëgjuar nga dëshmitari i cili e
25 identifikoi veten -- identifikimi i Selimit nga ky dëshmitar

1 ishte me gabime të rënda, veçanërisht kur Prokuroria nuk e
2 thirri atë si dëshmitar edhe pse e kishte në listën e
3 dëshmitarëve, pra, në lidhje me këtë kërcënim.

4 Kemi edhe dy shembuj të fabrikuar, të sajuar, të
5 pabesueshëm, të pakonfirmuar që nuk demonstrojnë, vërtetojnë
6 synimin e z. Selimi.

7 Në vend të kësaj, ajo e gjitha që Prokuroria ka për të
8 vërtetuar synimin e z. Selimi në NKP është fjalimi që ai ka
9 dhënë në paraqitjen e parë publike të UÇK-së në nëntor të
10 1997-s, që mbi të cilën ajo, Prokuroria, mbështetet në mënyrë
11 konkrete në paragrafin 573.

12 Sa ironike është që të gjitha fjalët e thëna më parë
13 gjatë dhe pas periudhës së aktakuzës, në të gjitha pretendimet
14 e ngritura kundër të akuzuarve dhe të gjitha arsyet për të
15 cilat kjo Gjykatë u krijua, fjalimi i mirënjohur në një vend
16 gjatë varrimit të një mësuesi të vrarë, Halil Gecit, që nxiti
17 mbështetje për UÇK-në dhe e bëri UÇK-në publike për herë të
18 parë është ajo që Prokuroria përdor për të mbështetur
19 pretendimet e saj kundër z. Selimi.

20 Mbrojtja e ka trajtuar këtë në dosjen e saj
21 përfundimtare, rrethanat në të cilat ky fjalim u shkrua dhe që
22 nuk e përmend aty FARK, LDK, Qeverinë e Bukoshit apo
23 bashkëpunëtorët. Ai një fjalim klasik propagande që ka qëllim
24 të caktuar në rrethanat e kohës dhe thekson veprimet e
25 papërcaktuara, të paverifikuara që janë ndërmarrë kundër

1 bashkëpunëtorëve dhe kolaboracionistëve dhe në mënyrë
2 legjitime kritikojnë ata që besojnë që kjo nuk ishte politika
3 e duhur për t'u ndjekur.

4 Kjo është ilustrative dhe vërteton synimin e z. Selimi
5 për të frymëzuar rezistencë. Suksesi i saj mund të gjykohet
6 nga ata qindra, mijëra vullnetarë që luftuan për UÇK-në në
7 javët dhe muajt në vijim.

8 Të nderuar Gjykatës, faleminderit për vëmendjen. Këtu
9 përfundoj me parashtrimet e mia dhe do t'ia jap fjalën kolegut
10 tim në mëngjes.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

12 Tani disa udhëzime. Nesër do të mbarojmë me kolegët tuaj
13 nga dreka.

14 Për Mbrojtjen e Krasniqit për informacion, do të bëjmë
15 pushimin përpara dhe pastaj të fillojmë në orën -- ta bëjmë në
16 12.00 deri në 1.30 dhe pas pushimit mund të filloni ju që do
17 keni pjesën tjetër të pasdites dhe do të jeni afruar drejt
18 përfundimit gjatë asaj kohe, por kemi edhe të hënën për të
19 përfunduar. Pra, ky është plani për nesër dhe do ta them edhe
20 më në hollësi nesër në mëngjes.

21 Diçka tjetër? Nuk ka.

22 Seanca ndërpritet deri nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

23 --- Seanca mbyllet në orën 16.48

24

25